

MËSIMI I BAZUAR NË PROJEKTE (MBP) DOMOSDOSHMËRI NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Luiza Myrtaj Nezha

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkencat Sociale , me profil
Psikologji-Pedagogji , për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof Asoc Dr Ilir Yzeiraj

Numri i fjalëve: 54000

Tiranë, 2020

DEKLARATA E AUTORESISË

.

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është punim origjinal, është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë si i tillë përpara një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar si i tërë.

Ky punim nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

E drejtë e autorit luizamyrtaaj@ 2018. Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.

ABSTRAKTI

Ky studim synon të ndryshojë qasjen e trajtimit të përdorimit të punës me projekte (MBP), jo më si një trend në mësimdhënie, por si një domosdoshmëri që do të ndryshojë brezat në lëmin e kërkim –hulumtimit dhe qasjes së dijeve të tyre drejt aksesit në botën reale, në botën e punës, jashtë mureve të shkollës

Punimi përcakton nivelin e ndikimit të mësimit të bazuar në projekte (MBP) të nxënësit e arsimit të mesëm të ulët të shkollave 9-vjeçare në qytetin e Tiranës.

Studimi u jep përgjigje pyetjeve kërkimore:

Çfarë ndikimi ka MBP në nxitjen e të mësuarit aktiv dhe aftësive për jetën(bashkëpunimi në grupe, mendimi kritik, zgjidhja e problemeve) te nxënësit e arsimit parauniversitar (APU)?

dhe A ka ndikim pozitiv zbatimi i mësimit të bazuar në projekte (MBP) në arritjet mësimore të nxënësve ?

Hipotezat e studimit:

Ndërmjet variablit cilësia e zbatimit të MBP-së dhe variablit të mësuarit aktiv dhe aftësitë për jetën ekzistojnë marrëdhënie statistikisht domethënëse.

Ndërmjet ndikimit pozitiv të MBP-së dhe arritjeve të pritshme të nxënësve ekzistojnë marrëdhënie statistikisht domethënëse.

Kampioni u përbë nga mësues, nxënës dhe prindër të njëmbëdhjetë shkollave të përfshira në anketim dhe intervistat me gjashtë drejtorë të shkollave të arsimit të mesëm të ulët të qytetit të Tiranës. Për të plotësuar anketën u angazhuan 386 nxënës, 346 mësues dhe 136 prindër. Metoda kryesore që u përdor në këtë studim është kryesisht sasiore e mbështetur edhe nga qasja cilësore. Analiza e të dhënave dhe përpunimi statistikor i tyre u kryen me anë të SPSS 22.00

Ky studim është studimi i parë i këtij lloji, në përmasat e një studimi doktoral dhe për problematikën që shtron për studim.

Gjetjet e studimit në fjalë, përfundimet dhe rekomandimet mendohet të jenë të dobishme jo vetëm për shkollat 9-vjeçare të Tiranës.

Fjalët kyçe: *mësimi i bazuar në projekte, stile të nxëni, arritjet e nxënësve, motivimi i nxënëve, aftësitë për jetën*

ABSTRACT

This study aims to change the approach to dealing with project work (PBL), not as a teaching trend but as a necessity that will change generations in the field of the research and accessing their knowledge towards the real world, in the working environment and anywhere.

The paper determines the level of impact of project-based learning (PBL) on lower secondary school students in all elementary schools in the city of Tirana.

The study answers some questions as: What is PBL's impact on promoting active learning and life skills (group collaboration, critical thinking, problem solving) in pre-university education students? and Does the implementation of project-based learning (PLB) have a positive impact on student learning achievements?

Hypothesis of the study:

Between the variable the quality of PBL implementation and the active learning variable and life skills there are statistically significant connection.

Between the positive impact of PBL and the expected student achievement there are statistically significant connection.

The sample consisted of teachers, students and parents of the eleven schools involved in the survey and interviews with six principals of elementary schools and high schools located in Tirana. To complete the survey, 386 students, 346 teachers and 136 parents were engaged in the process. The main method used in this study is mainly quantitative and also supported by qualitative approaches. Data analysis and statistical processing were performed through SPSS 22.00

This study is the first study of its type because of the problem that it discussed.

The results of the study in question, conclusions and recommendations are thought to be useful not just for the elementary schools in Tirana.

Key words: project-based learning, learn style, student achievement, learning motivation, life skills

DEDIKIMI

Këtë punim doktoral ua kushtoj bashkëshortit tim Shkëlqim dhe dy fëmijëve: Luçianës dhe Arrnoldit, të cilët përveç përkrahjes morale kanë qenë shtysë dhe motivues të fuqishëm në realizimin e kësaj pune.

Falenderimet më të mira shkojnë dhe për mamanë time, Rrapen, motrat e mia Zhuljeta dhe Marsela për durimin e treguar me mua gjatë kohës së realizimit të punimit!

FALENDERIME

.

Pa dyshim që një falënderim i merituar shkon për udhëheqësin tim, Profesorin e nderuar Fatmir Vadahi dhe profesorin Ilir Yzeiraj , për mbështetjen dhe ndihmën konstruktive dhe të pakursyer në realizimin e këtij punimi. Mirënjohja ime shkon dhe për gjithë stafi i UET-së për cilësinë e shërbimit të dhënë, dhe mënyrën e veçantë të komunikimit.

Falenderoj Drejtorinë Arsimore të Tiranës dhe gjithë drejtuesit e shkollave të qytetit të Tiranës, që më kanë pranuar, ndihmuar dhe mirëkuptuar për realizimin e studimit në shkollat e përzgjedhura,

Falenderim i veçantë shkon për të gjithë pedagogët anëtarë të Departamentit të Edukimit.

TABELA E PËRMBAJTJES

KAPITULLI I:

HYRJE.....	20
1.1. Problematika e problemit	20
1.2. Qëllimi dhe objektivat e punimit	22
1.3. Pyetjet kërkimore	23
1.4. Hipotezat	23
1,5 Rëndësia e punimit	24
1.6 Kufizime të punimit	24
1.7 Përkufizimi i koncepteve kryesore.....	27
1.8 Struktura e punimit	28

KAPITULLI II: SHQYRTIM LITERATURE

2HYRJE- Pjesa e parë.....	29
2.1Teoritë shkencore mbështetëse studimit.....	30
2.1.1 Teoritë e të nxënit	37
2.1.2 Stilet e të nxënit,stile e të mësuarit ose preferencat e të nxënit.Llojet e tyre.....	37
2.2 Pjesa 2 Mësimdhënia tradicionale dhe mësimdhënia me në qendër nxënësin.....	44
2.2.1 Mësimdhënia tradicionale	44
2.2.2 Mësimdhënia bashkëkohore.....	46
2.2.3 Aftësitë e suksesit të shekullit 21.....	49
2.2.4 Kurrikula me në bazë kompetencat.....	50
2.2.5 Mendimi kritik domosdoshmëri e shekullit të ri	54
2.2.6 Shprehjet e të menduarit .Zgjidhja e problemeve.....	56

KAPITULLI III: MËSIMI PROBLEMOR (MP)VS MËSIMI I BAZUAR NË PROJEKTE (MBP)

3.1. Mësimi problemor (MP)VS Mësimi i Bazuar në Projekte (MBP)

Hyrje	59
3.1.1. Mësimi problemor.....	59
3.1.2. Mësimi i bazuar në projekte (MBP).....	61
3.1.3.Historiku i mësimi të bazuar në projekte në Reggio Emilia.....	65
3.1.4.Mësimi i bazuar në projekte (MBP) dhe karakteristikat e tij.....	69
3.1.5.Elementet e projektit	69
3.1.6 Karakteristikat e mësimi të bazuar në projekte.....	70
3.1.7 Cikli i projektit mësimor	71
3.1.8 Projektet kurrikulare si pjesë e përpunimit të njohurive.....	74
3.1.9 Projekte kurrikulare si metodë për përvetësimin e njohurive të reja.....	74
3.1.10 Përparësitë e mësimi të bazuar në projekte, në raport me mësimdhënien tradicionale.....	86
3.2.1 Pse duhet të përdorim MBP sot në klasat tona?.....	88
3.2.2 Roli i nxënësit në raport me MBP-në.....	90
3.2.3 Aplikimi i MBP te nxënësit me aftësi të veçanta.....	94
3.2.4 Roli i mësuesit në MBP; si lehtësues, menaxher i procesit, vëzhgues /komentues dhe vlerësues.....	96
3.2.5 Prindërit –roli i tyre në MBP	98
3.2.6.Baza ligjore në Shqipëri për përdorimin e MBP –së .Çfarë thonë Dispozitat Normative për projektin:.....	98
3.2.7 Korniza kurrikulare e Arsimit Parauniversitar.....	100
3.2.8Motivimi i nxënësit gjatë zbatimit të mësimi të bazuar në projekte.....	103
3.2.9 Vlerësimi i nxënësit gjatë MBP –së.....	104
3.2.10 Teknologjia në ndihmë të MBP-së .Çfarë është STEM MBP?.....	110
3.3Një përmbledhje për përparësitë dhe jo përparësitë e zbatimit të mësuarit të bazuar në projekte	114
3.3.1 Përparësitë e Mësimi të Bazuar në Projekte.....	114

3.3.2 Dobësitë e zbatimit të MBP-së.....	115
--	-----

KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E STUDIMIT

4.1 Metodatat e kërkimit dhe dizenjimi i punimit.....	117
4.2 Instrumentet e hulumtimit.....	120
4.3 Kampioni i studimit	122
4.4 Vlefshmëria dhe Besueshmëria e Studimit.....	132
4.5 Mbledhja dhe grumbullimi i të dhënave	133
4.6 Etika e kërkimit	133
4.7 Vështirësi gjatë mbledhjes së të dhënave	134

KAPITULLI V: ANALIZA E TË DHËNAVE:MËSUESIT,NXËNËSIT, PRINDËRIT

5.1 Analiza dhe interpretimi i rezultateve	135
5.1.1. <i>Paraqitja e rezultateve të pyetësorëve dhe analizimi tyre në përqindje dhe grafikë. Rezultatet dhe analizimi pyetësorëve të mësuesve dhe nxënësve</i>	136
5.1.2Gjinia.....	137
5.1.3Eksperienca.....	139
5.1.4 Zona urbane dhe periurbane	140
5.1.5.Cilësia e MBP-së Arritjet e nxënësve.....	142
5.1.6: Krijimi e sjelljeve sociale midis nxënësve	144.
5.1.7 Aftësimi i nxënësit për tregun e punës dhe për të ardhmen	147
5.1.8Aftësitë e shekullit XXI, si të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve.....	149
5.1.9 MBP në raport me metodologji të tjera të mësimdhënies	151
5.2Të dhënat deskriptive .Rezultatet dhe analizimi i pyetësorëve të prindërve.....	169
5.3 Rezultatet e tabelave të kryqëzuara.....	182
5.4 Rezultatet e analizës cilësore	210

5.5 Vërtetimi i hipotezave	216
5.5.1 Hipoteza 1 Rezultatet e tabelave të kryqëzuara	216
5.5.2 Rezultatet e analizës korrelacionale dhe regressive.....	216
5.5.3 Hipoteza 2	221
5.5.4 Rezultatet e analizës korrelacionale dhe regressive.....	221
 KAPITULLI VI: PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET	
6.1 Përfundimet	229
6.2 Rekomandimet.....	230
 BIBLIOGRAFIA	
Burime parësore	233
Burime dytësore	239
Burime nga interneti.....	241
SHTOJCA	243

Lista e tabelave

Tabela 1: Modeli i mësimdhënies në shkollën tradicionale.....	45
Tabela 2: Modeli i mësimdhënies me në qendër nxënësin.....	47
Tabela :3 Zbatimi i MBP në klasë -ora 1.....	75
Tabela 4:Zbatimi i MPB-së në klasë -Ora 2-3.....	79
Tabela 5:Mësimi problemor (MP)VS Mësimi të bazuar në projekte	84
Tabela 6 Elementet e transformimit të nxënësit gjatë përdorimit të MBP-së.....	89
Tabela 7:Llojet e vlerësimit të nxënësit në kurrikulën e re /pesha e tyre	110
Tabela8:Testi i besueshmërisë Cronbach's Alpha për respondentët nxënës dhe mësues.....	118
Tabela 9 :Testi i besueshmërisë Cronbach's Alpha për prindërit me pyetjen 5.....	119
Tabela 10: Popullata e nxënësve të arsimit të mesëm të ulët të shkollave 9-vjeçare publike të qytetit të Tiranës	124
Tabela 11: Popullata e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët të shkollave 9-vjeçare publike të qytetit të Tiranës	129
Tabela 12: Respondentët mësues të arsimit fillor dhe arsimit të mesëm të ulët pjesëmarrës në studim.....	130
Tabela 13:Testi i besueshmërisë Cronbach's Alpha –respondentët mësues	133
Tabela 14:Testi i besueshmërisë Cronbach's Alpha –respondentët nxënës	136
Tabela 15:Vlera e frekuencave të variablit Klasa –respondentët nxënës	138
Tabela 16:Vlera e frekuencave të variablit gjinia –respondentët mësues	138
Tabela 17:Vlera e frekuencave të variablit gjinia-respondentët nxënës	139
Tabela18 :Vlera e frekuencave të variablit –Eksperienca.....	140
Tabela 19:Vlerat e frekuencave Zbatimi i MBP-së dhe Niveli shkollor i përdorimit të MBP–respondentët nxënës	142

Tabela 20:Vlerat e frekuencave të Zbatimit të MBP-ja dhe Sqarimi nga mësuesi para aplikimit- Respondentët nxënës.....	142
Tabela 21 : Vlera e frekuencave të cilësisë së MBP-së në arritjet e nxënësve -respondentët mësues	143
Tabela 22:Vlera e frekuencave të Ndikimit të MBP-së e Arritjet e nxënëve –respondentët nxënës	144
Tabela 23:Vlera e frekuencave të ndikimit të MBP-së në krijimi i sjelljeve sociale midis nxënësve –respondentët mësues	146
Tabela 24;Vlerat e frekuencave Shkalla e MBP-së ë krijimin e sjelljeve sociale të tyre – respondentët nxënës	147
<i>Tabela25:Vlerat e frekuencave të Ndikimi i MBPs ë aftësimin e nxënësve për tregun e punës dhe për të ardhmen -respondentët mësues</i>	<i>148</i>
Tabela 26– Vlerat e frekuencave të Shkallës së ndikimit të MBP në aftësimin e nxënësve për tregun e punës dhe për të ardhmen -respondentët nxënës.....	149
Tabela 27:Vlerat e frekuencave të ndikimiit të MBP në aftësitë e shekullit XXI, (si të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve)-respondentë mësues.....	150
Tabela 28 :Vlerat e frekuencave të Ndikimit të MBP në aftësitë e shekullit XXI, (si të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve)—respondentët nxënës	151
Tabela29 :Vlera e MBP-së në raporti me metodat,teknikat e strategjitë e tjera të mësimdhënies respondentët mësues	152
Tabela 30:Vlerat e frekuencave Rëndësia e MBP-së në raport me metodat,teknikat e strategjitë e tjera të mësimdhënies -repondentët nxënës	154
Tabela 31: Vlera e frekuencave Cilët aktivizohen më shumë gjatë zhvillimit dhe prezantimit të projektit femrat apo meshkujt-respondentët mësues	154
Tabela 32 :Vlera e frekuencave të Aktivizimit gjatë MBP-së i femrave apo meshkujve-respondentët nxënës.....	156
Tabela 33: Ndikimi i MBP VS Mësimdhënies tradicionale.....	156
Tabela 34.Tabela e vlerave të frekuencave të funksionimit të MBP-së në klasat ku mbizotëron mësimdhënia tradicionale –respondentë mësues	156
Tabela 35: Vlerat e frekuencave të funksionimit të MBP-së në klasat ku mbizotëron mësimdhënia tradicionale –respondentë nxënës	157
Tabela 36: Vlerat e frekuencave Cilësia e MBP-së në zonat urbane dhe periurbane-respondentët mësues	158.

Tabela 37: Vlerat e frekuencave të Efektivitetit të MBP-së ë lidhje me nxënësit e talentur Respondentë mësues	159
Tabela 38:Vlerat e frekuenca ndikimi MBP-së në reduktimin e numrit të mungesave në shkollë –respondentët mësues	161
Tabela 39:Vlerat e frekuencave Ndikimi MBP-së në reduktimin e numrit të mungesave në shkollë –respondentët nxënës.....	163
Tabela 40:Vlerat e frekuencave:Koha e harxhuar nga MBP-ja në lidhje me strategjitë e tjera-respondentët mësues	164
Tabela 41:Vlerat e frekuencës së :Kohës së harxhuar nga MBP-ja në lidhje me strategjitë e tjera-respondentët nxënës	165
Tabela 42:Vlerat e frekuencave të ndikimit të MBP-së ne lidhje me stilet e të mësuarit – respondentët mësues	166
Tabela 43:Vlerat e frekuencave të Vlera e MBP-së në lidhje me vlerësimin përfundimtar-respondentët nxënës	167
Tabela 44 :Vlerat e frekuencave të variablit :Promovimi i të nxënit gjatë gjithë jetës	168
Tabela 45:Vlerat e frekuencave të variablave, ndikimi i MBP-puna në grupe-respondentët nxënës	169
Tabela 46:Vlerat e frekuencave të variablave, ndikimi i MBP-së dhe Komunikimi (mësues dhe nxënës)-respondentët nxënës për	170
Tabela47:Testi i besueshmërisë Cronbach's Alpha me pyetjen 8.....	171
Tabela 48 :Mosha e prindit.....	173
Tabela 49:Arsimi i prindit	173
Tabela 50:Vlera e frekuencave të variablave gjinia -ndikimi i MBP-së për jetën.....	174
Tabela 51:Gjinia e prindit - MBP-ja i ndihmon të marrë përgjegjësi Crosstab.....	176
<i>Tabela 52: Zbatimin praktik i njohurive gjatë MBP-së - Mosha e prindit.....</i>	<i>178</i>
<i>Tabela 53 :Variablat Ndhma nga prindi-gjinia e fëmijës</i>	<i>179</i>
<i>Tabela 54 :Lidhja ndërmjet “ndihma nga prindi “dhe gjinia e fëmijës</i>	<i>180</i>
Tabela 55:Aftesite nga MBP- MPB ndihmon/zhvillon femijen me skillse/aftësi te reja/	181
Tabela 56 :Motivim nga MBP-ja për arritjet e nxënësve	182

Tabela 57 Vlerat e Pearson Chi-Square të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) ndikimi i MBP-se në motivimin e nxënësve –respondentët nxënës	183
Tabela 58: Vlerat e Pearson Chi-Square të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) zona urbane /periurbane –Të punuarit në grupe gjatë MBP(respondentët nxënës).....	184
Tabela 59 :Gjinia –Zbatimi i MBP sjell ndryshimi në notë-respondentët nxënës	185
Tabela 60 Ndikimi i MBP-së –komunikimi me shokët dhe mësuesit dhe bashkëveprimi në grupe-respondentët nxënës.....	186
Tabela 61 : Lidhja midis variablave : Gjinia –vlerësim përfundimtar më i lartë për MBP-në (respondentë nxënës.....	187
<i>Tabela 62:Zona urbane /periurbane –Ndikimi i MBP te nxënësit e talentuar-respondentët mësues.....</i>	<i>188</i>
Tabela 63:Zona urbane /periurbane–Ndikimi MBP te stilet e të nxënës –respondentët mësues.....	190
Tabela 64: Vlerat e Pearson Chi-Square të tabelave të kryqëzuara (Chi-Squ.....	191
Zona urbane /periurbane –Ndikimi i MBP te stilet e të nxënës –respondentët mësues.....	191
<i>Tabela 65: Në vijim paraqiten vlerat e Phi dhe Cramer’s V të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) zona urbane /periurbane –MBP kërkon më shumë planifikim-respondentët mësues.....</i>	<i>192</i>
<i>Tabela 66 :zona urbane /periurbane –MBP kërkon më shumë planifikim respondente mësues</i>	<i>193</i>
Tabela:67 Vlerat e Pearson Chi-Square të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) Shkolla –Zhvillimi i MBP dallim në cilësi respondentët mësues	194
<i>Tabela 68: Vlerat e Pearson Chi-Square të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) Shkolla –Efektiviteti i MBP te nxënësit e talentuar –respondentët mësues.....</i>	<i>195</i>
Tabela 69: Vlerat e Phi dhe Cramer’s V të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) Shkolla –Ndikimi i MBP më një variacion stileshe	196
Tabela 70: Vlerat e Phi dhe Cramer’s V të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) Gjinia –Efektiviteti i MBP te nxënësit e talentuar –respondentët mësues.....	197
Tabela 71: Vlerat e Pearson Chi-Square të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) Gjinia –Ndikimi i MBP me një variacion stileshe	198
Tabela 72 :Variablat Gjinia –Ndikimi i MBP-së në aftësinë për jetën (5 shkallë) respondentët nxënës	199

Tabela 73: Vlerat e Pearson Chi-Square të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) Vite në arsim –Ndikimi i MBP me një variacion stileshe.....	200
Tabela 74 : Vlerat e Phi dhe Cramer’s V të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) Vite në arsim-Efektiviteti i MBP te nxënësit e talentuar –respondentët mësues.....	201
Tabela 75: Vlerat e Pearson Chi-Square të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests)Gjinia e fëmijës - fëmijës tim i pëlqen të prezantojë produktin gjatë MBP	202
Tabela 76: Vlerat e Phi dhe Cramer’s V të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) Gjinia e fëmijës –Fëmija kërkon ndihmë gjatë MBP.....	203
Tabela 77:Gjinia e fëmijës –MBP-ja ndihmon fëmijët ë menaxhimin e kohës	205
Tabela 78 : Vlerat e Phi dhe Cramer’s V të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) Mosha e prindit –Interesim kur fëmija zbaton MBP.....	206
Tabela79 :Gjinia e prindit –interesimi i tij kur fëmija ka MBP.....	207
Tabela 80: Vlerat e Phi dhe Cramer’s V të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) Gjinia e prindit -interesimi i tij gjatë kohës kur në klasën e fëmijes së tij aplikohet MBP-ja.....	208
Tabela 81 : Vlerat e Pearson R dhe Spearman të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) Gjinia e prindit –Prezantimi i produktit nga fëmija	209
Tabela 82 Vlerat e C të tabelave të hi Square (Chi-Square Test	
MBP reduktohet numri i mungesave të nxënësve në shkollë - Ndikimi i MBP në aftësitë për jetën_5 shkallë.....	210
Tabela 83 : Vlerat e Phi dhe Cramer’s V të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests..	
Rëndësia e MBP në raport me metodat e tjera dhe Ndikimi i MBP-së në aftësitë për jetën – respondentët nxënës.....	212
Tabela 84: MBP duhet të ketë një vlerësim më shumë se 10% dhe Ndikimi i MBP-së në aftësitë për jetën – sipas nxënësve.....	213
Tabela 85:Vlerat e Pearson Chi-Square të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) Ndryshime në nota gjatë aplikimit të MBP dhe Ndikimi i MBP-së në aftësitë për jetën – sipas nxënësve.....	214
Tabela :86 Vlerat e Pearson Correlation, Chi-Square të tabelave të kryqëzuara (Chi-Square Tests) ndermjet variablilit Cilësia e zbatimit të MBP dhe të mësuarit aktiv dhe aftësitë për jetën për respondentet nxenes dhe mesues veç e veç	221
Tabela 87 : Vlerat e për marrëdhëniet ndërmjet variablave), MBP cilësia dhe vlerat në mësimdhënie dhe të variablilit aftësisë për jetën respondentët nxënës-mësues	224

Tabela 88 vlerat e Pearson Correlation të përftuara nga analiza korrelacionale për marrëdhëniet ndërmjet variablave: (Cilesia e zbatimit të MBP dhe variablit Arritjet e nxënësve	225
---	-----

Tabela 89: Regresioni:.....	227
-----------------------------	-----

Tabela 90:Model Fitting Information.....	228
--	-----

Tabela 91: Goodness-of-Fit.....	223
---------------------------------	-----

Tabela:92 Vlerat e Pseudo R Square	224
--	-----

Tabela: 93Test of Parallel Lines ^a	226
---	-----

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1: Harta e njohurive të fragmentizuara.....	42
---	----

Grafiku 2 :Dije të holla , disa lidhje.....	42
---	----

Grafiku 3 : Të kuptuarit e integruar.....	43
---	----

Grafik 4 :Lidhje të forta mes ideve.....	44
--	----

Grafiku 5:Dizenjimi i projektit inxhinierik	64
---	----

Grafiku 6:Paraqitja skematike e ciklit të projektit.....	71
--	----

Grafiku 7:Vlerat e frekuencave të variablit gjinia-respondentët mësues.....	140
---	-----

Grafiku 8 Vlerat e frekuencave të variablit gjinia-respondentët nxënës	145
--	-----

Grafiku 9:Grafiku me vlerat zonë urbane dhe periurbane.....	145
---	-----

Grafiku 10 Vlera e frekuencave të Ndikimit të MBP-së ë Arritjet e nxënësve –respondentët nxënës	146
---	-----

Grafiku 11 :Vlera e MBP-së në raportin me metodat,teknikat e strategjitë e tjera (Mësues)	151
---	-----

Grafiku 12: Vlerat e frekuencave Rëndësia e MBP-së në raportin me metodat,teknikat e strategjitë e tjera të mësimdhënies -repondentët nxënës.....	153
---	-----

Grafiku 13:Vlera e frekuencave të pyetjes : A mundet të funksionojë MBP në një klasë ku mbizotëron mësimdhënia tradicionale?-respondentët nxënës	154
--	-----

Grafiku 14:Vlerat e frekuencave të variablit efektiviteti për nxënësit e talentuar.....	157
---	-----

Grafiku 15: Vlerat e frekuencave të Ndikimit të MBP-së në reduktimin e numrit të mungesave në shkollë –respondentët mësues	162
--	-----

Grafiku16 : Vlera e frekuencave të variablave –gjinia e prindit të fëmijës –ndikimi i MBP-së për jetën	175
Grafiku 17:Aftësite nga MBP -MPB ndihmon/zhvillon femijen me skillse/aftësi te reja/.....	177
Grafiku 18: Ndikimi i MBP-së –ndihmon nxënësin me aftësi të reja	181
Grafiku 19: MBP motivon nxënësit	182
Grafiku:20 Zona urbane /periurbane –Ndikimi i MBP te nxënësit e talentuar-mësuesit.....	183
Grafiku 21:Gjinia –Vlerësim më i lartë për MBP –respondentët nxënës.....	188
Grafiku 22:Shkolla –Ndikimi i MBP më një variacion stilesh	185
Grafiku 23: Shkolla –Efektiviteti i MBP te nxënësit e talentuar –respondentët mësues.....	195
Grafiku 24:Shkolla-Ndikimi i MBP me një variacion stilesh (mësues)	197
Grafiku 25:Gjinia e fëmijës –Fëmija kërkon ndihmë gjatë MBP (prindër).....	198
Grafiku26: Vite në arsim–Efektiviteti i MBP te nxënësit e talentuar (respondentët mësues).....	202
Grafiku 27:Gjinia e fëmijës–Fëmijës tim i pëlqen të prezantojë produktin gjatë MBP(respondentët prindër).....	203
Grafiku 28 Gjinia e - Fëmija kërkon ndihmë kur ka MBP(respondentët prindër).....	204
Grafiku 29 Mosha e prindit –interesimi i tij kur fëmija ka MBP.....	207
Grafiku 30 Gjinia e prindit –interesimi i tij kur fëmija ka MBP.....	208

KAPITULLI I: HYRJE

1.1.Prezantimi i problemit

Nevoja që ka shkolla jonë për të përmirësuar strategjitë në procesin e mësimdhënies dhe futjen e mësimin të bazuar në projekte (MBP) në këtë proces përbëjnë pikënisjen e këtij studimi. Arsimi është në qendër të zhvillimit shoqëror, ndaj vitet e fundit për hir të së vërtetës mund të themi se është zgjuar ineteresi së pari i politikëbërësve për të futur në kurrikulat shkollore projektet kurrikulare dhe më pas i mësuesve për t'i bërë pjesë të mësimdhënies së tyre .

Interesi është ngjallur për disa arsye:

- **Së pari**, Jetojmë në një shekull të ri, shoqëri të re, njerëz të rinj kreativë, kritikë, që përqafojnë ndryshimet që ndodhin me shpejtësinë e erës dhe dinë t'u përshtaten këtyre ndryshimeve më së miri.
- **Së dyti**, teknologjia dixhitale e bën më të lehtë apikimin e MBP-së në klasa, lehtëson hulumtimin (bibliotekat online, materiale që mund të shkarkohen dhe falas nga interneti) lehtëson punën për regjistrim të procesit (kamerat, telefonat, tabletat etj) dhe në fund shpërndarjen në botën virtual në mënyrë të rrufeshme.
- **Së treti**, dijet rreth MBP dhe përvojat e mësuesve nuk janë më ato të viteve të shkuara.
- **Së katërti**, avantazhet që ka aplikimi i kësaj metodologjie në raport me mësimdhënien tradicionale janë “ndjellëse”(mbështetja e nxënësve në përvojat e mëparshme, nxënësit bëhen hulumtues, janë të lirshëm në çështjet që për zgjedhin për diskutim dhe produktet që do të prodhojnë, bashkëpunojnë midis tyre, marrin përgjegjësi dhe fitojnë vetëbesim, në klasën me atmosferë miqësore dhe me mësues lehtësues dhe tolerantë dhe jo pedantë.

Puna me projekte është një nga format e të nxënësve që po përhapet me shpejtësi dhe në vendin tonë. Nëse lexojmë Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar në Nenin 72,

flitet për punën me projekte qofshin këto vjetore lëndore ose ndërlëndore. Gjithashtu dhe në “Udhëzuesin për nxjerrjen e notës vjetore lëndore dhe të notës mesatare vjetore për klasat IV-IX” të datës 08.04.2014 me numër protokolli 2479, pesha që ka vlerësimi me projekte është 10% të vlerës së përgjithshme të notës përfundimtare. Me futjen e kurrikulës së re dhe daljes së “Udhëzuesit për zhvillimin e kurrikulës së re në arsimin e mesëm të ulët (AMU)klasat VI-IX “(2017) dhe “Udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës së re në gjimnaz”(2016) projekti përfshihet në portofolin e nxënësit, pesha e vlerësimit e të cilit është 20% të vlerës së përgjithshme të notës përfundimtare .

Pavarësisht përpjekjes për të futur punën me projekte në mësimdhënie dhe në formulën e vlerësimit, kjo përqindje kaq e vogël të çon në mendimin se punës me projekte(MBP-ja) nuk po i kushtohet vëmendja e duhur, si një mënyrë nxënie që e largon nxënësin nga mësimdhënia tradicionale dhe i bën ata hulumtues dhe krijues, duke pasur më shumë kontroll mbi të mësuarit e tyre dhe të mos jenë vetëm objekt i të mësuarit, por dhe subjekt .

Jo vetëm kaq, por edhe numri i hulumtimeve dhe studimeve në lidhje me përfitimet e nxënësve dhe mësuesve gjatë përdorimit të MBP, në vendin tonë është mjaft i limituar. Pra, pavarësisht të gjithave ndërgjegjësimi i të gjithë aktorëve: mësuesve, nxënësve , prindërve ,komunitetit, politikëbërësve për të mirat e MBP-së janë të një niveli të ulët.

Si rrjedhim, themi se jemi në hapat e para për të sensibilizuar këta aktorë.dhe për këtë, do të duhet kohë dhe hulumtime të shumta në realitetet shqiptare mësimdhënëse për të informuar, bindur, ndërgjegjësuar dhe së fundi familjarizuar të gjithë këta aktorë se sa rëndësi ka që në mjediset tona të mësimdhënies të futet me një peshë të konsiderueshme MBP ,midis metodave bashkëkohore dhe nevojës së përfshirjes së nxënësve në procesin e hulumtimit.

Boshllëku i studimeve në vendin tonë, në fushën e përdorimit të MBP në mësimdhënie e bën të domosdoshëm hulumtimin e nivelit të përdorimit të kësaj metodologjie në shkollat e arsimit parauniversitar në Shqipëri.

Në hulumtim do të përcaktohet dhe niveli i gadishmërisë për përdorimin e MBP-së në shkollë duke analizuar dhe ndikimin e faktorëve të tjerë infrastrukturorë dhe jo vetëm si:

laboratorët e informatikës, mundësia e hulumtimit të nxënësve, kur ato ndodhen në zona të thella rurale, qartësia e hartimit dhe vlerësimit të një projekti nga ana e mësuesve, gjetja e buxhetit për produktet përfundimtare të projektit, etj

1.2 Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky studim synon të ndryshojë qasjen e trajtimit të përdorimit të punës me projekte (MBP), jo më si një trend në mësimdhënie, por si një domosdoshmëri që do të ndryshojë brezat në lëmin e kërkim –hulumtimit dhe qasjes së dijeve të tyre drejt aksesit në botën reale, në botën e punës, jashtë mureve të shkollës

Qëllimi eksplorues që ka studimi, synon të përcaktojë efektin dhe ndikimin e mësimit të bazuar në projekte (MBP) në mësimdhënien e Arsimit Parauniversitar (APU) në vendin tonë.

Do të synohet të zbulohet :

- Niveli i ndikimit të MBP-së në arritjet e nxënësve
- Niveli i ndikimit të MBP-së në motivimin e nxënësve
- Niveli i ndikimit të MBP-së në rritjen e vetëvlerësimit të nxënësve

Mësuesit dhe specialistët e edukimit do të gjejnë në këtë punim bazën konceptuale për krijimin e mjedisit të të nxënësve hulumtues

Studimi ka si objektiva .:

- Të prezantojë opininet e nxënësve, mësuesve, prindërve dhe drejtuesve të shkollave për MBP-në
- Të përcaktojë nivelin e ndikimit të mësimit të bazuar në projekte në arritjet e nxënësve
- Të provojë se MBP i përfshin nxënësit në një hulumtim konstruktiv duke rritur te ata motivimin, vetëbesimin, dhe aftësitë ndërpersonale .

- Të provojë se përdorimi i metodave të të mësuarit nëpërmjet projekteve do të sjellë ngritjen e nivelit të arritjeve të nxënësve.
- Të evidentojë nëpërmjet analizës statistikore faktorët që ndikojnë në zbatimin e MBP –së gjatë procesit mësimor.
- Të vërtetojë ndikimin e cilësisë së zbatimit të MBP-së në nxitjen e të mësuarit aktiv dhe aftësitë për jetën
- Të japë rekomandime të përgjithshme, të veçanta dhe kohore për përdorimin e MBP-së në shkollat e arsimit parauniversitar.

1.3 Pyetjet kërkimore

- Çfarë ndikimi ka MBP në nxitjen e të mësuarit aktiv dhe aftësive për jetën(bashkëpunimi në grupe,mendimi kritik,zgjidhja e problemeve) te nxënësit e arsimit parauniversitar (APU)?
- A ka ndikim pozitiv zbatimi i mësimit të bazuar në projekte (MBP)në arritjet mësimore të nxënësve ?
- A ekzistojnë marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave cilësia e zbatimit te MBP dhe variablit të mësuarit aktiv dhe aftësitë për jetën në arsimin e mesëm të ulët
- A ka dallime në cilësinë e zhvillimit të MBP në shkollat që janë në qendrat urbane dhe ato periurbane ?
- Cilët aktivizohen më shumë gjatë zhvillimit dhe prezantimit të projektit femrat apo meshkujt?

1.4 Hipotezat

Duke u nisur nga pyetjet e shtrura më lart ky punim ka si qëllim të vërtetojë këto hipoteza:

- **Hipoteza alternative # 1:** Përdorimi i MBP-së nxit aftësitë për jetën (të mësuarit aktiv dhe bashkëpunimin me grupe të nxënësve të arsimit parauniversitar)
- **Hipoteza alternative # 2:** Zbatimi i MBP-së ndikon pozitivisht në arritjet e pritshme të nxënësve

Variablat kryesorë të studimit janë përcaktuar: (1) variabli i pavarur: Cilësia e zbatimit të MBP-së

Variabla të varur: Të mësuarit aktiv dhe aftësitë për jetën dhe arritjet mësimore të nxënësve

1.5 Rëndësia e punimit

Natyrshëm dikujt që lexon këtë studim i lind pyetja “Pse e ndërmora këtë studim? ”Çfarë më ka shtyrë të hulumtojë rreth MBP?

Brezi im i takon atij brezi ku mësimdhënia ishte një mësimdhënie tradicionale ku figura e mësuesit ishte burimi i vetëm i informacionit, ku të punuarit në grup apo ekip me detyra të mirëpërcaktuara njihej pak, ndërsa të mësuarit bazuar në projekt si strategji mësimore nuk njihej aspak. As fjala projekt as ishte parë në fjalor a dëgjuar ndonjëherë.

Dhe fjala projekt vit pas viti filloi të familjarizohej me rrethin e arsimtarëve dhe nxënësve. Pas viteve 2005 projekti u bë pjesë e mësimdhënies në vendin tonë.

Kudo lexon lajmërimi pune ku kërkohen këto pozicione të tilla si :

1. Koordinator projektsh
2. Asistent projekti
3. Zbatues projekti

Dhe si mund të mendosh të punosh në këto punë, nëse nxënësi ynë nuk mësohet me këtë mënyrë të punuari dhe me karakteristika të saj.

Kështu që MBP i mëson nxënësit të jenë aktiv në një shoqëri e cila ndryshon me hapa gjigandë ,duke e përgatitur nxënësin për botën reale, jashtë mureve të shkollës

Gjatë bisedave të mia si mësuese dhe drejtuese me një eksperiencë të gjatë në punë dhe si trajnere në disa agjenci trajnuese dëgjoja shpesh se dhe mësuesit kishin mangësi në të kuptuarit dhe të aplikuarit e mësimit të bazuar në projekt.

Në emailin tim vinin sms nga mësues të ndryshëm, të cilët kërkonin ndihmë për të zbatuar MBP në orët e tyre mësimore.

Ndaj dhe rëndësia e këtij studimi qëndron në faktin se ai, jo vetëm synon që, nga njëra anë, të japë një tablo të gjendjes sa më reale ku ndodhet shkolla shqiptare, të japë një gjendje sa më reale të aplikimit të strategjisë së mësimdhënies të mësimit bazuar në projekte. por të shërbejë si një manual për mësuesit e arsimit parauniversitar. Studimi do t'ju vlejë duke sjellë rekomandime të vlefshme jo vetëm nxënësve, por dhe mësuesve,

Do t'ju shërbejë hartuesve të politikave arsimore për shtimin e peshës së vlerësimit të MBP-së në formulën e nxjerrjes së notave, gjithashtu dhe krijimit të kushteve më të mira për zhvillimin e MBP në zonat urbane, periurbane, dhe rurale

1.6 Kufizime të punimit

Përsa ju përket kufizimeve studimi u përball me mungesë të konsiderueshme të dhënash dhe literaturë dytësore, të kërkimeve empirike në vendin tonë si dhe mungesë literature në gjuhën shqipe rreth kësaj teme.

Studimi ka dhe disa kufizime të tjera :

Së pari, vlefshmëria dhe përgjithësimi i rezultateve të arritura në shkollat zonat urbane dhe ato periurbane është i limituar.

Së dyti, duke qenë se vlera e ndikimit të produktit të MBP në nxjerrjen e notës është zëre e pakonsiderueshme (projekti bën pjesë në vlerësimin e punëve të portofolit personal të nxënësit), nxënësit mund të mos i japin rëndësinë e duhur punës së tyre në grup për nxjerrjen e produktit përfundimtar.

Së treti, prindërit dhe komuniteti nuk mund të kuptojë rëndësinë e MBP-së dhe vlerësimit të nxënësve nga tri aktorët: mësuesi, anëtarët e grupit dhe ata të vlerësojnë veten, pasi janë

mësuar me mënyrën tradicionale të vlerësimit ku vetëm mësuesi vlerëson, pra i jep vlerën e duhur përgjigjes së nxënësve dhe punës së tyre në MBP. Gjithashtu një kufizim tjetër i studimit lidhet me faktin që plotësimi i pyetësorëve ishte me vetëraportim, atëherë ekziston mundësia që prindërit, por jo vetëm, të kenë manipuluar me të dhënat, apo mund të kenë qenë dyshues gjatë dhënies së informacionit.

Së katërti, studimi në nivelin aplikativ të tij është në një masë të kufizuar shkollash nxënësish, mësuesish, prindërish, drejtorësh, prandaj rezultatet në krahasim me studime të tjera të ngjashme në një popullatë me përmasa më të mëdha mund të kenë diferenca.

Së pesti, mungesa e pyetësorëve të standardizuar dhe mungesa e literaturës për zbatimin e MBP-së në realitete shqiptare

Së gjashti kampionimi u përzgjedh duke mos u shtrirë në shumë qytete, për shkak të kostove ekonomike dhe kohore. Ky fakt e kufizon punimin në sigurimin e të dhënave më të gjera dhe më përgjithësuese.

Së shtati, mësuesit që kanë marrë pjesë në kampionim nuk kanë qenë të trajnuar në aplikimin e MBP-së në klasa. Njohuritë e marra prej tyre rreth MBP-së kanë qenë marrë në mënyrë autodidakte.

Gjithashtu mund të themi se studimi është i dizenuar për të matur marrëdhëniet ndërmjet dy variablave cilësia e zbatimit të MPB-së dhe të mësuarit aktiv, aftësitë për jetën dhe arritjet mësimore të nxënësve dhe nuk merr përsipër të trajtojë ndikimin e variablave të tjerë që nuk janë përfshirë në studim.

Studimi bazohet kryesisht në matjen e variablave në studim bazuar në vetëdeklarimet e respondentëve me anë të zbatimit të pyetësorëve të strukturuar dhe intervistave gjysmë të strukturuar. Nëse në studim do të zbatoheshin instrumente të tjera, studimi mund të ofronte rezultate dhe përfundime të ndryshme.

1.7 Përkufizimi i koncepteve kryesore

Për të analizuar situatat e ndryshme rreth të mësuarit me projekte, të mbështetura në studime konkrete, dhe për të argumentuar gjetjet në terren të këtij hulumtimi, jemi bazuar në një sërë konceptesh, të cilat mundësojnë arritjen e qëllimit të këtij studimi. Në mënyrë të përmbledhur, le të shohim kuptimin dhe përdorimin e këtyre koncepteve

Mësimi Problemor një njësi, një temë që mund të trajtohet edhe brenda një ore për zgjidhjen e një situate të shtruar në formë problemi.

Mësimi i Bazuar në Projekte – një cikël që ka një fillim dhe një përfundim/ afat i përcaktuar kohor

Projekti është një detyrë komplekse, që shërben për të organizuar dhe drejtuar një tërësi veprimtarish, brenda afatesh të përcaktuara dhe që për t'u kryer kërkon një vëllim pune, një buxhet dhe një nivel cilësor të caktuar.

Projekti mësimor (kërkimor) është metodë hulumtuese komplekse, që kombinon në shkallë të ndryshme shumë nga metodat e punës së nxënësit, si: zgjidhjen e problemit, studimin e rastit, vrojtimin, eksperimentimin etj.

Metoda e punës me projekte është një qasje mësimore gjithëpërfshirëse, në kuadër të së cilës nxënësit planifikojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë projekte që zbatohen në botën reale, si dhe angazhohen në kërkime/hetime të pandërprera bashkëpunuese

Të nxënësit : Të nxënësit nuk është produkt i krijuar nga mësuesit dhe i transmetuar te nxënësit...janë nxënësit ata që krijojnë të nxënësit, në kokën e tyre, apo në duart e tyre dhe është detyrë e mësuesit të lehtësojë, udhëheqë dhe mbështesë nxënësit të bëjnë këtë transformim për veten e tyre, njohuritë e tyre, qëndrimet dhe aftësitë. Kërkohet pjesëmarrja aktive nga nxënësit, nëse duam të ndodhë të nxënësit.”Bardhyl Musai

Hulumtojt : Sipas Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe : Vëzhgoj për të gjetur a për të parë diçka; kërkoj diçka të panjohur për ta zbuluar (Tiranë 1980 fq 696)

Hulumtim: Veprimi sipas kuptimit të foljeve HULUMTOJ,HULUMTOHET,Vepër e shkruar në të cilën një çështje, a paraqiten të dhënat që janë mbledhur nga kërkimet për një çështje; gjurmime, gjetje ose arritje shkencore; Gjetje ose arritje shkencore. (Tiranë 1980 fq 696)

Të nxënëet gjatë gjithë jetës, paraqet një sistem, i cili i siguron një personi mundësi për zhvillimin individual në nivelet më të larta të potencialit të tij. dhe përfshin arsimimin formal nga kopshti deri në studimet universitare dhe ato pasuniversitare, por dhe gjithë mundësitë e arsimimit të individit gjatë jetës së tij, në një lidhje të ngushtë me interesat, detyrat dhe nevojat e tij .(Vampa.M AKTET, Vol. III, Nr 4;499)

1.8 Struktura e punimit

Punimi kërkimor shkencor është ndarë në pesë kapituj:

Kapitulli i parë fillon me prezantimin e problematikës së punimit lidhur me nevojën që shkolla jonë ka për të përmirësuar strategjitë në procesin e mësimdhënies dhe futjen e mësimi të bazur në projekte (MBP). Më pas është paraqitur qëllimi dhe objektivat e studimit, pyetjet kërkimore, hipotezat, rëndësia e punimit, kufizime të punimit janë përkufizuar konceptet kryesore e në fund struktura e punimit

Në kapitullin e dytë shtjellohet në mënyrë sa më të thelluar literatura duke qenë më pranë problematikës së zgjedhur. Ky kapitull do të ndahet në dy pjesë :

Në pjesën e parë do të flitet për a)Teoritë e zhvillimit të individit b)Teoritë konstruktiviste të edukimit dhe c)Teoritë konstruktiviste e të nxënit,

Në pjesën e dytë do të shtjellohet mësimdhënia tradicionale dhe ajo me në qendër nxënësin ,aftësitë e shekullit 21-të, mendimi kritik dhe zgjidhja e problemit, kurrikula me bazë kompetencat .

Në kapitullin e tretë do të flitet për Mësimin problemor dhe Mësimin e bazuar në projekte duke bërë krahasimin e tyre, do të listohen karakteristikat e mësimi të bazuar në projekte,

do të flitet për rolin e nxënësit, mësuesit dhe prindit gjatë zbatimit të MBP-së, vlerësimin e nxënësve në arritjet e tyre në krahasim me metodat e tjera të mësimdhënies; baza ligjore për përdorimin e MBP-së në kurrikul, aplikimin e mësimit të bazuar në projekte të nxënësit me aftësi të kufizuar; roli i teknologjisë në zbatimin e MBP-së dhe qasje trend të zbatimit të MBP-së siç është STEM MBP.

Kapitulli i katërt e në vazhdim janë kapitujt më të rëndësishmë të punimit .Ky kapitull në zbatim të kërkesave dhe standardeve të UET-së, është ndarë në këto nënçështje: Metodatat dhe dizenjimi i studimit; Instrumentet e studimit; Kampioni i studimit; Vlefshmëria dhe Besueshmëria e Studimit; Mbledhja dhe grumbullimi i të dhënave; Etika e studimit; Kufizimet e studimit dhe vështirësitë që u shfaqen gjatë mbledhjes së të dhënave

Kapitulli i pestë : Ky kapitull ka të bëjë me analizën e të dhënave të mbledhura nga mësuesit, nxënësit, prindërit. Ky kapitull përbën thelbin e punimit dhe ka të bëjë me analizën deskriptive ku përfshihen gjinia, eksperiencia, zonat urbane dhe periurbane, mosha, arsimimi ndikimi i MBP-së në arritjet e nxënësve, ndikimi i MPB-së në /zhvillimin me skillse/aftësi te reja te fëmijët. Do të shohim rezultatet e analizës inferenciale, ku në mënyrë specifike pasqyrohen Rezultatet e tabelave të kryqëzuara dhe Rezultatet e analizës korrelacionale dhe regresive, sipas lidhjes mes variablave. Si një çështje e këtij kapitulli do të merremi me Rezultatet e analizës cilësore. Në fund të këtij kapitulli bëhet edhe verifikimi i hipotezave.

Kapitulli i gjashtë:Në këtë kapitull paraqiten përfundimet dhe rekomandimet e dala nga gjetjet e studimit si dhe nga analiza e shqyrtuar e literaturës së kësaj fushe. Në fund vjen Bibliografia e përdorur për realizimin e këtij studimi.

KAPITULLI II: SHQYRTIM LITERATURE

2. Hyrje

Qëllimi i këtij kapitulli është i lidhur ngushtësisht me pyetjet kërkimore që ky studim ka ngritur.

Çfarë ndikimi ka MBP në nxitjen e të mësuarit aktiv dhe aftësive për jetën(bashkëpunimi në grupe, mendimi kritik, zgjidhja e problemeve) te nxënësit e arsimit parauniversitar (APU)?

A ka ndikim pozitiv zbatimi i mësimit të bazuar në projekte (MBP) në arritjet mësimore të nxënësve ?

Ky kapitull ka përdorur një kuadër të madh teorik, pasi këto teori në mënyrë efektive kanë dhënë perspektiva të rëndësishme për të shpjeguar nxitjen që mësimi i bazuar në projekte (MBP) bën në nxitjen e të nxënit aktiv dhe sa nxit bashkëpunimin në grupe të nxënësve, po kështu dhe në motivimin e tyre.

Shqyrtimi i literaturës në këtë hulumtim është i ndarë në dy pjesë: në pjesën e parë shqyrtohen teoritë më të njohura mbi të cilat mbështetet punimi dhe në pjesën e dytë do të trajtohen studimet empirike në lidhje me probleme të konceptit të MBP, mësimdhënia tradicionale në raport me mësimdhënien bashkëkohore,

Pjesa e parë

2.1. Teoritë shkencore mbështetëse të studimit

Teoritë që do të shqyrtohen në këtë hulumtim do të na ndihmojnë për të mbështetur studimin tonë rreth ndikimit të MBP-së në arritjet e nxënësve, në rritjen e motivimit dhe të vetëbesimit të tyre .Këto teori janë :

- ✓ Teoritë e zhvillimit të individit
- ✓ Teoritë konstruktiviste të edukimit
- ✓ Teoritë konstruktiviste e të nxënit

Studimi mbi MBP do të mbështetet në disa teori edukimit që vënë në qendër nxënësin dhe mësuesin e bëjnë lehtësues të procesit.

Teoritë e të nxënit na tregojnë rrugët dhe strategjitë e duhura drejt një mësimdhënie efektive, produktive dhe të qëllimshme.

Në ndryshim me teoritë tradicionale të cilat theksonin se truri është një depozitë e zbrazët e cila duhet të mbushet me njohuri të re, kjo teori ka në bazë ndërtimin e dijes mbështetur në përvojat e mëparshme. Konstruktivizmi e sheh njohurinë si të asimiluar në skema ekzistuese.

Ndër autorët që kanë kontribuar në fushën e të nxënit dhe të zhvillimit, është psikologu zviceran Piazhë (1896 – 1980), i cili studioi proceset e të menduarit te fëmijët.

Teoria e Piazhës (Woolfolk 2011:324-328,335-345)(konstruktivizmi konjativ) për zhvillimin e fëmijës dhe të nxënit. Kjo teori artikulon mendimin se fëmijët mësojnë duke krijuar “harta të mendjes” ose “skema” të cilat shumëzohen dhe përshtaten me mënyrën se si do ta kuptojnë mjedisin. Me kohë struktura bëhet më komplekse.

Piazhëa ishte konstruktivist për faktin se deklaroi që e gjithë njohuria po ashtu dhe perceptimi ndërtohet, jo thjesht merret, as është e lindur. Funksionet themelore të të nxënit sipas tij ishin organizimi, pra të gjitha strukturat konjative janë të ndërlidhura dhe çdo njohuri e re duhet t'i përshtatet sistemit ekzistues.

Një funksion tjetër është adaptimi, pra përshtatja me mjedisin që të promovohet mbijetesat. Nuk mund të kemi adaptim pa dy elemente të tjerë sic janë asimilimi dhe akomodimi

Asimilimi është një proces në të cilin njohuria e re ndryshohet në mendjen tonë për t'u përputhur asaj që ne dimë. Akomodimi është një proces ku ne modifikojmë atë çka dimë për të marrë parasysh informacionin e ri. Ekuilibrimi është baraspesha mes asaj që dihet dhe asaj që po procesohet për momentin, mësimi i materialit të ri (Spenser, K 1991p 17) cituar nga Gerta Sula te “Teoritë e të nxënit fq 57

Ekulibri ndikon në zhvillimin konjitiv të individit dhe sipas Piazhesë ky zhvillim kalon nëpër katër faza, të cilat janë:

1.Faza shqisomotore (lindja -2 vjeç, ku përmes kontaktit fizik me mjedisin fëmija zhvillon koncepte mbi realitetin.

2)Faza paraoperacionale (2-7 vjeç).Në këtë stad të zhvillimit fëmija ka nevojë për situatë fizike të konkretizuar për të ndërtuar koncepte, por nuk ka arsyetim logjik

3)Faza e operacioneve konkrete (7-11 vjeç). Në këtë stad të zhvillimit fëmija krijon koncepte bazuar në përvojën fizike, krijon struktura logjike dhe ka mundësi të zgjidhë probleme abstrakte.

4.Faza e operacioneve formale (11-15 vjeç). Në këtë stad fëmija zgjidh problemet abstrakte me arsyetim logjik (Woolfolk, 2011)

Fazë pas faze Piazheja na shpjegon ndryshimet të natyrës se si fëmijët e shohin botën, ndryshe nga sa e kanë parë.

Piazhe e sheh njohurinë si të asimiluar në skema ekzistuese. Ai thotë se fëmijët mësojnë duke ndërtuar “Harta të mendjes”ose skema. Këto skema shumëzohen dhe përshtaten në mënyrën që u ndihmon atyre ta kuptojnë mjedisin. Me kohë struktura bëhet më komplekse.

Përsa i përket procesit të të nxënës Piazheja na mëson se të nxënët duhet parë si procesi i lidhjes së informacionit të ri me atë që është mësuar më parë. ”Të nxënët nuk është thjesht siç mund të mendohet shtim informacioni dhe nxënësve duhet t`u jepen detyra të cilat janë të përshtatshme nga ana moshore dhe zhvillimore. Qëllimi i edukimit sipas Piazhesë është që të formojë njerëz kritikë, krijues, zbulues dhe shpikës: (Sula.G 2012)

Më pas Lev Vygovski me teorinë social-kulturore të zhvillimit theksoi idenë se të rriturit mësojnë në mënyra të ndryshme nga fëmijët dhe shërbejnë si “skela” për të rritur dijet e fëmijëve. Këto “skela “japin ndihmesën dhe mbështetjen e tyre për të nxënët dhe zgjidhjen e problemeve.

“Mësuesit duhet të bëjnë shumë më tepër, sesa të përgatisin mjedisin, me qëllim që nxënësit të zbulojnë gjëra të reja në mënyrë të pavarur. Nuk duhet dhe nuk mund të pritet që fëmijët të shpikin apo të rizbulojnë dijet që gjenden në kulturat e tyre. Ata duhet të udhëhiqen dhe të asistohen në procesin e të nxënës (Karpov & Haywood 1998)” citon Woolfolk.A (2012)

Një tjetër autor tjetër që ka kontribuar në teorinë e të mësuarit është dhe Jerome Brunet i cili themeloi “Teorinë e Mësimi zbulues”.e cila vë theksin në faktin se “fëmijët i kujtojnë gjërat më mire, nëse i zbulojnë vetë dhe mbështesin fort filozofinë e mësimi të bazuar në projekte (MBP)

Në veprën e tij “The process of education “ai dallon ndryshimin midis “Të kuptuarit “dhe “Bërjes. Një dallim i kuptueshëm për rastin që një nxënës e kupton një koncept matematikor, por nuk di ta shfrytëzojë atë në llogaritje” ”(The process of education, 1999;fq 29)

Po në këtë vepër ai thekson:’ “Tani veprimtaria intelektuale e fëmijës duket se bazohet në aftësinë për të vepruar në propozime hipotetike dhe jo të kufizohet në atë që ai ka mësuar nga përvoja dhe nga ajo që ka ndodhur para se ai të ishte. Fëmija tani mund të mendojë për variablat e mundshëm dhe madje të nxjerrë përfundimin e lidhjeve të mundshme që më vonë mund të verifikohen me anë të eksperimentit ose vrojtimit” (Bruner .S .J 1999)

“Zbulimi, si psh surprizat, - thotë Bruner (1979) në veprën “On knowing-Essays for the left hands The art of discovery”, -ndihmon mendjet më të përgatitura”

Theksohet ideja e të mësuarit e nxënësit nga eksperiencat e mëparshme. Është mësuesi ai që duhet ta bëjë më të lehtë punën hulumtuese, zbuluese të nxënësit, duke ndërtuar njohuri të reja mbi ato që kanë ditur më parë. Në këtë mënyrë krijohen avantazhe të tilla si:

- ✓ Mundësi reale për pjesëmarrjen aktive të nxënësve
- ✓ Pronësinë e të nxënës
- ✓ Zhvillimi i kreativitetit dhe aftësive të zgjidhjes së problemeve
- ✓ Promovon dhe motivon nxënësit (Sulo.G 2012 fq 61)

Një teori tjetër që mbështet punimin është dhe Teoria socialkonjitive e Albert Bandurës që mbështetet te të nxënit vëzhgues dhe të nxënit nga të tjerët.”Shumica e sjelljeve njerëzore mësohet vazhdimisht përmes modelimit”. (Bandura.A,1967 fq 22)

Në rastin e sjelljes shoqërore, fëmijët brenda së njëjtës familje mund të zhvillojnë karakteristika të pabarabarta të personalitetit duke u mbështetur në attribute të ndryshme prindërore dhe të vëllezërve.” Modelimi i njëpasnjëshëm, në të cilin vëzhguesit më vonë shërbejnë si burime të sjelljes për anëtarët e rinj, ka shumë të ngjarë të prodhojë një evolucion gradual imitues të modeleve të reja që kanë pak ngjashmëri me ato të ekspozuara nga modelet origjinale. Në kulturat homogjene, ku të gjitha modelet shfaqin stile të ngjashme të sjelljes, sjellja mund të pësojë pak ose aspak ndryshim gjatë një sërë modelesh të njëpasnjëshme. Është diversiteti në modelim që nxit inovacionin e sjelljes. Modelimi ndoshta kontribuon më shumë në zhvillimin krijues në fillimin e stileve të reja.”(Bandura .S.J, 1967 fq 48)

Një teori tjetër është dhe Teoria e Gardnerit e “Inteligjencave të shumëfishta” në të cilën ai shpreh moton e tij: “Ndihmohini nxënësit të gjejnë potencialin e tyre!”. Kjo teori luan një rol të rëndësishëm në aplikimin e MBP në klasat tona,”duke ofruar një metodë mësimore e cila synon t’u ofrojë nxënësve rrugë të shumëllojshme të personalizimit të të mësuarit të tyre dhe të angazhimit me informacionin e duhur”(QTKA,Tiranë, 2006: fq 55)

“Teoria e inteligjencave të shumëfishta’ kundërshton idenë e etiketimit të nxënësit në një inteligjencë të veçantë. Sipas tij “Çdo individ zotëron një përzierje unike të të gjitha inteligjencave. Ai vendosmërisht pohon se teoria e tij e inteligjencave të shumëfishta duhet të " fuqizojë “nxënësit dhe nuk i kufizon ata në një mënyrë të të mësuarit.

Gjatë krijimit të një produkti gjatë aplikimit të MBP duhet të kemi parasysh se të gjitha inteligjencat luajnë një rol të rëndësishëm .

Nuk mund të prezantosh punën tënde, nëse nuk ke aftësi të mira komunikimi, të artikulojë mendimet në mënyra të ndryshme, nëse nuk ke kultivuar inteligjencën gjuhësore, pasi zgjedhja e fjalëve është shumë e rëndësishme. Nuk mund të bashkëpunosh më të tjerët, të mësosh duke shkëmbyer ide me të tjerët, të kënaqesh duke kaluar kohën me të tjerët, nëse

nuk ke inteligjencën ndërpersonale, nuk mund programosh mire produktin në kompjuter,”të kesh aftësi, jo vetëm për të zbuluar analogji, por dhe për të gjetur analogji midis analogjive” (Gardner.H, Tiranë 2003; 179) në rast se nuk ke të zhvilluar inteligjencën matematikore,

“Inteligjencat e shumëfishta inkurajojnë te nxënësit shumëllojshmëri alternativash të nxëni, të cilat angazhojnë plotësisht inteligjencat e tyre të forta, duke ndikuar edhe në forcimin e atyre më të dobëtave” (QTKA, Tiranë 2006 ;56)

Nga kjo arrijmë në përfundimin se një nxënës mund të mos jetë sistematik gjatë të mësuarit, por talenti i tij mund të shpërthejë në një fushë të caktuar të potencialit njerëzor.

Gardneri identifikoi komponentë të ndryshëm të inteligjencës, ndërsa Sternberg (1988, 2003) fokusohet në vetëm tre komponentet kryesore të cilët janë

1. Inteligjenca praktike - aftësia për t`iu përshtatur dhe formësuar mjedisit.
2. Inteligjenca eksperimentale – aftësia për të menduar në mënyrë të ndryshme nga e tanishmja dhe përshtatja e situatave të tanishme, në situatat e së ardhmes
3. Inteligjenca Komponente - aftësia për të përpunuar informacionin në mënyrë efektive.

Sternberg nuk fokusohet në komponentë të veçantë të inteligjencës të përafuar me disiplina të ndryshme akademike, por ai shqetësohet për faktin se sa ndihmë u jep inteligjenca njerëzve që të kryejnë mirë çdo gjë që zgjedhin të bëjnë. (Sternberg, 1998;131-145) (Moursund.David 2003; 47-48)

Sternberg beson fuqimisht se inteligjenca mund të rritet me studimin dhe praktikën. Mësimi që vazhdon jashtë shkollës është krejt i ndryshëm nga ai që bëhet në shkollë

Në teorinë e shtuar të inteligjencës së suksesshme (Sternberg, 1998, 2003), thekson katër grupe të aftësive njohëse që shërbejnë për t'u bërë një person i arsimuar:

Aftësitë kreative, analitike, praktike dhe aftësitë të bazuara në dituri. Stenberg vë theksin se “edukimi i nxënësve në përgatitjen për të menduarit e tyre për t`u rritur në një botë të

globalizuar është ekuilibri. Nxënësit duhet të zhvillojnë aftësitë krijuese e të menduarit për të gjeneruar ide të reja dhe bindëse, për t'u marrë me probleme komplekse globale; duhet të zhvillojnë aftësitë analitike për të konstatuar nëse idetë e tyre janë të reja e të vlefshme ; të zhvillojnë aftësitë praktike për të zbatuar idetë e tyre dhe për të bindur të tjerët për dobishmërinë e tyre; dhe së fundi të zhvillojnë aftësi të bazuara në dituri për t'u siguruar që individët të përdorin njohuritë dhe aftësitë e tyre për të ndihmuar në nxitjen e një të mirë të përbashkët, duke balancuar vetveten, Mençuria është çelësi i një bote më të mirë dhe problemet që na dalin para nesh sot do të zgjidhen vetëm falë mençurisë. Ndaj, nuk mund të lejojmë që të zhvillojmë mendimtarë që nuk kanë kreativitetin, mençurinë dhe aftësitë praktike për të zgjidhur probleme të rëndësishme globale. Është shumë më e vështirë të mësosh për mençuri dhe kreativitet, apo për kujtesën dhe aftësitë analitike. (Ambrose.Don& Sternberg.R.J 2016 ;17)

David Perkins është një tjetër mbështetës i teorisë së Gardnerit për inteligjencat e shumëfishta. Perkins thotë se se arsimi mund të përmirësohet ndjeshëm duke u fokusuar në shkathhtësitë njohëse të rendit të lartë, dhe duke përdorur mësimin e bazuar në projekte .

Perkins (1995)hulumton rreth inteligjencave dhe dallon ndryshe nga Gardneri këto inteligjenca:

1. Inteligjenca nervore. Kjo i referohet sistemi neurologjik, efikasitetit dhe saktësisë së tij
2. Inteligjenca eksperimentale. Kjo i referohet njohurive dhe përvojave të grumbulluara në fusha të ndryshme.
3. Inteligjenca reflektuese. Kjo i referohet strategjive për të mësuar, për të zgjidhur probleme dhe për t'u afruar intelektualisht detyrave sfiduese. Kjo lloj inteligjence përfshin qëndrime që mbështesin këmbënguljen, imagjinatën, vetë-menaxhimin etj

Pra, në përfundim mund të themi se thelbi i gjithë teorive konstruktiviste qëndron në faktin se nxënësit janë në qendër të procesit të mësimdhënies, janë aktivë në ndërtimin e njohurive dhe e gjithë njohuria ndërtohet nga përvojat e mëparshme. (Moursund David 1999;43-45))

Në krahasim me teoritë tradicionale njohuria duhet të zbatohet që të kuptohet nëse është asimiluar dhe truri është një depozitë e zbrazët e cila duhet të mbushet me njohuri të re.

2.1.1 Teoritë e të nxënit

“Të mësuarit pa të menduarit është mund i humbur; të menduarit pa të mësuarit është i rrezikshëm.” Konfuci

Ekzistojnë studime që stregojnë se individët kanë prirje të brendshme për t'iu qasur mësimit në mënyra të ndryshme (Biggs, 2001; Coffield, Moseley, Hall & Eccleston, 2004)

Stilet e të nxënit, stilet e të mësuarit ose preferencat e të nxënit mund t'i quajmë, por në thelb është mënyra e të cilën një person i qaset mësimit dhe studimit. (Woolfolk, 2011 fq 123)

Sipas profesor Musa Krajës (Pedagogjia 1998 fq 245) “Të nxënësit është një proces, nëpërmjet të cilit çdo njeri fiton njohuri, shkathtësi dhe shprehje” të cilat njeriu nuk i nxë vetëm në shkollë, por kudo, në shoqëri, në shtëpi, përmes librave apo burimeve të tjera të informimit.

“Ekzistojnë teste formale dhe kuice të dizenuara për të identifikuar stilet individuale të të nxënit” (Pitchard, A., 2009 fq 55) Mësuesit shqiptar duhet ta bëjnë vetë një gjë të tillë nëse munden ta bëjnë, nëse nuk munden vazhdojnë me mësimin me gjithë klasën.

Jo të gjithë nxënësit nxënë me të njëjtin stil. Disa duan të punojnë të heshtur, më vetë, të tjerët duan të punojnë në bashkëpunim, në grupe me madhësi të ndryshme, duke nxënë së bashku në mënyrë aktive.”Ndaj mësuesi duhet të jetë i kujdesshëm të identifikojë stilet e të nxënit të nxënësve, sepse të nxënësit varet nga stili i preferuar i të nxënit të një individi” (Pitchard, A. 2009, fq 107)

2.1.2 Stilet e të nxënit, stilet e të mësuarit ose preferencat e të nxënit. Llojet e tyre

Termi 'stil të nxëni' është përdorur gjerësisht në psikologji dhe pedagogji që nga viti 1930. Studiues të ndryshëm kanë punuar në mënyrë të pavarur në aspekte të ndryshme të stilit të

të nxënit dhe kjo ka çuar në një sferë disi të madhe të teorive të të mësuarit.. Boneva”&Mihova 2012 fq5

Në fakt stilet e të nxënit i referohen ndryshimeve në aftësitë tona për të grumbulluar dhe përvetësuar njohuri, pra stili i të nxënit ka të bëjë me mënyrën se si ne mbledhim dhe si ti përdorim njohuritë tona. Secili prej nesh ka një stil të nxëni të vetëm ose një kombinim të stileve të ndryshme të të nxënit. Njerëzit janë të ndryshëm si rrjedhim dhe stilet e të nxënit të tyre do të jenë të ndryshme

Specialistët kanë arritur në përfundimin se ka tre stile bazë të të nxënit .Ato janë :.Stili pamor ; Stili dëgjimor; Stili lëvizor ose me anë të të prekurit .

Stili pamor ose vizual

Shqisa kryesore është shqisa e të parit me anë të së cilës nxënësi përvetëson materialin ose ndryshe nxë. Përmbajtja mësimore mund të përcillet me anë të skicave, hartave të konceptit, diagramave, tabelave, posterave, fotove, pra me pamje.

Studimet tregojnë se 65% e nxënësve nxënë me stilin pamor ose vizual ([http: // ëëëstudyingstyle.com/visual-learners.html](http://ëëëstudyingstyle.com/visual-learners.html)) (Boneva Daniela”&Mihova 2012 fq 10-11)

Nxënësit që nxënë me këtë stil kanë këto karakteristika:

- ✓ Janë të qetë
- ✓ Memorizojnë informacionin me pamje
- ✓ Kujtojnë pamje dhe detaje
- ✓ Janë të organizuar dhe të përpiktë
- ✓ Janë me imagjinatë

Preferojnë këto profesione: artistë vizualë, shpikës, arkitektë, dizajner të brendshëm, mekanikë, inxhinierë, lundrues, skulptorë .

Stili dëgjimor

Si arrin një fëmijë të dallojë të ëmën nga njerëzit e tjerë, pavarësisht nga fakti se ç'ka veshur ajo, se si i ka rregulluar flokët apo se çfarë shprehjeje ka në fytyrë?

Përgjigja është e thjeshtë. Me anë të shqisës të së dëgjuarit

Të dëgjuarit është një nga mënyrat bazë të komunikimit dhe informacioni që merr organizmi i njeriut futet në tru nëpërmjet të dëgjuarit.

Rreth 30% e nxënësve preferojnë të nxënë me stilin dëgjimor (<http://www.studyingstyle.com/auditory-learners.html>)

Në këtë stil shqisa kryesore është shqisa e të dëgjuarit .Nxënësit që nxënë me këtë lloj stili përmbajtjet mësimore i përvetësojnë me anën e fjalës, të inçizimeve, ligjëratave, bisedave, diskutimeve. Kërkohej nga ana e mësuesit një i folur i kujdesshëm, klasa duhet të jetë pa zhurma, duhet të përfshihen të gjithë nxënësit në diskutime e debate.

Nxënësit që nxënë me këtë stil kanë këto karakteristika:

Mësojnë përmes leksioneve, e-librit prezantimeve me gojë, muzikës etj

- ✓ Lexojnë me zë tekstet shkollore, por jo vetëm
- ✓ Diskutojnë me zë të lartë
- ✓ Janë impulsivë në të folur
- ✓ Preferojnë të dëgjojnë muzikë
- ✓ Zgjidhin problemet me të folur (Journal of Studies in Education ISSN 2162-6952 2012, Vol. 2, No. 1, fq 109-110)

Preferojnë këto profesione si :Shkrimtar, gazetar, mësues, avokat, politikan, bloger, përkthyes, poet.¹

Stili kinestezik ose me të prekur.

¹ (<https://www.studyingstyle.com/visual-learners/>)

Nxënësit që nxënë me këtë lloj stili përvetësojnë përmbajtjet mësimore në mënyrë aktive, kur e ndjejnë materialin mësimor,(Garro.S,2013;8) duke vepruar, shkruar, vizatuar etj. Zhvillimi i mësimiit nëpërmjet projekteve është strategjia më e preferuar nga ata, pasi kërkon veprimtari të ndryshme praktike, lëvizje trupore, sportive, paraqitje skenike. Nxënësit me këtë stil kanë prirje dhe shkathtësi për lojëra me top, sport, atletikë, kërcime si dhe veprime tjera ku kërkohet aktivitet trupor.

Nxënësit që nxënë me këtë stil kanë këto karakteristika:

- ✓ Janë imitues të zotë
- ✓ Nuk mund të rrinë ulur për një kohë të gjatë.
- ✓ Janë aktivë në zgjidhjen e problemeve
- ✓ Janë emocionalë dhe përdorin shumë gjestikulacione gjatë të folurit
- ✓ Kureshtarë për gjëra të reja

Preferojnë profesione të tilla si: aktorë, sportistë, imitues, biologë etj

Në librin”Pedagogjia “profesor Musa Kraja thekson se ka dhe stile te tjera të të nxëniti..

Të nxënët konjitiv

Nxënësi kognitiv përvetëson përmbajtjet mësimore, përmes proceseve mendore. “Ky lloj të nxëni rezulton në fitimin e një kompetence profesionale, të cilësive pozitive shoqërore,duke përvijuar personalitetin, karakterin konceptin për veten etj”(Kraja .M, 1998 : fq 249)

Të nxënët psikomotor konsiston në përvetësimin e shkathtësive të jetës së përditshme (Kraja .M, 1998 :fq 249)

Të nxënët efektiv synon në formimin e dëshirave dhe antipative, qëndrimeve dhe paragjykimëve ”(Kraja .M, 1998, fq 249)

David Kolb (1984) dhe të tjerë (p.sh. Kiersey, 2000, Fleming, 2001, Honey, 2002, Rita dhe Keneth Dun 1970 kanë konsideruar ndikime të tjera të mundshme në stilin e të nxëniti të një

nxënësi a individi si :Mjedisi; Mbështetja emocionale; Përbërja shoqërore; Elementet vetjake trupore

Pra “Të nxënët nuk është produkt i krijuar nga mësuesit dhe i transmetuar te nxënësit janë nxënësit ata që krijojnë të nxënët, në kokën e tyre, apo në duart e tyre dhe është detyrë e mësuesit të lehtësojë, udhëheqë dhe mbështesë nxënësit të bëjnë këtë transformim për veten e tyre, njohuritë e tyre, qëndrimet dhe aftësitë. Kërkohej pjesëmarrja aktive nga nxënësit, nëse duam të ndodhë të nxënët.” B.Musai

Të nxënët hulumtues

Xhon Dewey e ka përshkruar formatin themelor të mësimit hulumtues që në 1910. Forma bazë e kësaj strategjie përfshin elementet e mëposhtme :

Mësuesi u paraqit nxënësve një ngjarje, një pyetje ose një problem për zgjidhje. Nxënësit

- 1.Formulojnë hipoteza për të shpjeguar ngjarjen ose problemin.
- 2.Mbledhin të dhënat për të testuar
- 3.Nxjerrin përfundime
- 4.Reflektojnë rreth problemit original dhe proceseve të nevojshme të menduarit për zgjidhjen e tij .

Nxënësi kryen kërkime dhe këto kërkime i ndan në kërkime të dorës së parë dhe të dorës së dytë

Kërkime të dorës së parë :Përvojat; eksperimentet e drejtpërdrejta ; fotografi dhe video ;

Kërkime të dorës së dytë : Librat; interneti, urime të tjera për të gjetur informacione specifike

Ky lloj procesi u ndihmon nxënësve të mësojnë përmbajtjen dhe procesin në të njëjtën kohë

(Woolfolk A , 2011, fq 317-318)

Të nxënët gjatë gjithë jetës Pasi mbarojmë shkollën dhe marrim një diplomë kjo nuk mjafton, pasi bota dhe shoqëria ndryshon me shpejtësi të paimagjinueshme, konkurenca për vendin e punës rritet, po kështu rritet me moshim dhe egoja profesionale dhe personale e njeriut .

Të nxënësit gjatë gjithë jetës, paraqet një sistem, i cili i siguron një personi mundësi për zhvillimin individual në nivelet më të larta të potencialit të tij. dhe përfshin arsimimin formal nga kopshti deri në studimet universitare dhe ato pasuniversitare, por dhe gjithë mundësitë e arsimit të individit gjatë jetës së tij, në një lidhje të ngushtë me interesat, detyrat dhe nevojat e tij .(Vampa.M AKTET, Vol. III, Nr 4;499)

Shembull konkret që sqaron mirëfilli nevojën e arsimit gjatë gjithë jetës janë pasojat e krizës ndërkombëtare financiare si rezultat i së cilës miliona njerëz humbën vendet e tyre të punës dhe trendi i rritjes së papunësisë në vendet e zhvilluara është rritur ndjeshëm gjatë kësaj periudhe. ²

Nxënësit duhet të bëhen qytetarë që mësojnë gjatë gjithë jetës e të mësohen se ndaj një realiteti edukativ të caktuar , çdo individ duhet të përshtatet në mënyrë krijuese

Hartat e koncepteve


Joseph S. Krajcik (2001) në veprën e tij “Mbështetja e të mësuarit të shkencës në kontekst: Mësimi i bazuar në projekte “ citon Whitehead (1929), Perkins(1986),Talsma-n(2001) të cilët theksojnë se “Shumica e nxënësve vetëm mësojnë përkufizimin e termave dhe nuk mësojnë se si të aplikojnë idetë për të zgjidhur problemet që janë të rëndësishme për ta. Këtë Talsma e quan dije inerte ose e fragmentizuar

Valeriae.L Talsma ne disa raste ka folur për hartat e koncepteve. Me anë të hartave të konceptet, nxënësit mund t'i lidhin konceptet në mënyra të ndryshme dhe mund të përfaqësojnë kuptimet personale që mbajnë për konceptet, (Talsma.L, Valerie 1997)

Për të dalluar dallimin midis kuptimeve të shkëputura dhe të integruara skicoi disa lloje hartash .


² <https://telegrafi.com/globalizimi-dhe-te-mesuarit-gjate-gjithe-jetes/>

Grafiku 1: Harta e njohurive të fragmentizuara




Harta e koncepteve e tregon qartë mënyrën se si qëndrojnë te nxënësi këto koncepte ,të palidhura me njëra –tjetrën

Grafiku 2 :Dije të holla , disa lidhje




Në hartën e dytë vëmë re se nxënësi ka koncepte, ide në kokë, por mezi i lidh dhe përshtat ato në situata të caktuara

Grafiku 3 : Të kuptuarit e integruar



Tashmë të kuptuarit është i integruar dhe realizohet lidhja midis ideve. Ndërsa nxënësit zbatojnë kuptimet e tyre në situata të reja, lidhjet bëhen më të pasura dhe më të forta .

Grafiku 4 :Lidhje te forta mes ideve



Te gjitha hartat janë ndërtuar si një model për të përshkruar se si ndërtohet kuptimi.

Kuptimi nuk vjen nga memorizimi, por nga ndërtimi aktiv i një individi bazuar në përvojat e tij ose të saj në botë. Për të zhvilluar kuptime të integruara, nxënësit duhet të zhvillojnë të kuptuarit lidhur me situatat reale. Kuptimet e integruara nuk mund të mësohen të shkëputura nga jeta e nxënësve. (Joseph S. Krajcik, 2001;fq16)

Pjesa e dytë


2.2 Mësimdhënia tradicionale dhe mësimdhënia me në qendër nxënësin

2.2.1 Mësimdhënia tradicionale

Mësimdhënia e para viteve '90 ishte një mësimdhënie tradicionale ku mësuesi shpjegonte dhe nxënësi dëgjonte, ku mësuesi pyeste dhe nxënësi përgjigjej vetëm atëhere kur i jepnin leje, ku nxënësi ishte i bindur para mësuesit që komandonte dhe riprodhonte ato që mësuesi thoshte.

Më poshtë po paraqisim skematikisht Modelin e mësimdhënies në shkollën tradicionale

Tabela 1: Modelin e mësimdhënies në shkollën tradicionale



Mësuesi ishte burimi i vetëm i informacionit e mësimdhënia ishte një mësimdhënie tradicionale

Siç shihet dhe nga figura dhe për sa thamë dhe më lart mbizotërues në këtë lloj mësimdhënie është shpjegimi dhe komunikimi mësues-nxënës i cili zhvillohet vetëm në një kah, nga ai i mësuesit. Informacioni transmetohet i gatshëm. (QTKA,2005; fq 15-20) Në këtë mësimdhënie mësuesi përdorte metodat të cilat kishin në qendër mësuesin të tilla si Kontrolli frontal; Ligjërata; Punë individuale; Të pyeturit individual të nxënësve; Shpjegimi; Demonstrimi; Vrojtimi, Biseda;etj

Natyra e kësaj lloji mësimdhënie ka këto karakteristika :

1.Procesi i të nxënit është linear

2.E gjithë veprimtaria në shkollë ideohet dhe organizohet nga mësuesi

3.Nuk mendon për ndërveprim midis mësuesve dhe nxënësve apo nxënës-nxënës

4.Matja e të nxënit të nxënësve e vështirë për t'u realizuar, pasi mbizotëron në mësimdhënie, shpjegimi dhe leksioni

Mësuesit që janë trajnuar përgjatë linjave tradicionale të mësimdhënies priren të mbivlerësojnë ndikimin e mësimit me anë të të folurit ku përfshihen metodat tradicionale të instruktimit të tilla si : Leksioni formal, Riprodhimi, Metoda e bisedës, Përsëritja dhe rishikimi etj. Megjithatë në përfundim mund të themi se pavarësisht jofrytshmërisë së tyre në mësimdhënie këto metoda trashëgohen nga një brez mësuesish tek tjetri, duke shfrytëzuar traditën dhe kulturën arsimore të vendit dhe popullit në të cilin përdoren (Garo.S,2013;124)

2.2.2 Mësimdhënia bashkëkohore

Metodat e sipërpërmendura na bëjnë me dije se teknikat e zhvillimit të mendimit kritik as mund të mendoheshin para viteve '90 e aq më shumë strategjia e mësimdhënies të bazuar në projekte.


Pas viteve 90`shkolla shqiptare padyshim do të fillonte reformimin e saj hap pas hapi.Vitet e fundit ky reformizim është bërë i dukshëm dhe i prekshëm në disa drejtime :

- Kurrikula në ndryshim: Njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet
- Pedagogjia në ndryshim: Mësimdhënia me nxënësin në qendër
- Vlerësimi në ndryshim: Standardet dhe etika
- Teknologjia në ndryshim: Kompjuterizimi, TIK-u dhe teknologjia edukative
- Ndryshimi i klasës: organizimi dhe menaxhimi i klasës (KEC 2013)

Reformimi i punës në shkollë dhe ndërveprimi në mësim do të kërkonte një skemë tjetër mësimdhënie dhe modele të reja metodash, te cilat do të nxisin ndërveprimin dhe mendimin kritik. Më poshtë po paraqisim skematikisht

Modelin e mësimdhënies me në qendër nxënësin

Tabela 2: Modelin e mësimdhënies me në qendër nxënësin



Ndërveprimi midis nxënësit dhe mësuesit është i qartë. Mësuesi lekon, por është dhe në rolin e ndihmësit. Ai tashmë merr rolin si një partner në komunikimin dhe ndërveprimin në klasë duke bërë që të zvogëlohet stresi i nxënësve në klasë, ngarkesa e punës, pasi ata do të ndërveprojnë me njeri-tjetrin duke i aftësuar dhe të kontrollojnë përparimin e njeri-tjetrit, si rrjedhim të rritet koha e të nxënësit të tyre.

Ashtu si dhe mësuesi dhe nxënësi merr një rol të ri në klasë. Ai është në qendër të procesit mësimor duke u përfshirë në mënyrë aktive emocionalisht, shpirtërisht, intelektualisht, fizikisht. Nxënësi merr nisma, vepron si lider në grupin që drejton, merr vendime, krijon marrëdhënie të reja në raport me shokët dhe mësuesin, janë të pavaruar, padyshim brenda kornizës së kushteve dhe detyrave të dhëna më parë. (QTKA, 2005 : 21-28)

Në këtë ndryshim rolesh dhe mësimdhënie mësuesi përdor dhe përshtat metodat. të cilat kanë në qendër ndërveprimin dhe u japin mundësi nxënësve të realizojnë qëllimet mësimore duke bashkëvepruar në grup të tilla si: Puna në grup; Grupet e ekspertëve, Mendo -Puno në dyshe -Shkëmbe me të tjerët; Diskutimi; Lojë në role dhe simulimi ; Teknikat e metodat e hulumtimit të cilat kanë në qendër ndërveprimin dhe u japin mundësi të nxënë,të nxjerrin përfundime dhe t'i zbatojnë ato në situata të reja të tilla si : Studimi i rastit ; Puna me projekte ; Ekskursioni; Mësimi zbulues; Zgjidhja e problemit

Metoda, teknika dhe strategji që zhvillojnë mendimin krijues dhe kritik të cilat zhvillojnë :

1.Aftësitë folëse: Parashikim me terma paraprakë, Stuhi mendimi; Rrjet diskutimi ; Dora e fshehtë

2.Aftësitë lexuese: INSERT (Interactive Notice System for Effective Reading and Thinking); Tabela e koncepteve; DRTA (Directed Reading and Thinking Activity) Veprimtaria e leximit të drejtuar; Mësimdhënia e ndërsjelltë, Lexim i imët me kodim teksti; (Temples, Crawford & Soul 2006 “ 40;52,66;68

3.Aftësitë shkruese: Diagrami i Venit; Tryeza e rrumbullakët; Pesëvargëshi; Esetë dhe shkrimet e lira (QTKA,2005 : 35)

Procedura kerkim -hulumtim bën të mundur që nxënësit të shkojnë përtej informacionit të marrë në libër dhe të gjejnë informacion të ri përmes intervistave , vëzhgimeve dhe llojeve të tjera të hulumtimit jashtë klasës dhe shkollës. (Temple.et.al 2006)

Kjo teknikë zgjat disa ditë dhe një pjesë e punës bëhet në shkollë, ndërsa një pjesë tjetër bëhet jashtë saj. Është një teknikë që u vjen në ndihmë nxënësve të gjejnë informacione të cilat u japin jetë kurrikulumit shkollor

Të mësuarit konstruktivist duke përfshirë edhe analizën dhe interpretimin nga nxënësit si dhe zbatimi i detyrave kërkojnë kohë. Prandaj mësuesi ndoshta së bashku me nxënësit, duhet të bëjë zgjedhjen se cilat janë temat që meritojnë më shumë kohë për t'u trajtuar. “Bëj më pak, por bëj atë mire”.

Në përfundim mundemi të themi se metoda tradicionale tashmë është një realitet, i cili megjithëse produktiv për kohën e saj, sot nuk është e mjaftueshme, pasi ajo çfarë të mëson mësuesi ndryshon nga ajo që mësohet nga vetë nxënësi, pasi dhe kjo e fundit ndryshon nga ajo çka vetë nxënësi zbaton në jetën reale .”³

Një proverb kinez thotë:

Unë dëgjoj...Unë harroj

Unë shoh...Unë mbaj mend

Unë bëj...Unë kuptoj

2.2.3 Aftësitë e suksesit të shekullit 21

Shekulli 21, shekulli i ri kërkon dhe një qasje të re në mësimdhënie. Jetojmë në një botë në të cilën teknologjia po ecën me shpejtësinë e erës, ku laptopët, Ipadët, tabletat dalin të reja çdo ditë, ku nxënësit mund ta marrin informacionin me një klikim në www(web). Në disa fusha të dijes roli i mësuesit ka dalë fare nga qarkullimi.

Jetojmë në një epokë ku rritet së tepërmi rreziku për vendin e punës. ”Fondacioni për të rinjtë australianë” raporton se "të diplomuarit e kanë shumë më të vështirë sot për punësim dhe punëdhënësit po raportojnë mospërputhje në aftësitë që të rinjtë po mësojnë në ato aftësi që industritë kërkojnë", duke rezultuar në normat e papunësisë së të rinjve deri në 30% Raporti i njëjtë pohon se 50% e vendeve të punës së shpejti do të kërkojnë shkathtësi të konsiderueshme digjitale dhe iniciativë. Ende sot, shumë studentë po braktisin shkollën e mesme pa zhvilluar këto aftësi. Ndërkohë, kompjuterat dhe robotët po zëvendësojnë çdo nevojën që njerëzit të kujtojnë faktet, llogaritjet ose kryen detyra të përsëritura.⁴

³ <http://www.living-democracy.al/textbooks/volume-1/part-2/unit-4/chapter-2/lesson-2-2/>

⁴ www.iley.com/legacy/Australia/Teacher_Resources/Meeting_21st_century_needs_white_paper_August_2017.

Le të listojmë më poshtë aftësitë e shekullit XXI

- 1.Përshtatshmëria. Aftësia dhe gatishmëria për t'u përballur me pasiguritë dhe emergjencat.
- 2.Komunikimi verbal dhe joverbal. I aftë të negociojë në çdo situatë
- 3.Zgjidhja jorutinë e problemeve. Kreativitet për të gjeneruar zgjidhje të reja dhe novative
- 4.Vetëmenaxhim. Vullneti dhe aftësia për të fituar informacione të reja dhe shkathtësitë që lidhen me punën (Houston, 2007).
- 5.Sisteme të të menduarit. Përfshin gjykim, analizë, vendimmarrje, vlerësim, arsyetim abstrakt rreth mënyrës së ndërveprimit të elementëve të ndryshëm të një procesi pune (Peterson, 1999)citon Bybee “The BSCS 5e instructional model and 21st century” 2009;17)

Shekulli i 21-të ka nevojë për njerëz digjitalë, mendimtarë kritikë, novatorë, komunikues. vizionarë, fleksibël, zgjidhës të problemeve, bashkëpunues, dhe kreativë.”Ata do të zhvillojnë sipërmarrjen, do të zhvillojnë dhe respektojnë oraret, dorëzimin e projekteve në kohë, do ta mësojnë procesin dhe rezultatet. Përdorimi i pajisjeve të shekullit të 21 do t`u ndihmojë nxënësve të përgatiten për jetë dhe punë.”(USAID & MASHT,2013; fq 21)

Siç po ndryshon bota duhet të ndryshojnë dhe kurrikulat, pasi fëmijët tanë nuk kanë më zgjedhje!

2.2.4 Kurrikula me në bazë kompetencat

Në vitin 2014-2015 filloi pilotimi i kurrikulës së re në shtatë shkolla të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Ky ishte sinjali që po tregonte se kishte ardhur ora e ndryshimit në arsimin parauniversitar.

Kurrikula, në kuptimin e gjerë, është faktori më i rëndësishëm i procesit të arsimimit. Ajo përcakton se çfarë duhet të dinë dhe çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit, cilat vlera duhen kultivuar tek ata, si duhet të aftësohen për bashkëjetesë dhe tolerancë, si mund

të japin ndihmesën e tyre në mënyrë aktive për mirëqenie shoqërore dhe vetjake (MAS Draft 2012;fq 3)

Ndryshimet në shoqërinë shqiptare u shoqëruan dhe me ndryshime strukturore në arsimin parauniversitar :

- ✓ kalimin e arsimit bazë nga tetë në nëntë vjet
- ✓ zgjatjen e ciklit fillor nga pesë në gjashtë vjet;
- ✓ kalimin e arsimit të mesëm të lartë nga katër në tre vjet.

Si rrjedhim këto ndryshime nuk mund të mos shoqëroheshin me përcaktimin e standardeve të të nxënës sipas cikleve të reja të shkollimit si dhe ndryshimet nga një kurrikul e cila synonte në përvetësimin e përmbajtjeve lëndore, në një kurrikul që krijon kushte dhe mbështet zhvillimin e kompetencave bazuar në kompetencat themelore europiane

Po çfarë kuptojmë me kompetencë?

Kompetenca është zotësia/aftësia që individ ka përvetësuar dhe mund të shfaqë njohuritë /dijet teorike Shkathtësi praktike si shprehje, qëndrime, vlera dhe emocione në kontekste të caktuara

Sistemi ynë arsimor synon të formojë nxënësit që të jenë të aftë të jetojnë dhe të kontribuojnë aktivisht në shoqërinë demokratike, të zotë të përballojnë e të përshtaten në një botë të larmishme e në ndryshim të pandërprerë në të gjitha fushat e jetës, të dijes dhe të punës.

Me kurrikulën e re përmes punës në grupe nxënësit zhvillojnë shkathtësi të komunikimit, kreativitetit dhe pranojnë mendimin e njeri-tjetrit, kuptojnë rolet e tyre në grup dhe zhvillojnë vetëdijen dhe vetëbesimin përmes aktiviteteve konkrete.(USAID&MASHT 2013;fq 19-20)

Në këtë kurrikul dija ndërtohet nga vetë nxënësit. Nxënësi gjeneron dijet e reja nëpërmjet aktiviteteve, përvojave dhe eksperimenteve, që u përgjigjen situatave të të nxënës, të formuluar nga mësuesi në orën e mësimit. Dijet e përfutuara në këtë mënyrë nga nxënësit

çojnë në zhvillimin e kompetencave, e cila u përshtatet nevojave dhe interesave të tyre si gjatë viteve të shkollimit dhe më tej në jetë për përgatitjen e gjeneratave të reja si qytetarë të shoqërisë së dijes. (Salianji.B,2017 ;5)

Po cilat janë kompetencat bazë?

1.Komunikimi në gjuhën amtare. 2. Komunikimi në gjuhë të huaj. 3. Kompetencat në matematikë, në shkencat natyrore dhe në teknologji. 4. Kompetenca digjitale. 5. Kompetenca për të nxënë gjatë gjithë jetës. 6. Kompetenca ndërpersonale, ndërkulturore, shoqërore dhe qytetare. 7. Sipërmarrjen, aftësinë për të shndërruar idetë në veprime. 8. Shfaqjen e identitetit kulturor, mirëkuptimin e larmisë së kulturave, krijimin dhe paraqitjen e ideve, e përvojave dhe e emocioneve në forma të larmishme.

Si dhe kompetencat të cilat pritet që nxënësit t'i arrijnë në fund të arsimit parauniversitar

1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit- Komunikues efektiv
2. Kompetenca e të Menduarit—Mendimtar kreativë
3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë –Nxënës i suksesshëm
4. Kompetenca që ka të bëjë jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin-Kontribues produktiv
5. Kompetenca personale-Individ i shëndoshë
6. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm
7. Kompetenca digjitale Qytetar SMART (IZHA, 2012; fq 5)

Deri dje nuk e dinim dhe nuk kemi folur për kompetencë të sipërmarrjes dhe sot është momenti që t`u mësojmë nxënësve tanë këtë kompetencë, me qëllim që të jenë të përgatitur për shoqërinë e së nesërme

Ç`është kompetenca e sipërmarrjes?

“Sipërmarrësit nuk lindin, por ata bëhen të tillë përmes përvojave të tyre jetësore”(Prof. Shapio.A Universiteti i Ohajos, SH.B.A

Edukimi i sipërmarrjes në shkollë synon që t'i përgatisë njerëzit, e sidomos të rinjtë për të qenë të përgjegjshëm, sipërmarrës individualë, në mënyrë që ata të bëhen të tillë ose mendimtarë të sipërmarrjes për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe për një jetë të qëndrueshme në komunitetin ku ata bëjnë pjesë.

Sipërmarrja është një mënyrë të vepruari, e cila krijon siguri dhe vazhdimësi në jetën personale, duke mundësuar që brezat e rinj të përballojnë me sukses konkurrencën e tregut, përballjen me sistemin e vlerave që krijon një shoqëri e hapur, demokratike. Aftësi për të menduar në mënyrë krijuese dhe kritike. Përfitim nga edukimi i “sipërmarrjes” kanë të gjitha moshat që mësojnë në sistemin parauniversitar. Atyre u duhen krijuar kushtet e nevojshme për të marrë njohuri në këtë drejtim në tërë lëndët shkollore, duke orientuar kështu një politikë të re edukimi, e cila natyrisht kërkon një pasqyrim profesional në kurrikulën e shkollore. Edukimi i “sipërmarrjes” është një proces të nxëni gjatë gjithë jetës, që fillon që në shkollën fillore dhe progreson në të gjithë nivelet e arsimit, përfshirë dhe edukimin e të rriturve në punë.

Kompetenca e sipërmarrjes përfshin një tërësi njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash, të cilat pasqyrohen në përmbajtjen që ofrojnë gjithë kurrikulat lëndore sipas fushave shoqërore, shkencore, natyrore

Po cilat janë këto?

- ✓ Aftësia për të ndërtuar marrëdhënie me të tjerë dhe për të bashkëpunuar me ta
- ✓ Aftësia për të mbajtur lidhje të qëndrueshme
- ✓ Aftësia për të qenë gjithmonë rigoroz dhe “i rreptë” me veten dhe me të tjerët • Aftësitë për bashkëpunuar me të tjerë, për të mbajtur lidhje të vazhdueshme me ta, si dhe për të patur një “disiplinë” personale janë qëndrime, të cilat kërkojnë një kohë të gjatë për t'u krijuar.

- ✓ . Të punuarit në grup, ndërtimi i marrëdhënieve me të tjerët, përballimi i situatave konfliktuale, përballimi i problemeve sociale, kulturore që ka grupi ku bën pjesë është një mundësi e mirë për të krijuar sjellje efektive bashkëpunimi. (UMB 2015;5)

Shkollat përgatitin nxënësit për të jetuar, për të punuar në një botë të ndërlikuar dhe për t'u ballafaquar me ekonominë konkurruese globale. Jeta dhe puna në shekullin XXI kërkon kompetenca për t'u përballur me rrethana dhe sfida të paparashikuara, si dhe kapacitete për të shfrytëzuar mundësitë që ofrohen për zhvillimin vetjak, përparimin e shoqërisë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Për të zhvilluar këtë kompetencë, shkolla iu krijon nxënësve kushte që të kuptojnë tërësisht ndërvlerësinë ndërmjet dukurive ekonomike, politike dhe kulturore të shoqërisë vendore dhe globale. Ajo mundëson që nxënësit të orientohen drejt së ardhmes, të zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes dhe të jenë të motivuar për të përmbushur objektivat.(MAS 2014,fq 20-21)

Sipërmarrja nuk mund të konsiderohet si lëndë ose program i posaçëm shkollor, por ajo zhvillohet dhe përmbushet përmes një procesi afatgjatë që përfshin mosha të ndryshme të individit që i vogël deri sa të diplomohet dhe më tutje në profesionin që zgjedh të punojë.

2.2.5 Mendimi kritik domosdoshmëri e shekullit të ri

Para se të diskutojmë mësimin e bazuar në probleme si një qasje pedagogjike për të mësuar me anë të të menduarit kritik, është e nevojshme të shpjegojmë se çfarë nënkuptojmë me të menduarit kritik.

Heidegger (1966, f.3) fillon kursin e leksioneve, të mbajtura në viteve 1951 - 1952, në të cilin synon të sensibilizojë njerëzit të kuptojnë se duhet:” Të arrijmë të dimë se çfarë do të thotë të mendojmë, kur ne vetë të përpiqemi të mendojmë. Nëse përpjekja arrin të jetë e suksesshme, ne duhet të jemi të gatshëm për të mësuar të menduarit 'Mason.M(2008)

Mendimi kritik është një aftësi. Shumica e aftësive kërkojnë që njerëzit të njohin fakte dhe të kenë zakone të mira. Një kuzhinier i mirë e ka bërë zakon larjen e duarve. Një skiator i mirë e ka bërë zakon kontrollin e raportit të motit. Disa zakonet janë thelbësore për të qenë një mendimtar i mirë kritik. Jackson.D & Newberry.P ,(2012 ;4)

Më poshtë po japim disa përkufizime për të menduarit kritik:

Të menduarit kritik është të menduarit “jashtë kutisë” duke plotësuar emocionet dhe krijimtarinë tonë. Ai nuk ndodh në një vakum, por zhvillohet në një "mjedis" mendor të përbërë nga përvojat, mendimet dhe ndjenjat tona. Vaughn.L (2008)

“Mendimi kritik,-citon Christine Doddington(2008),-gjykohet gjerësisht si lloji i të menduarit logjik që na ndihmon për të analizuar dhe kuptuar, interpretuar, të gjitha format e situatave apo informacioneve, ashtu si konkluzionet që nxjerrim nga interpretimet tona të shëndosha”(Ennis, 1987, fq.10)

Fillimi për të menduar në mënyrë kritike: njohja e argumenteve. (Bowell& Kemp.G 2002)

“Mendimi kritik është thelbësor për të jetuar në një shoqëri demokratike, sepse ju jeni përgjegjës për marrjen e vendimeve që ndikojnë në jetën tuaj dhe jetën e bashkëqytetarëve tuaj, ju duhet të jeni në gjendje të mendoni me kujdes rreth argumenteve në mënyrë që të bëni zgjedhje më të mira.”

Mendimi kritik është një lloj i rëndësishëm i të menduarit, i cili kërkon përdorimin e proceseve njohëse analitike dhe vlerësuese dhe konsiston kryesisht në analizimin e argumenteve për qëndrueshmëri logjike me qëllim njohjen e anshmërisë dhe arsytimit fals. Nxënësit sot përballen vazhdimisht me informacione të cilat qarkullojnë në kanalet televizive, faqet e internetit dhe rrjetet sociale, por nuk janë verifikuar për saktësi. Për të qenë efektiv në të menduarit kritik kërkon aftësi që do të ndihmojnë në përcaktimin e saktësisë së informacionit dhe që do të ndihmojë në vënien në pah të argumenteve të palogjikshme dhe / ose të gabuara dhe qëndrime, prirje të orientuara drejt hetimit të së vërtetës (Arends. R 2012; 326)

Shpeshherë gjykojmë mendimet e të tjerëve pa vënë në përdorim aftësitë e të menduarit si: të përqëndruarit e vëmendjes, analizën dhe shembujt, dallimin e detajeve dhe krahasimin e tyre, klasifikimin dhe etiketimin e tyre etj ku janë të bazuara aftësitë e të menduarit kritik. Fillimi për të menduar në mënyrë kritike: njohja e argumenteve .Bowell&Gary Kemp (2002 ,4)

Filozofi i shekullit të 20-të Bertrand Russell pohon se është i pasionuar e mbajtja e një opinionin është një shenjë e sigurt e mungesës së arsyeve për të mbështetur opinionin.

Të menduarit kritik ndihmon për të identifikuar të dukshmen dhe mesazhet e fshehura, për të kuptuar procesin me të cilin është ndërtuar një argument citojnë në veprat e tyre (Bowell & Kemp 2002 ;155 dhe Cottrell,S 2005 ;2)

Të menduarit kritik na mundëson të shqyrtojmë mendimet tona dhe të ndërgjegjësohemi për natyrën e tyre. Të mendosh kështu do të thotë që mendimet tona të drejtohen drejt një synimi. (CDE 2006)

Nxënësit duhet të zhvillojnë aftësinë për vlerësuar në mënyrë kritike punën e të tjerëve, mendimet dhe hulumtimet e tyre, të mos pranojnë çdo gjë menjëherë pa dyshuar në saktësinë e tyre, pa analizuar faktet e pa kontrolluar provat. Nxënësit duhet t'i kushtojnë vëmendje asaj që mendojnë dhe si mendojnë (CDE 2006).

Duke menduar kështu nxënësit do të jenë të aftë të përballojnë sfidat dhe do të gjejnë rrugëzgjdhje për t'ia dalë gjithçkaje që mund t'u duket e vështirë, ndoshta dhe e pamundur. Mendimtari kritik duhet të zotërojë shkathtësi të larta të të menduarit ose të ketë aftësinë për të menduar në mënyrë kritike, për të analizuar në mënyrë efektive dhe për të qenë një zgjidhës i aftë problemesh.

Detyra jonë si mësues është që të nxisim te nxënësit tanë të menduarit kritik për t' i bërë të aftë për të nesërmen me sfida

2.2.6 Shprehitë e të menduarit .Zgjidhja e problemeve

Të menduarit, gjuha dhe lënda mësimore ka një marrëdhënie simbiotike me njera-tjetrën. Mësimdhënia e shprehive të të mësuarit arrin rezultate të mira në lëndët e vështira dhe nxënësit arrijnë rezultate të mira, mësimdhënia bëhet më e efektshme kur nxënësit përfshihen në veprimtari të cilat kërkojnë të menduar të pasur. Sa më të forta të jenë bazat e shprehive të të nxënëit të nxënësit aq më i qëndrueshëm bëhet të kuptuarit e koncepteve, fakteve, ideve që ata duhet të mësojnë në klasë(Zwiers.J, 2005)

Shprehitë e të menduarit janë :Analiza 2.Krahasimi 3.Identifikimi i shkakut dhe pasojës 4.Kategorizimi dhe klasifikimi 5.Zgjidhja e problemeve 6.Argumentimi bindës 7.Vënia e vetës në pozitën e tjetrit (Empatia)8.Sinteza 9.Interpretimi 10.Vlerësimi 11.Komunikimi 12.Zbatimi

Të gjitha këto shprehje të të menduarit janë të domosdoshme t'i vëmë në funksion kur jemi në procesin e MBP-së, por ne do të analizojnë zgjidhjen e problemeve si një nga shprehitë e të menduarit kritik që e praktikojmë më tepër kur jemi gjatë procesi të zbatimit të MBP-së.

Në jetë na duhet që çdo ditë të përballemi me shumë probleme, të cilave përpiqemi t'i japim zgjidhje me të gjitha mundësitë tona. Dhe në shkollat tona, ne, mësuesit përpiqemi t'u mësojmë nxënësve t'u bëjnë ballë dhe t'u japin rrugëzgjidhje problemeve që u dalin. Një nga shprehitë e të menduarit është dhe zgjidhja e problemeve “e cila përfshin marrjen e vendimeve, kapërcimin e sfidave dhe pengesave a zotërimin, zgjidhjen e çështjeve, gjetjen e përgjigjeve për pyetjet e vështira ose menaxhimin e çdo rrethanë tjetër në të cilën kërkohet një zgjidhje apo ide.”(Zwiers.J,2005)

Problemet sipas Robert Sternbergut shfaqen në tre lloje 1.Analitike 2.Krijuese 3.Praktike

Zgjidhja e problemeve analitike kërkon analiza të thella për të gjetur zgjidhjen e problemit

Zgjidhja e problemeve krijuese nuk kërkon vetëm një përgjigje .Ajo përfshin dhe procese të tjera të të menduarit si: përfytyrimin, shpikjen, projektimin, dhe shprehje të tjera tejet njerëzore.

Zgjidhja e problemeve praktike i kërkon nxënësve që t'i zbatojnë zgjidhjet dhe në rrethana të jetës së përditshme dhe botës që i rrethon.” Zwiers.J 2005

Çfarë përfitojnë nxënësit nga kjo shprehje e të nxënësve gjatë zbatimit të saj në situata reale të të nxënësve .

Përfitimet janë si mëposhtë: Këmbëngulja; Vënia në kontroll e impulsivitetit; Dëgjimi i të tjerëve me qetësi dhe mirëdashje; Të menduarit fleksibël; Komunikim me qartësi dhe saktësi; Mbledhja e të dhënave përmes të gjitha shqisave; Krjueshmëria, imagjinata dhe

risitë; Të menduarit me ndërvaresi; Të mësuarit e vazhdueshëm. Të gjitha këto nënshprehësi do t'i shërbejnë në jetë nxënësit

Hapat për zgjidhjen e problemit

- 1.**Prano që ka një problem, çështje apo pyetje që duhet zgjidhur
- 2.**Përkufizojeni problemin, shikojni tiparet e tij nga këndvështrime të ndryshme, bëjini pyetje për ta sqaruar.
- 3.**Formuloni një strategji për të gjetur zgjidhjet e mundshme.
- 4.**Gjeni zgjidhje të mundshme dhe merrni në shqyrtim çdo ide që duken si të çmendura, gjeneroni mundësi krijuese, lërinidë të zhvillohen.
- 5.**Analizoni zgjidhjet e mundshme për të veçuar ato më të mirat! Ngrini hipoteza për efektshmërinë dhe mundësinë e realizimit të tyre.
- 6.**Krijoni një mënyrë për të testuar një ose më shumë prej zgjidhjeve më të mira, analizoni ato përpjekje që dështojnë.
- 7** Zbatoni zgjidhjen e përzgjedhur.

Nxënësit duhet t'i kenë parasysh këto hapa jo vetëm kur aplikojnë MBP-në në klasat e tyre, por dhe kur u paraqitet një vështirësi a pengesë, a situatë që lidhte me të përditshmen dhe që kërkon zgjidhje. Zgjidhjet e problemeve rrallë janë lineare në rastet më të shumta, por ato janë ciklike dhe të kuptuarit e tyre do e lehtësojnë punën e nxënësit.(CDE, 2005;fq 11)

KAPITULLI III: MËSIMI PROBLEMOR (MP)VS MËSIMI I BAZUAR NË PROJEKTE (MBP)

3.1 Mësimi problemor (MP)VS Mësimi i Bazuar në Projekte (MBP)

Hyrje

Në kohët që po jetojmë ne, mësuesit jemi të detyruar të rishqyrtojmë mënyrën se si i mësojmë dhe çfarë duhet t'u mësojmë nxënësve tanë për t'i përgatitur ata për këtë kohë sfiduese dhe për të mos i bërë ata thjesht marrës pasivë të njohurive. Për këtë na ndihmojnë këto metoda. Në mësimdhënie aplikohet mësimi problemor dhe mësimi i bazuar në projekte.

Në shumicën e rasteve mësuesit këto dy koncepte i marrin si sinonime me njera-tjetrën (Boud 1985). Kjo ndodh për arsye se midis tyre ka ngjashmëri, por mbi të gjitha ka dallime dhe për ta bërë më të qartë ndryshimin, na duhet t'i analizojmë në terma të përgjithshëm se ku qëndron ky ndryshim .

3.1.1 Mësimi problemor

Mësimi problemor fillesat e tij i ka në shkollat mjekësore në vitet 1960, kur interesi për të u rrit dhe një rritje e tillë mund të shihet në numrin e kurrikulave dhe në faktin se ky lloj të mësuarit na ndihmon për të arritur shumëfishin tonë dhe shpesh për të arritur qëllime të ndryshme arsimore.

Howard Barrows është një nga pionierët kryesorë të Mësimi Problemor dhe ka shkruar gjerësisht në lidhje me të domosdoshmet e MP që kur është zhvilluar dhe aplikuar fillimisht në edukimin mjekësor (Megan Yih Chyn A. Kek Henk Huijser, 2017, fq 15)

Në vitin 1998 Mësimi problemor ishte një vision i ri në edukimin e mësimdhënësve duke e futur si një qasje të re, e cila dilte mbi modelin e mësimdhënies tradicionale (Margot Filipenko & Jo-Anne Naslund 2016 fq3-4)

Është një metodë e të nxënësve ku nxënësit mësojnë përmes zgjidhjes së problemeve dhe reflektimit në përvojat personale të të nxënësve. Të nxënësve e bazuar në probleme e fuqizon

njohurinë e lëndës, fuqizon zhvillimin e shkathtësive të komunikimit, zgjidhjes së situatave problemore dhe shkathtësive për të nxënë të vetudhëhequr. Të nxënit e bazuar në probleme mund të jetë pjesë e një njësie të vetme apo pjesë e një projekti më të madh. (Utecht.J.R 2003

Ky lloj mësimi buron nga teoria konstruktiviste e të mësuarit në të cilën të mësuarit është aktiv Dhe në këtë proces mësuesi është ndihmës. Maggi Savin-Baden në veprën e tij “Facilitating Problem-based Learning” fq 18 citon (Barrows dhe Tamblyn 1980) të cilët theksojnë se ky mësim realizohet vetëm në grupe të vogla nxënësish, duke demonstruar shkathtësi të shumta dhe efektive të komunikimit, si verbale dhe të shkruara (Duch.B.J, Groh & Allen.2001, fq 6)

Nxënësit e shohin se të mësuarit është një proces i vazhdueshëm dhe se gjithmonë do të ekzistojnë çështjet e të mësuarit që duhet të hulumtohen. Përvoja dhe dëshmitë kërkimore tregojnë se mësimi i bazuar në probleme (MP) në masë të madhe përmirëson mjedisin mësimor (. Cavanaugh.C.J 2001)

Megjithatë mund të themi se ka ardhur koha që mësimdhënia e shekullit të XXI nuk kërkon më në mësimdhënie këtë lloj qasje për arsye se : Aftësia kryesore për nxënësit e kërkuar në shekullin e njëzetë është aftësia për t'u marrë me një sasi të madhe informacioni dhe ta kthejnë këtë informacion në 'njohuri', domethënë aftësinë për të zgjedhur dhe manipuluar në mënyrë kritike informacionin dhe duke e kthyer atë në mënyrë krijuese për çdo gjë në kontekstet që duhet të zbatohet.”(Megan Yih Chyn A. Kek and Henk Huijser 2017 ;fq 34-35)

Mësimi problemor përfaqëson një ndryshim të paradigmës nga filozofia tradicionale e mësimdhënies dhe mësimi e cila është më shpesh e bazuar në leksione. Mësimdhënia e mësimi problemor është shumë më e ndryshme nga mësimet tradicionale në klasa dhe shpesh kërkojnë më shumë kohë dhe burime përgatitore për të mbështetur të nxënit e grupeve të vogla

Karakteristikat e mësimit problemor :

- 1.Nxënësit punojnë në grupe të vogla
- 2.Nxënësit zhvillojnë aftësinë e të menduarit kritik
- 3,Nxënësit bëhen të aftë për jetën dhe botën reale
- 5.Mësuesi është lehtësues i punës së nxënësve

Mësimi problemor modelon problemet e botës reale, ai u tregon nxënësve se mësimi mund të bëhet kudo dhe në çdo kohë. Utecht.R.J 2003;6

Teknologjia ka hapur mundësi të shumta për mësuesit dhe nxënësit. Ajo shihet nga të dy palët si një mjet për të zgjidhur problemet, duke aftësuar nxënësin të jetë i suksesshëm në të ardhmen.Mësimi problemor dhe teknologjia u jep nxënësve dhe mësuesve një gamë të gjerë opsionesh, kur ata kërkojnë përgjigje për problemet e botës reale. (Utecht.R.J 2003;16)

Në përfundim mund të themi se mësimi problemor (MP) ofron përvoja autentike që nxisin mësimin aktiv, mbështesin ndërtimin e njohurive, pra integrohet natyrshëm mësimi në shkollë dhe jeta reale; Kjo qasje e kurrikulës gjithashtu adreson standardet shtetërore dhe kombëtare dhe integron disiplina.(Torp.L &Sage,S ,2002;16.) Megjithatë ashtu si shekulli XX i la vendin shekullit XXI ka ardhur koha që MP-ja t`ia lërë vendin MBP-së.

3.1.2Mësimi i bazuar në projekte (MBP)

Mësimi i bazuar në projekte (MBP) ka një traditë e gjatë në shkollat publike të Amerikës, duke u rikthyer në shekullin e 19-të në punën e Francis W. Parker dhe John Dewey. Ideja e mësimit në klasë të bazuar në projekte u përzgjodh nga bujqësia dhe artet industriale dhe, pasi u aplikua fillimisht në shkollat fillore, u zgjerua në të gjitha nivelet e klasës. Fillimisht u përqëndrua në problemet e "botës reale" me rezultate të prekshme dhe të matshme, metoda e projektit u miratua shpejt dhe zbatohet për çdo aktivitet me interes për studentët. (Burlbaw,M.J,Ortwein ,J,M & Williams.K.J 2013)

Mësimi i bazuar në projekte ka qenë për shumë vite dhe është ndërmarrë në mjekësi, inxhinieri, arsim, ekonomi dhe biznes.(Capraro.M.R ,Capraro M.M & Morgan.R.J 2013) citojnë (Dewey, 1938, faqe 25) :’Besimi se arsimi i vërtetë vjen përmes përvojës nuk do të thotë që të gjitha përvojat janë vërtet ose në mënyrë të barabartë edukative’.

Mësimi i bazuar në projekte (MBP) kërkon një forcë profesioniste dhe profesionale të fuqizuar me aftësitë e nevojshme për hartimin e përvojave të nxëniet që maksimizojnë potencialin e nxënësve (. Capraro,M,R & Slough W.S ,2013 ;13)

Nxënësit janë në gjendje të "përdorin ide shkencore për të shpjeguar fenomene shkencore, për të bërë parashikime dhe për të kuptuar përvojën e tyre personale". Në vend të njohurive të fragmentuara dhe inerte, mësimi i tyre është mjaft i pasur dhe konceptet mjaft të ndërlidhura për t'u transferuar lehtësisht në situata të reja. Ne e quajmë strategjinë arsimore që përputhet me këtë kapacitet "Të mësuarit në bazë të projektit". (Karen C. Cohen.C.Karen 2001)

Një projekt i mirë krijon kushte në të cilat studentët janë të detyruar të kërkojnë. Hetimi është rruga personale e marrjes në pyetje, kërkimit dhe arsyetimit që e merr një person nga mosnjohja e diturisë. Krauss.J & Boss,S 2013; 14

Ata mësojnë së bashku dhe nga njëri-tjetri, dhe mësimi i tyre është kuptimplotë(Krauss.J & Boss,S 2013) MBP-ja siguron atë që Dewey (1901)e quajti "kontaktin ballë për ballë të mësuesit dhe fëmijës".(Kliebard.M,H,2002)

Një shembull i mirë i aplikimit të mësimin të bazuar në projekte është ai në shkencat inxhinierike Dizajni i inxhinierisë mund të përfaqësohet duke përdorur një proces shtatë hapash.

Hapi 1: Identifikimi i problemeve dhe pengesave. Duke identifikuar problemin, përshkruajmë qartë dhe në mënyrë të përmbledhur qëllimin e punës së planifikuar. Përveç përcaktimit të qëllimit të projektimit, ekipi duhet të identifikojë të gjitha kufizimet dhe kriteret e përshtatshme si psh koha.

Hapi 2: Hulumtimi Kërkimi i informacionit

Hapi 3: Ideimi përfshin gjenerimin e ideve të shumta të zgjidhjes dhe kreativitetit. Ideimi është një pjesë thelbësore e këtij procesi dhe në këtë fazë duhet të përdoren teknika të ideve si psh Brainstorming për të zhvilluar një listë të plotë të ideve për zgjidhjen e problemit dhe për të identifikuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me secilën ide. Megjithëse shumë besojnë se ata dinë të mendojnë, ata shpesh nuk e kanë zhvilluar me të vërtetë atë si një aftësi ose e kanë kuptuar vlerën e shtuar nga një ide e duhur..


Hapi 4: Analizoni idetë Pasi idetë paraprake janë identifikuar gjatë hapit të ideimit, ato duhet të përpunohen dhe të zhvillohen më plotësisht.

Hapi 5: Ndërtimi Pas aplikimit të matematikës, shkencës dhe teknologjisë për të zhvilluar plotësisht idenë më të mirë të dizajnit, duhet të ndërmerret një përpjekje për të ndërtuar një model pune pune të plotë ose prototip.

Hapi 6: Testimi dhe Përpunimi Performanca e prototipit do të vlerësohet në mënyrë eksperimentale dhe do të testohet në të gjitha kushtet e mundshme. Për çdo vlerësim duhet të regjistrohet dokumentacion i plotë, duke përfshirë parashikimet, kushtet e testimit, vëzhgimet dhe rezultatet.

Hapi 7: Komunikoni dhe reflektoni Dizajnimi i inxhinierisë kërkon komunikim efektiv. kërkojnë përvojë në të paktën katër stile të komunikimit: ndërpersonale, me gojë, vizuale dhe me shkrim Morgan.R., Moon.R.A & Barroso.R.L 2003; 30- 32.

Grafiku 5:Dizenjimi i projektit inxhinierik



Burimi: Morgan.R. Moon.R.A & Barroso.R.L 2003

Një model që u përshtat për mësimdhënien me projekte ishte modeli 5E ku përfshihet 1. Angazhimi-Aktiviteti duhet të bëjë me lidhjet midis përvojave të mësimin të së kaluarës dhe atyre të tanishme të mësimin, duke organizuar të menduarit e nxënësve drejt rezultateve të të nxënës.

2. Hulumtimi: Nxënësit njohuritë paraprake i përdorin për të gjeneruar ide të reja. Ata hulumtojnë në kërkim të informacionit.

3.Shpjegimi mund të vijë nga mësuesi i cili prezanton koncepte, nga nxënësit që punojnë në bashkëpunim dhe nga përvoja.

4.Shtjellimi në të cilin nxënësit i zgjerojnë konceptet e përvetësuar, bëjnë lidhjen midis tyre, zbatojnë njohuri në mjedisin e tyre.

5.Vlerësimi .Faza e vlerësimit inkurajon nxënësit që të vlerësojnë të kuptuarit dhe aftësitë e tyre dhe ofron mundësi për mësuesit që të vlerësojnë përparimin e nxënësve drejt arritjes së objektivit.(Bybee,2006;2)

3.1.3 Historiku i mësimit të bazuar në projekte në Reggio Emilia

Reggio Emilia, është një krahinë e cila ndodhet në pjesën veriore të Italisë. Pas Luftës së Dytë Botërore, në fshatin Cella në këtë krahinë nën udhëheqjen mësuesit Loris Malaguzzi (1920 - 1994), u përhap një lëvizje e cila pati përhapje në të gjithë botën dhe që praktikohet sot e kësaj dite me sukses në edukimin parashkollor. Falë punës së tij ai bëri që në 1963 të hapej shkolla e parë për fëmijë në Reggio Emilia. Malaguzzi qasjen e tij për edukimin parashkollor e shpreh përmes metaforës së murit, si një metaforë për pengesën në zhvillimin e fëmijës.

Sipas tij të gjitha rregullat dhe zakonet e përcaktuara nga modelet tradicionale të arsimit konsiderohen si një mur. Qëllimi i kësaj qasjeje është të shkojë përtej murit. Malaguzzi e shpreh këtë me thënien "nëse syri kërcen mbi mur" (Dalja e Katalogut të Mostra, 1996: 24),-citojnë Coşkun.H & Durakoğlu.A 2015;146

Si bazë ku u mbështet gjithë filozofia e edukimit të Malaguzzit ishte filozofia e Maria Montessorit e cila theksonte se arsimi është për “zbulimin dhe çlirimin” e fëmijës dhe për të problem më i madh është qëndrimi shtypës i të rriturve ndaj fëmijëve. Ndërsa metoda e Montessorit bazohet në një konceptim pedagogjik në të cilin fëmija është aktiv, qasja Reggio Emilia bazohet gjithashtu në argumentin se fëmijët nuk duhet të privohen nga kënaqësia për kërkime dhe kërkesa.

Pedagogjia Malaguzzi ka parësore problemin e "mënyrës së komunikimit me fëmijën" dhe Reggio Emilia u shfaq si një formulë që do të përdoret për eliminimin e këtij problemi

Qasja e Reggio Emilias, ofron :

- ✓ Mjedis të nevojshëm të të mësuarit në aspektin social dhe emocional.
- ✓ Synon të krijojë mjedise ideale arsimore duke vepruar me një parim të lirisë dhe duke theksuar se çdo kulturë duhet të ketë mjedisin e vet specifik arsimor.
- ✓ Liri për mësuesit dhe nxënësit.
- ✓ Ndihmon në përmirësimin e aftësive të zgjidhjes së problemeve.
- ✓ Inkurajohen fëmijët të mendojnë në mënyrë të pavarur.
- ✓ Fëmijët marrin pjesë aktivisht në procesin e edukimi.
- ✓ Përmirësojnë ndjenjën e tyre të përgjegjësisë dhe të vetëbesimit.

Qasja Reggio Emilia është më pak e strukturuar se konceptet e tjera. Ata nuk kanë një kurrikulum formal (të shkruar). Në vend të përdorimit të kurrikulave të paraplanifikuar, një mësues në shkollat parashkollore në Reggio paralajmëron nevojën e fëmijëve për të mësuar. Kurrikula del përmes punës së projektit. Përmbajtja vjen nga kurioziteti i fëmijëve në mësim, dhe nga vëzhgimet e mësuesit lidhur me interesat e fëmijëve. Mësuesit duhet ta ndjekin fëmijën dhe jo planin. Edhe pse mësuesi ndjek vazhdimisht fëmijën nuk do të thotë se nuk ka qëllime të përgjithshme arsimore. Mësuesit nuk kanë qëllime konkrete gjatë projekteve, vendosin vetëm hipotezën për atë që mund të ndodhë, bazuar në njohuritë e tyre dhe përvojat e kaluara në lidhje me fëmijët. Pastaj, formohen qëllimet, të cilat janë fleksibile dhe përshtaten me nevojat dhe interesat e fëmijëve, si dhe me qëllimet që ndjekin edukatorët. Është quajtur Kurrikula emergjente e quan Krooflić, 1997,citon Vodopivec.L 2012; 9)

Mësimi i bazuar në projekte është një nga format e mësimin, e cila përfshin aktivitete që ofrojnë mundësi të ndryshme për fëmijë të tilla si: vënien në praktikë të njohurive të fituara, planifikimin, ndarjen, bashkëpunimin dhe meditimin midis tyre.(Coşkun.H & Durakoğlu.A 2015;151-152)

Cili është roli i mësuesit, nxënësit dhe prindit në qasjen e Reggio Emilias?

Roli i fëmijës Siç theksuam më sipër se qasja Reggio Emilia bazohet gjithashtu në argumentin se fëmijët nuk duhet të privohen nga kënaqësia për kërkime dhe kërkesa. Kjo duhet të bëhet moto për të rriturin i cili duhet të besojë te kreativiteti i fëmijës së tij, te fuqia dhe energjia e talentit të tij. Fëmija vlerësohet dhe rrit kreativitetin e tij në një mjedis të përshtatshëm ku vepron lirshëm

Fëmijët janë në qendër të projekteve. Si një përjasje e përqendruar tek nxënësit, projektet përcaktohen sipas interesave dhe dëshirave të fëmijëve, pas përparimit në zgjedhjet dhe kuriozitetin e tyre.(Inan 2015;738)

Roli i mësuesit merr përmasa të ndryshme Nxënësit e shohin mësuesin si dëgjues dhe vëzhgues të mirë. Ata përpiqen të kuptojnë fjalët, sjelljet, marrëdhëniet me njëri-tjetrin, pyetjet dhe kuriozitetin e fëmijëve (Inan,H.Z & Kayir.G 2015: 734); komunikues i mirë me prindin për të caktuar temat e projektit, por dhe për të siguruar gjithë materialet e nevojshme për projekt. Mësuesit janë parë si nxënës në radhë të parë, ndërsa zhvillimi profesional i tyre konsiderohet të jetë një proces i vazhdueshëm evolucionar që është një pjesë e brendshme e ditës së mësuesit.

Marrëdhënia midis mësuesve dhe fëmijëve i ngjan një loje ping-pongu,- i thotë Malaguzi Gandinit(2011) në një bisedë mes tyre. Ai i krahason ata me të dy lojtarët të cilët duhet të japin kontributet maksimale në këtë lojë. Mjedisi i të nxënës është unik në atë se si hapësira është bashkëkrijuar nga nxënësit dhe mësuesit në klasë. Kjo marrëdhënie bashkëpunuese përbëhet nga shkëmbime reciproke ndërmjet fëmijëve dhe mësuesve në lidhje me përshtatjet e duhura që mund të bëhen për të siguruar rritjen dhe mësimin optimal brenda ambientit të klasës (Hewett, 2001). citon Kelsey Robson,(2016;3/6)

Roli i mësuesit nuk është të shpërndajë informacion ose thjesht të korrigjojë. Përkundrazi, mësuesi është si një mjet që fëmijët e përdorin, kur është më i nevojshme. Ai paraqitet nxënës, hulumtues dhe bashkëpunëtor. (Tarini.Eva & White.Lynn ,2005;376)”

Roli i prindit Prindi është një element shumë i rëndësishëm në edukimin e fëmijëve

Në mësimdhënien tradicionale ata janë vetëm përgjegjës për fëmijët e tyre, ndërsa në qasjen e Reggio Emilia-s ata janë pjesëmarrës aktivë në shkollë, vëzhgojnë orët mësimore dhe ndihmojnë mësuesit në mbarëvajtjen pozitive të fëmijëve të tyre, madje inkurajohen që të përfshihen në klasa, duke punuar drejtpërdrejt me fëmijët.

Prindërit përfshihen në mjedisin arsimor dhe përmes dokumentacionit. Dokumentacioni është një pjesë e rëndësishme e mëimit të bazuar në projekte. Bëhen shumë fotografi, mësuesit mbajnë shënime dhe ditaret e ty, punimet e projektit të nxënësve ku përfshihen vizatime, vepra 3D ruhen, ndahen më pas me familjet dhe stafin tjetër të shkollës në një mur ekspozues. Kjo tregon qartë për punën në klasë e shkollë. Ky dokumentacion nuk mund të jetë i pasur pa praninë e prindërve në të. Duke shërbyer si një urë midis shtëpisë dhe shkollës, dokumentacioni forcon komunikimin mes mësuesve, nxënësve dhe prindërve. Falë dokumentacionit, prindërit mund të informohen për atë po ndodh në klasë. Për më tepër, dokumentacioni u siguron prindërve mundësinë për të bashkëpunuar me shkollën (Inan, 2015: 734).

Marrëdhënia që ekziston midis shkollës dhe prindërve në Reggio është shumë e veçantë. Partneriteti cili përfshin përfshirjen reciproke dhe respektin e ndërsjellë.

Gjatë viteve të fundit, si shkollat parashkollore të Reggio Emilia, Itali, janë bërë gjithnjë e më të njohur në Shtetet e Bashkuara, duke rritur kështu rëndësinë e tyre për arsimin amerikan. Në vitin 1983, Sekretari i Arsimit, Ted Bell, lëshoi një raport të quajtur “Kombi në Rrezik” i cili pasqyronte përmbledhjen e fakteve që po ndodhnin në arsimin amerikan, i cili po dështonte dhe ishte në telashe dhe për shkak të eksperimenteve të shumta që po bëheshin me të. Kështu 2000 amerikanë nga Washington DC, Boston, Detroit në 1993 vizituan shkollat e Reggio Emilia-s (Lewin.et.al;336)

Në kthimin e mësuesve filloi një përpjekje për të përshtatur qasjen e Reggio Emilia-s duke shpërndarë praktikat e mësimdhënies, përvojën e bashkëpunimit mes mësuesve dhe fëmijëve, respektin, besimin e mësuesve për fëmijët, punën e mësuesve si hulumtues dhe

punën e fëmijëve në projekte të cilat mund të zgjasin për muaj apo edhe nga një vit shkollor në tjetrin. (Lewin .et.al ;342)

Kjo ishte një qasje e panjohur për shkollat e këtyre vendeve, ndaj dhe po bëheshin përpjekje për krijimin e shkollave novative duke ripërpunuar gjithë mjedisin. Filozofia e Reggio Emilias filloi të përhapej me shpejtësi, por jo pa telashe, pasi përqafimi i qasjeve të reja në institucionet arsimore është shumë e vështirë.

Ky bashkëpunim mbeti një vlerë dhe mbetet një shembull i punës dhe angazhimit më cilësor të edukatorëve, fëmijëve dhe prindërve duke ndërtuar një urë midis dy kulturave kulturën e një qyteti të vogël në veri të Italisë, dhe qyteteve të mëdha në Shtetet e Bashkuara. Ishte një gjë e mrekullueshme një sfidë dhe qëndron si frymëzim për këdo që beson në fuqinë e një mendjen e fëmijës së vogël.

3.1.4 Mësimi i bazuar në projekte (MBP) dhe karakteristikat e tij

Mësimi i bazuar në projekte metodë në të cilën nxënësit punojnë së bashku për të hulumtuar çështje dhe probleme të jetës reale, duke përdorur strategji të zgjidhjes së problemeve dhe burime të ndryshme në mënyrë që të prodhojnë një produkt final.

Një projekt duhet të jetë për nxënësit një eksperiencë serioze, nuk është “ëmbëlsira që ju i shërbeni nxënësve, por “pjata kryesore” që organizon gjithë njësinë mësimore. Gjatë kohës që ne përdorim termin mësimdhënie e bazuar në projekte MBP ne përfshijmë dhe disa metoda të cilat janë të ngjashme si mësimi i bazuar në probleme (MBP), sfidat e dizajnit, mësimi në hetim. Disa autorë të tjerë i dallojnë këto nga mësimi i bazuar në projekte por në fakt dhe këto metoda mësimdhënie janë të ngjajshme me mësimin e bazuar në projekte. (Larmer, Ross, & Mergendoller, 2017; 5-7)

3.1.5 Elementet e projektit

Sipas Dayna Laur (2013)dhe April Smith(2018) elementet që përbëjnë një projekt janë këto:

Përmbajtje e rëndësishme. Projekti duhet të fokusohet te dijet dhe aftësitë bazuar në kurrikul, ndaj zgjedhja e temës është shumë e rëndësishme.

Kompetencat e shekullit 21. Smith përmend kompetenca të tilla si zgjidhja e problemeve, mendimi kritik, bashkëpunimi, kreativiteti, komunikimi, kompetenca thelbësore këto për kohën që po jetojmë. Të gjitha këto aftësi duhen shpjeguar nxënësve ndërmjet strukturës së projektit. Këto aftësi ndërkurrikulare të cilat synon të zhvillojë kurrikula e arsimit parauniversitar do t'i gjeni të shpjeguara dhe më poshtë.

Vëzhgimi i thellë. Nxënësit duhet të thellohen në kërkime rreth temës që ata do të hulumtojnë.

Bërja e pyetjeve Është një nga elementet më të rëndësishme të projektit si në fillim dhe në fund të tij.

Nevoja e dijes. Projekti duhet të vendoset në kontekst realist se vetëm kështu mund t'i tregojmë nxënësve se si mund të mësojnë.

Zëri dhe zgjedhja. Mësuesi duhet t'i lejojë nxënësit të marrin vetë vendimet, por kjo nuk do të thotë të bëjnë si duan ata, por duhet të jenë vetë ata që të zgjedhin produktin përfundimtar.

Kritika dhe rishikimi/reflektimi i ndihmon nxënësit të marrin feedback /prapaveprim për atë çka kanë bërë dhe në të ardhmen të përmirësojnë punën e tyre. Mbajtja e shënimeve gjatë kohës së projektit dhe ruajtja e tyre janë të rëndësishme për këtë element.

Prezantimi i produktit final në shumicën e rasteve duhet të bëhet jashtë klasës, madje dhe jashtë shkollës para një audience të kuptueshme (Smith .A ,2018;14-16)

3.1.6 Karakteristikat e mësimit të bazuar në projekte

1.Nxënësit punojnë në grupe dhe nxiten të mësojnë “duke bërë” duke pasur parasysh faktin se “Një ekip i mirë ka nevojë për një përzierje aftësish. (”Boss&Krauss 2007;77)

2.Nxënësit zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik dhe kreativ.

3..Hulumtim i pavarur duke përdorur burime të ndryshme informacioni.

4.Mësuesi luan rolin e lehtësuesit të procesit.

5.Çështjet që trajtohen lidhen me jetën reale.


6.Kohëzgjatja e tij varion nga 2-4 javë, por me kurrikulën tonë mund të vazhdojë 3 muaj ose një vit dhe përfshin më tepër se një njësi mësimore .

7.Produkti final mund të jetë një poster, një prezantim në PPT, në video-film, një lojë.

3.1.7 Cikli i projektit mësimor

Si çdo gjë e ka një cikël dhe projekti e ka një cikël të tij, i cili fillon me krijimin e situatës problemore, me hartimin e një plani i cili përfshin përcaktimin e problemit dhe të produkteve të projektit, orarin e zbatimit të projektit, zbatimin e projektit, monitorimin dhe vlerësimin e tij.

Diagrama 6:Paraqitja skematike e ciklit të projektit si mëposhtë:



E fillojmë analizën me **situatën problemore**. Situata problemore joefektive nuk është motivuese për nxënësin, ndaj duhet të përzgjidhet me kujdes. Duhet që problemet të mos

jenë shumë të thjeshta, pasi zgjidhja e tyre do të ndodhi që në diskutimet e para. E kjo fillon me hartimin e “pyetjes së madhe” Një pyetje që një nxënës mund të përpiqet t'i përgjigjet nëpërmjet përdorimit të të menduarit shkencor është quajtur një pyetje e hetueshme.

Një pyetje e hetueshme e formuluar mirë do të sugjerojë se si do të hulumtojnë nxënësit për gjetjen e një përgjigjeje. Ndoshta do të vijë si befasi më e mira. (Settlage.J & Sherry A. 2007 ;166)

“Pyetja e madhe “ka disa karakteristika të cilat duhet të kihen parasysh për faktin se një pyetje e ndërtuar pa kujdes ose mund të gjejë përgjigje të menjëhershme, ose nuk sjell rezultatin që dëshirojmë. Pyetja e madhe duhet të jetë :

- ✓ E arritshme: Nxënësit duhet të jenë në gjendje të krijojnë dhe kryejnë hetime për t'iu përgjigjur pyetjes.
- ✓ E vlefshme: Pyetjet duhet të lidhen me përmbajtjen dhe procesin që përputhet me standardet e kurrikulës.
- ✓ E kontekstualizuar: Pyetjet duhet të jenë të përfshira në jetën e nxënësve dhe botën reale
- ✓ E qëndrueshme: Pyetjet duhet t'i mbajnë nxënësit me interes për javë të tëra, pasi gjejnë zgjidhje për pyetjet e drejtimit.
- ✓ E kuptimshme: Pyetjet duhet të jenë interesante dhe emocionuese për nxënësit.
- ✓ Etike: Gjetja e zgjidhjeve për pyetjet nuk duhet të dëmtojë organizmat e gjallë ose mjedisin (Krajcik.S.Josef 2001;15-16)

Plani ka të bëjë se me cilat qëllime kurrikulare do të realizohen duke iu përgjigjur”pyetjes së madhe” Plani përmban tri fazat kryesore të cilat janë sqaruar te orët mësimore të dhëna mëposhtë

1)Aktivitetet përgatitore të projektit

2Aktivitetet që përfshijnë nxënësit në procesin e të mësuarit

3. Aktivitetet dhe produktet e projektit

Një moment tjetër i rëndësishëm gjatë aplikimit të MBP-së në klasa është dhe **zbatimi i orarit** i cili ka të bëjë me respektimin nga ana e nxënëve të kohës së sjelljes së materialeve apo produkteve të projektit.

Koha /orari në një projekt është një nga elementet më të rëndësishme organizative. Në shkollat e Reggio Emilia-s u jepet shumë kohë për të hulumtuar në projekte afatgjata. Mësuesit janë shumë të vëmendshëm dhe të respektueshëm për kohën e fëmijëve, duke u dhënë atyre kohën që duhet duke filluar që nga procesi i informacionit, për të ardhur në një nivel të ri të të kuptuarit dhe për të ndërtuar njohuri të reja.

Monitorimi është pjesë përbërëse e projektit në të cilën monitorohen aktivitetet dhe mbahen shënime për çfarë është bërë.

Vlerësimi i nxënësve si pjesa e fundit, por jo më pak e rëndësishme e këtij cikli orientohet në produkt dhe në proces. Ky do të jetë vlerësim formativ dhe sumativ. Produktet duhet të jenë në përputhje me objektivat e programit lëndor.

Kujdes ! Shpeshherë në projektet tematike produkti është maskuar nga magjia dixhitale. Nxënësit mund të krijojnë broshura tërheqëse, slideshows, podkaste dhe media të tjera për të transmetuar informacion, por përmbajtja është shpesh e njëjtë si ato që mund të gjenden në një libër referimi, në internet ose në një raport tradicional.(Krauss .J& Boss.S, 2013; 9)

Klasifikimi projekteve kurrikulare/mësimore

Projektet kurrikulare i ndajmë në shkollore dhe lëndore ose të mësuesit. Le t'i shpjegojmë :

Projekti kurrikular shkollor i takon planit të shkollës. Secili nxënës, gjatë tre viteve të gjimnazit, duhet të marrë pjesë në projekte të tilla në të paktën 18 orë mësimore. Ky numër i caktuar orësh është i detyruar për arsimin e mesëm të lartë. Pra, kjo vlen për gjimnazin, ndërsa nëse do flasim për arsimin e mesëm të ulët nga orët që mësuesi i çdo lënde ka në dispozicion të përpunimit të njohurive 2 orë prej tyre ia “dorëzon ” drejtorisë së shkollës e cila i organizon këto orë në projektet kurrikulare ndërlëndore.

Dy llojet e tjera i takojnë planit mësimor të mësuesit. Këto projekte llogariten në totalin e orëve të programit lëndor.

Mësuesi mund të zgjedhë projektin kurrikular dhe si metodë për të shtjelluar njohuritë e reja. Projektet kurrikulare janë edhe pjesë e përhershme e përpunimit të njohurive. Në projekte të tilla nxënësve nuk u kërkohet të mbajnë mend njohuri të reja.

Projektet kurrikulare mund të jenë thjesht lëndore ose ndërlëndore, pra mund t'i përkasin një fushe të nxëni ose të shtrihen në më shumë se një fushë. Një projekt kurrikular zgjat disa ditë ose pak javë, por edhe disa muaj. Këto mbyllen brenda një viti shkollor, por mund të shtrihen edhe më tej duke u rimarrë në një vit pasardhës më thellë ose/dhe më gjerë. Një projekt mund të merret përsipër vetëm nga një mësues, kur është lëndor dhe më shumë se një mësues, kur është ndërlëndor. Çdo mësues i llogarit në planin e vet mësimor, numrin e orëve mësimore të cilat i duhen në paraqitjen e një projekti të përbashkët.

Kujdes ! Projektet ndërlëndore, ku merr pjesë më shumë se një mësues, miratohen nga ekipi kurrikular i shkollës.(UMB 2015 ;20)

Projektet kurrikulare mund të përdoren si pjesë e përpunimit të njohurive dhe projekte kurrikulare si metodë për përvetësimin e njohurive të reja .

3.1.8 Projektet kurrikulare si pjesë e përpunimit të njohurive.

Projektet kurrikulare mund të përdoren si pjesë e përpunimit të njohurive.

Zakonisht në të përditshmen tonë jemi mësuar që pas disa kapitujve të bëjmë përsëritje për të përforcuar njohuritë e marra më parë. Përdorimi i projekteve kurrikulare në këtë rast do të thotë të kombinosh njohuritë e disa kapitujve të një lënde për të zgjidhur një situatë problemore. Mësuesi duhet të veçojë e të rendisë ato njohuri të cilat ka për objektiv t'i përforcojë e thellojë nëpërmjet kësaj përsëritje të integruar që është projekti kurrikular.

3.1.9 Projekte kurrikulare si metodë për përvetësimin e njohurive të reja .

Projekte kurrikulare mund të përdoren si metodë për përvetësimin e njohurive të reja .Një nga strategjitë për të përvetësuar njohuritë e reja janë dhe projekteve kurrikulare të cilat shtjellojnë njohuritë e reja që parashikohen në programin lëndor.

Po japim një shembull të zbatimit të orëve të MBP-së në shkollat e arsimit parauniversitar të përshtatur nga autorja e punimit në Librin e mësuesit “Gjuhë shqipe 8 Shtëpia botuese “Pegi”(Myrtaj,L 2017)

Tabela :3 Zbatimi i MBP në klasë -ora 1

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore. Projekt Ndikimi i internetit dhe librit në zhvillimin e aftësive psikomotore të nxënësve ORA 1		Situata e të nxënit: Ndarja e punëve	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe 1- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 2 -Kompetenca e të menduarit. 3-Kompetenca personale 4-Kompetenca për jetë,sipërmarrje dhe mjedis 5-Kompetenca qytetare 6- Kompetenca digitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	

Nxënësi: Diskuton për rëndësinë e librit të shkruar Analizon lidhjen midis internetit dhe librit të shkruar Diskuton për shfrytëzimin e kohës së lirë nga fëmijët Merr pjesë aktive në punën në grup dhe ndarjen e detyrave në të Përzgjedh materialet e duhura për produktet finale Bën sistemimin e materialeve të përgatitura për prezantim Drejton punën në grup Prezanton produktet e projektit	Internet Web facebook rrjete sociale libër subjekt mesazh
Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK
<i>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Mendo/puno ë dyshe/shkëmbe mendime, Të nxënëët në bashkëpunim</i> <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Mendo/puno ë dyshe/shkëmbe mendime</i> Faza 1 Aktivitetet parapërgatitore të projektit Njohja me temën e projektit. Pavarësisht se është ora e parë nxënësve për projektin u është folur që në fillim të vitit që ata të marrin masa për hulumtim dhe mos ta lënë punën vetëm	

në ditët që kanë projektin.

Formimi i grupeve të nxënësve dhe ndarja e detyrave brenda grupit.

Grupet brenda klasës formohen heterogjene me nxënës me përparim të mirë, mesatar apo të dobët. Nxënësit duhet të bashkëveprojnë me njeri-tjetrin, pasi gjatë orës së projekteve nxënësit duhet të mësojnë duke u argëtuar.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Po japim më poshtë një model të planifikimit të projektit

Titulli	Një emër/ Titull tërheqës projekti.
Kohëzgjatja	Data e fillimit dhe mbarimit të projektit
Qëllimi	Çfarë do të nxënë nxënësit? Tregohet se si klasat pjesëmarrëse do të përfitojnë nga përvojat e tyre me ju.
Lendet	Lista e fushave të kurrikulës, të cilave do t'ju adresohet ky projekt.
Pjesëmarrësit	Mësues, nxënësit sipas nivelit.
Përshkrimi	Paragrafë të shkurtër, të cilët përshkruajnë projektin që të tërheqë interesin e lexuesit.
Veprimtaritë sipas linjave kohore.	Përshkrim i asaj që nxënësit do të kryejnë sipas afateve: - Zgjidhje problemesh. - Grumbullim informacioni. - Shkëmbime nderpersonale. - Vëzhgime. - Diskutime. - Vlerësime.

Burime të të kërkuara	Lista e burimeve.
Rezultatet	Produkte perfundimtare.
Përfitimet	
Vlerësimi	

Pra, nxënësit duhet të jenë të aftësuar për atë që do të bëjnë.

Qëllimi i projektit

Projekti ka si detyrë t'i pajisë nxënësit me kompetencat e mësipërme dhe të përforcojë disa rezultate të të nxëni sipas kompetencave të fushave

Në fund të projektit nxënësi duhet të arrijë:

- *të prezantojë produktet finale të projektit që kanë ardhur si rezultat i punës në grup apo individuale*
- *të argumentojë atë që ka sjellë në produkt*
- *të interpretojë cdo qasje të tij*

Grupi 1: Problemet e fëmijëve autike.

Grupi 2: Si ndikon libri te fëmijët.

Grupi 3: Interneti ndikon pozitivisht apo negativisht te fëmijët ?

Grupi 4: Interneti apo Libri ? Cili ka zhvillim me të gjerë ?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: të nxënësit në bashkëpunim

Nxënësit pasi kanë ndarë grupet dhe kanë caktuar nëntemat nxënësit bashkëpunojnë me njëri- tjetrin për të caktuar mënyrën e përgatitjes së produktet që do të prezantojnë në orën e fundit.

<i>Ai mund të jetë :</i> -Prezantim ne powerpoint -fletëpalosje -postera -revistë apo gazetë faqe web-i

Tabela 4:Zbatimi i MPB-së në klasë -Ora 2-3

Tema mësimore. Ndikimi i internetit dhe librit ne zhvillimin e aftesive psikomotore të nxënësve ORA 2	Situata e të nxënit: Seleksionimi i materialeve
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe -Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 2. Kompetenca e të menduarit. 3 Kompetenca personale. 4.Kompetenca për jetë,sipërmarrje dhe mjedis 5.Kompetenca qytetare 6.Kompetenca digjitale	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: Diskuton për rëndësinë e librit të shkruar. Analizon lidhjen midis internetit dhe librit të shkruar. Diskuton për shfrytëzimin e kohës së lirë nga fëmijët. Merr pjesë aktive në punën në grup dhe	Fjalët kyçe: Internet Web facebook rrjete sociale libër subjekt

ndarjen e detyrave në të . Përzgjedh materialet e duhura për produktet finale. Bën sistemimin e materialeve të përgatitura për prezantim Drejton punën në grup Prezanton produktet e projektit	mesazh
Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Të nxënë të bashkëpunim, bashkëbisedim. Faza 2: -Përpunimi i materialeve. -Krijimi i posterave -Krijimi i punimit në poërpoin -Krijimi i videos me mendime të nxënësve ▶ Kërkimi në internet i shfrytëzimit të internetit në jetën e përditshme ▶ Krijimi i fletëpalosjeve dhe posterave ku shprehin mendimin e tyre për librin e shkruar dhe dhe zhvillim psikomotor të nxënësve ▶ Krijimi i një videoje me mendimet e nxënësve në lidhje me internetin dhe librin. Nxënësit punojnë sipas punës së caktuar . Kordinatori i grupit është i vëmendshëm për punën që kryen secili nga anëtarët e	

grupit dhe bën vlerësimin e anëtarëve Vini re ! Në këtë fazë nxënësit duhet të mbledhin materialin në" burim ", pranë institucioneve të ndryshme për të kryer intervista dhe pyetësorë minimaliste.			
Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për bashkëpunimin e tyre dhe kryerjen e detyrave të ngarkuara			
Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore. Ndikimi i internetit dhe librit ne zhvillimin e aftesive psikomotore të nxënësve ORA 3		Situata e të nxënit: Prezantimi i materialit	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe 1 Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.2 Kompetenca e të menduarit.3 Kompetenca personale4 Kompetenca për jetë, sipërmarrje dhe mjedis 5 Kompetenca qytetare 6 Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: Diskuton për rëndësinë e librit të shkruar Analizon lidhjen midis internetit dhe librit të shkruar Diskuton për shfrytëzimin e kohës së lirë nga fëmijët Merr pjesë aktive në punën në grup dhe ndarjen e		Fjalët kyçe: Internet Web facebook rrjete sociale libër	

detyrave në të Përzgjedh materialet e duhura për produktet finale Bën sistemimin e materialeve të përgatitura për prezantim Drejton punën në grup Prezanton produktet e projektit	subjekt mesazh
Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK
<i>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Të nxënë të bashkëpunim, Bashkëbisedim</i> Faza 3: Aktivitet në të cilin nxënësit prezantojnë rezultatet e punës së tyre si prezantime, tabela dhe albume. <i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:</i> Në këtë fazë do të vlerësohen nxënësit. Mësuesja duhet të jetë transparente në vlerësim, po kështu dhe pjesëtarët e grupit me njeri-tjetrin. Më poshtë do t'ju sugjerojmë mbajtjen e disa evidencave në secilën prej orëve të projektit, evidenca që do t'ju lehtësojnë vlerësimin e nxënësve dhe ata do të jenë më të qartë me veten. Tabelat përmbajnë kritet për vlerësim të cilat u bëhen me dije nxënësve me fillimin e vitit shkollor. Plotësimi i kriterëve për vlerësim. Monitorimi i zbatimit të detyrave. <i>Grupi 1</i>	

		Detyrat	Personat përgjegjës	Afati	Komente	
Pl	Planifikuar	Diskutimi i ideve dhe mendimeve për përgatitjen e prezantimit teknologjisë si koncept		05.12.2016	Nxënësit dhanë ide interesante dhe bashkëpunuan për realizimin e tyre	
Re	Realizuar	+		05.12.2016		
Pl	Planifikuar	Punë në klasë		06.12.2016	Punë me fletëpalosje, vizatime	
Re	Realizuar	+		05.12.2016		
Pl	Planifikuar	Përgatitja dhe hedhja e të dhënave në një tabela dhe ndërtimi i posterave dhe albumeve apo dosjeve të punës		06.12.2016	Krijimi i posterave për teknologjinë në shërbim të njerëzimit	
Re	Realizuar	+				
Pl	Planifikuar	Prezantimi i produktit		09.12.2016	Prezantim suksesshëm	i i
	Realizuar	+		09.12.2016	punimeve duke shfaqur në mënyrë të qartë e konçize të gjitha llojet e	

					përgatitjeve të bëra
--	--	--	--	--	----------------------

Fletëvlerësimi për menaxhimin individual të kohës (Vlerësimi në pikë)

Dita 1

Vini re ! Fletëvlerësim plotësohet për secilën ditë të projektit!

	Kriteret Nxënësit	Kohën e shfrytëzon në mënyrë racionale	Bashkëpunon me anëtarët e tjerë të grupit	Kryen detyrat në kohë	Vlerësimi ditor
1	Luiza Myrtaj	10	10	10	10
2		10	10	10	10
3		10	10	10	10
4		9	8	9	9
5		9	9	8	9
6		9	9	8	9

Fletëvlerësimi për bashkëpunimin brenda grupit (Vlerësimi në pikë)

Dita 1

	Kriteret Nxënësit	Anëtarët e grupit e ndihmojnë njëri tjetrin	Të gjithë marrin pjesë në mënyrë të barabartë në realizimin e projektit	Vlerësimi ditor
25	X	10	10	10
26	Y	9	10	10

U komunikohet dhe argumentohet vlerësimi nxënësve, pas prezantimit.

Burimi : Larmer, John & Ross. David & Mergendoller.R.John 2009 Project Based Learning (PBL)Starter fq 13.

(Dispozitat Normative 2013&Lila.A.&Hoxha.F,2011,IZHA(2016,2017;Myrtaj.L(2017)

Në fund të analizës sonë rreth karakteristikave, elemeteve përbërëse, aftësive dhe shkathtësive që krijojnë nxënësit gjatë përdorimit të MP dhe MBP kemi hartuar një tabelë e cila na paraqet dallimet dhe të përbashkëtat që kanë këto metoda mësimdhënie.

Tabela 5:Mësimi problemor (MP)VS Mësimi të bazuar në projekte

Mësimi Problemor –MP	Mësimi i bazuar në projekte –MBP
Një njësi ose një temë e cila mund të trajtohet brenda një ore për zgjidhjen e problemit, që mund të përdoret si qasje e tërë metodologjike.	Një cikël që ka një fillim dhe një përfundim Brenda një afati të përcaktuar kohor
Zgjidhja e problemit mund të jetë pjesë e procesit, por fokusi është në menaxhimin e problemeve, jo në një zgjidhje të qartë dhe të kufizuar	Nxënësve u kërkohet të prodhojnë një zgjidhje ose strategji për të zgjidhur problemin,
Nxënësit nuk kanë në fokus këtë lloj rezultati.	Nxënësit duhet të japin një rezultat në formën e një raporti apo dizajni,
Mbështetet në situatën problemore, të cilën duhet ta krijojë mësuesi	Nxënësit e zgjedhin vetë situatën problemore nganjëherë nga një listë e paracaktuar
Një strategji e përgjithshme arsimore	Shihet më shpesh si një teknikë mësimore në një fushë të caktuar të kurrikulës
Shihet si një mjet për t'i ndihmuar studentët të mësojnë përmbajtje, të bëhen kompetentë në zbatimin e njohurive në kontekst për zgjidhjen, dhe ndoshta menaxhimin e	Njohuritë e fituara në klasë zbatohen në praktikë .Nxënësit nuk janë konsumatorë të informacionit, por janë prodhuesit e tij

problemeve fq 17-18-19-30	
Mësuesi lehtësues i procesit	Mësuesi udhëheqës -drejtues dhe menaxhues i procesit
Të përbashkëtat Nxënësit krijojnë mes tyre raporte pozitive dhe bashkëpunuese Nxënësit plotësojnë nevojat me nivele të ndryshme të shkathtësive dhe stile të ndryshme të të nxënit Motivim i nxënësve jo aktivë në mësim	

Burimi :Përshtatur nga unë mbështetur Maggi Savin-Baden "Facilitating Problem-based Learning" fq 18-19

3.1.10 Përparësitë e mësimit të bazuar në projekte në raport me mësimdhënien tradicionale

Pasi analizuam ndryshimin midis mësimit problemor dhe mësimit të bazuar në projekte, bëjmë dhe një përqasje e themi disa nga arsyet pse mësimi i bazuar në projekte (MBP) është më mirë për t'u përdorur në klasat tona përballë mësimit tradicional.

Mësimi i bazuar në projekte integron njohjen dhe veprimin", kur nxënësi zbaton ato që di për të zgjidhur problemet autentike me synimet për të prodhuar rezultate që kanë rëndësi.

Përballja e nxënësve me problemet e jetës reale

Mësimi i bazuar në projekte fokusohet në aftësimin e nxënësit për t'u përballur me situatat e botës reale të simuluar në format e projekteve. Nxënësit mësojnë duke bërë atë që dinë dhe zhvillojnë mësim të reja rreth hobeve, pasioneve të tyre. Mësimi i bazuar në projekte ofron mënyra unike për zgjidhjen e problemeve të ndryshme më të cilat mund të përballen nxënësit në botën reale, por që mësimdhënia tradicionale e cila ka esë me bazë pyetje /

përgjigje dhe shkrime provimi, apo detyrat që u jepen të gjithë nxënësve të klasës nuk ua mundëson.

Përmirëson aftësitë ndërpersonale të nxënësit

Ashtu siç kemi thënë dhe në kapitujt më sipër MBP-ja ndikon në masë të madhe në zhvillimin e aftësive ndërpersonale të nxënësve. Projektet e dhëna shpesh janë më komplekse sesa në detyrat e dhëna në mësimin tradicional të bazuar në klasë. Nxënësit organizojnë anketa për projektet, analizojnë rezultatet e anketës, përgatisin raporte dhe bashkëpunojnë për produktet e projekteve duke përmirësuar aftësitë e tyre të komunikimit dhe të bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm.

Lind dhe zhvillon kreativitetin e nxënësve

Gjatë aplikimit të mësimin të bazuar në projekte kuptimi i koncepteve zhvillohet më në thellësi sesa mund të bazohemi në mësimin tradicional . Kjo duket në nivelet e krijimtarisë së nxënësve të cilat sa vijnë dhe përmirësohen.

Vizitat në terren. Të mësuarit e bazuar në projekte (MBP) në raport me mësimdhënien tradicionale nuk mund të kuptohet pa vizitat në terren nga nxënësit dhe mësuesit. Këto vizita u mësojnë nxënësve mënyra të reja të të mësuarit dhe të të bashkëpunuarit me palët e interesuara dhe njerëzit e rinj.

Zhvillimi i aftësive që kërkon shekulli i ri/e ardhmja

Në raport me mësimdhënien tradicionale, në të nxënësit e bazuar në projekte, përmes strukturës së projektit nxënësit i nënshtrohen fazave të ndryshme të zgjidhjes së problemeve .Këto faza janë : qëllimi i projektit, planifikimi i punës, kryerja e veprimtarive dhe menaxhimi i tyre menaxhimi i pasigurive të paraqitura gjatë aktiviteteve të zgjidhjes së problemeve të projektit, prezantimi i projektit, mbyllja. Gjatë kësaj kohe nxënësit kanë mundësi të zhvillojnë aftësi të vëzhgimit, hulumtimit, raportimit, prezantimit, komunikimit dhe bashkëpunimit me njerëzit e përfshirë, ndërtimin e ekipit dhe udhëheqjen në qasjen e zgjidhjes së problemeve .

Përfshirja e teknologjisë

Mësimi i bazuar në projekte është një mënyrë efektive për përfshirjen e teknologjisë në laboratorët e të mësuarit të sistemit arsimor. Projektet e përzgjedhura nga nxënësit sipas interesit të tyre përfshijnë kompjuterë dhe internet, si dhe tabelat interaktive, e shumë mjete të tjera që i vijnë në ndihmë.⁵

3.2.1 Pse duhet të përdorim MBP sot në klasat tona?

Funksioni themelor i çdo klase është realizimi i mësimi e për këtë arsye klasa duhet të jetë më efektive dhe më produktive. Klasa e shekullit 21 ka në qendër nxënësin, zhvillimin i tij, stilet e të nxënit të tij dhe dallon nga klasa tradicionale nga mënyra se si sillen nxënësit dhe mësuesit të cilët mundohen të fitojë ndjenjë për idenditet.

Programi në klasën e shekullit 21 është fleksibël, sipas nevojave konkrete të nxënësve, nisur nga interesat e tyre. Motivimi i nxënësve luan një rol shumë të madh. Suksesi i tyre ndiqet dhe raportohet te prindërit të cilët janë partnerë dhe marrin pjesë në suksesin e vështirë të fëmijëve. Gjatë zhvillimit të mësimi të bazuar në projekte duhet të krijohet një klimë pozitive në klasë. Kjo klimë pozitive përfshinte përfshirjen e nxënësve në vendimmarrje; energji pozitive nga të dy palët nxënës dhe mësues; atmosferë besueshmërie nxënës –nxënës dhe mësues-nxënës dhe motivimin e nxënësve në rrugën drejt suksesit

Terry Barret 2006 në artikullin “A problem as a provoker of a space betwixt and between old and new ways of knowing” citon : ”MBP nuk është një teknikë e thjeshtë mësimi, por një strategji gjithëpërfshirëse e edukimit e mbështetur nga parimet filozofike” Mësimi i bazuar në projekte një rrugë e qasjes ndaj kompetencave

⁵ <https://elearningindustry.com/project-based-learning-better-traditional-classroom> parë më 30 mars 2017

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies që mund të zbatohen gjatë një ore mësimi, janë të shumta. Projektet kurrikulare janë modele të veprimitarisë mësimore, realizimi i të cilëve kërkon zbatimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: kërkimi, intervista, vrojtimi, studimi i rastit, ndërthurjen e të gjitha këtyre teknikave së bashku. Këto metoda e vënë theksin te aftësitë dhe te shprehjetë. “MBP është një strategji mësimdhënie me në qendër nxënësit që përfshin një qasje dinamike në klasë, në të cilën besohet se nxënësit fitojnë njohuri më të thella përmes eksplorimit aktiv të sfidave dhe problemeve të botës reale” ([Wikipedia, the free encyclopedia](#))

Rreth viteve 2008 dëgjova në Kosovë se në një shkollë jopublike “Mileniumi 3” zhvillohej mësimi i bazuar në projekte e ideuar në një javë të plotë që quhej “Java e projekteve”. Nuk ngurova aspak të trajnohesha për këtë risi dhe ta aplikoj në shkollën jopublike “Albanët “në të cilën unë punoja asokohe. Nxënësve u jepej një “menu” me disa tema të cilat kishin lidhje drejtpërdrejt me realitetin, tema nga të cilat nxënësit mësonin shumë. Nxënësit të ndarë në grupe shfrytëzonin stilet e të nxënësve dhe inteligjencat e tyre të shumëfishta, me qëllim që produkti përfundimtar të ishte cilësor. Pas mbarimit të projektit e prezantimit të tij nxënësit pyeteshin se si shkoi procesi .

Në artikullin e shkruar nga Dayna Laur të publikuar në Education World më 2013 ajo përshkruan elementet (të cilat ne i kemi cituar më lart dhe nga Smith)që mësuesit duhet të marrin parasysh, kur të zbatojnë strategjinë e MBP.

Duke përdorur 8 elementet thelbësore të MBP do të na lejojë të krijojmë në klasat tona një mësim që shkon përtej memorizimit të përmbajtjes, i cili nxit angazhimin e nxënësve si dhe aftësitë e shekullit XXI dhe do të na udhëheq ne dhe nxënësit tanë drejt suksesit të MBP Lind natyrshëm pyetja pse duhet të përdorim MBP në klasat tona sot ?

Në tabelwn 6 e mëposhtme do të shohim elementet e transformimit të nxënësit gjatë përdorimit të MBP:

Zemrat dhe mendjet e angazhuara Studentët angazhohen në mënyrë aktive me projektet MBP të cilat sigurojnë rëndësi të vërtetë në botën e të mësuarit. Nxënësit mund të zgjidhin problemet që janë të rëndësishme për ta dhe komunitetet e tyre.	Shkathtësitë e punës në shekullin 21 Përtej njohurive themelore, nxënësit mësojnë të ndërmarrin iniciativa dhe përgjegjësi, të zgjidhin problemet dhe të komunikojnë me ide.
---	---

Të mësuarit më të thellë Projektet MBP çojnë në një kuptim më të thellë dhe mbajtje më të madhe të njohurive të përmbajtjes. Nxënësit janë më të aftë të zbatojnë atë që ata i njohin, në situata të reja

. Një ndjenjë qëllimi

Një projekt i madh mund të jetë transformues për nxënësit. Duke parë një ndikim në botën reale u jep atyre një ndjenjë të përgjegjësisë dhe dhe qëllimit

Kreativiteti dhe teknologjia

Nxënësit kënaqen duke përdorur një spektër të mjeteve të teknologjisë nga hulumtimi dhe bashkëpunimi përmes krijimit dhe prezantimit të produktit

Ekspozimi ndaj të rriturve dhe karrierave

Nëpërmjet PBL, nxënësit bashkëveprojnë me të rriturit, bizneset dhe organizatat, dhe komunitetin e tyre, dhe mund të zhvillojnë interesa në karrierë.

Shpërblimi i marrëdhënieve të mësuesve

Mësuesit punojnë ngushtë me nxënësit aktivë dhe të angazhuar që bëjnë punë domethënëse dhe ndajnë gëzimin e rizbuluar të të mësuarit.

Burimi : http://www.bie.org/about/what_pbl

“MBP integron njohjen dhe bërjen e njohurive dhe elementeve të kurrikulës bërthamë. Nxënësit aplikojnë atë që dinë për të zgjidhur probleme autentike dhe për të prodhuar rezultate të cilat kanë rëndësi” citon Tomas Markham (2011)

3.2.2 Roli i nxënësit në raport me MBP-në

Gjatë zhvillimit të mësimit të bazuar në projekte ka një kombinim të punës në grup me atë individuale. Të dyja janë po aq të domosdoshme për një ecuri sa më të mirë të MBP-së. Ndarja e mirë e punëve ndërmjet anëtarëve të grupit zhvillon përgjegjësitë në raport me të tjerët, pra anëtarët e grupit. Në këtë raport secili nxënës duhet të jetë i përfshirë dhe të ndjehet i dobishëm, i vlefshëm, madje i pazëvendësueshëm. Kontributet e tyre do të jenë të ndryshme, por serioziteti, përgjegjshmëria e nxënësve duhet të jetë e njëjtë.

Nxënësit ndryshojnë nga njeri-tjetri, por më shumë për nga talentet dhe secilit i do gjetur prirja vetjake. Dikush pëlqen më shumë të kërkojë në internet për informacione, një tjetër është më i zoti në krijimin e videove, posterave dhe fletëpaslojeve, një tjetër për intervista të mira, kurse dikush pikturon dhe krijon objekte 3D etj, etj

Në fillesat e para të mësimi të bazuar në projekte, ndarja e nxënësve bëhet nga mësuesi, por më vonë nxënësit janë ata që i ndajnë grupet.

Nxënësit gjatë procesit të aplikimit të MBP-së marrin disa role të cilat do t`u vlejnjë më pas, në të ardhmen e tyre të afërt, kur të dalin në tregun e punës, Disa nga këto role janë :

- ✓ Koordinator i grupit
- ✓ Hulumtues
- ✓ Redaktor
- ✓ Bashkëpunues dhe bashkëndërtues i njohurive
- ✓ Matës i kohës
- ✓ Prezantues
- ✓ Përdor aftësitë e komunikimit
- ✓ Zgjidh probleme me rëndësi për komunitetin

Në raport me MBP-në:

- ✓ Përdor aftësinë e të menduarit kritik .
- ✓ Angazhohet në hetim
- ✓ Ushtron kreativitetin e tij
- ✓ Nuk kufizohet nga mësuesi
- ✓ Bashkëpunon për të reflektuar dhe rishikuar punën e bërë

- ✓ Motivohet në hulumtim
- ✓ Angazhohen në vendimmarrje
- ✓ Arsyeton rreth çështjeve komplekse
- ✓ Fillon me fillimin dhe fundin në mendje
- ✓ Ofron modele pozitive të zgjidhjes së problemeve
- ✓ Nxënësit nga çdo klasë mësojnë se si të mbledhin dhe zbatojnë njohuritë për t'u bërë nxënës të gjithë jetës (Serkan Özel 2013;44)

Në përfundim të analizës së rolit në nxënësit gjatë aplikimit të mësimit të bazuar në projekte mund të mbështesim mendimin e Diamanto Filippatou dhe Stavroula Kaldi se nxënësit mund të zgjedhin aktivitetet dhe punët e ndërmarra gjatë studimit, të bëhen komunikues, kreativ dhe të zhvillojnë të menduarit praktik, pasi ata janë të angazhuar në kërkim aktiv / zbulim, eksplorim dhe vendimmarrje; njohuria bazohet në përvojën dhe eksperimentimin në jetën reale / autentike; mësimi i bazuar në projekte lidh punën manuale dhe intelektuale (Filippatou.D& Kaldi.S,2010;17)

Nxënësit gjatë përdorimit të mësimit të bazuar në projekte janë të aftë që njohuritë e tyre t'i përdorin në mjedise të ndryshme. Ata janë të aftë të angazhohen në një proces rigoroz duke zgjeruar hetimit të fokusuar në pyetje, punojnë në mënyrë të pavarur , krijojnë produkte me cilësi të lartë dhe i prezantojnë para shokëve dhe komunitetit, duke ndërtuar kështu aftësitë e shekullit XXI.

Bashkëpunimi brenda grupit

Bashkëpunimi është një element i domosdoshëm për të zhvilluar MBP cilësore. Mësuesit duhet t'u bëjnë të qartë nxënësve se bashkëpunimi është kriter për sukses.(Mcnamara.S&Moreton.G fq 16)

Mësimi i bazuar në projekte rrit bashkëpunimin në punë , rrit shkathtësitë që nxisin nxënësit hezitues dhe të paangazhuar, pra studentët me arritje të ulëta) për t'u bërë të motivuar dhe të angazhuar (Thomas, 2000, f.21-23).

Ka shumë probleme gjatë të punuarit në grupe. Ndodh që një nxënës të jetë dominues në klasë dhe të detyrojë të tjerët, që të mos punojnë në grup; ka tipa të tjerë të cilët punojnë dhe sakrifikojnë në emër të grupit, duke lënë të tjerët të rrinë kot dhe të mos jenë protagonistë në punën me projekte; ka dhe nga ata të cilët mendojnë se nuk janë të aftë të nxjerrin produkte me vlerë, ndaj struken në një qoshe dhe presin nga të tjerët. MBP duhet të jetë kënaqësi në klasë dhe nxënësit të mësojnë duke u argëtuar.

Mësuesve u takon që t'u ngulisin nxënësve filozofinë e të mosmarrurit e punës tjetrit, ku secili të bëjë punën e tij e të mos presë nga të tjerët, por të mbajnë përgjegjësitë e tyre dhe të menaxhojnë ankthin dhe stresin. Ai u bën të qartë nxënësve që nuk do të vlerësojë askënd, i cili nuk ka kontribuar me punën e tij në nxjerrjen e produktit, pasi pjesëmarrja në të është një mundësi për përmirësim dhe sukses ⁶

Në të përditshmen time si mësuese në orët kur përdor MBP udhëzoj nxënësit se vlerësimi i punës do të realizohet në këtë mënyrë:

- Koordinator i grupit vlerëson shokët e grupit
- Shokët e grupit vlerësojnë njeri-tjetrin
- Mësuesi vlerëson të gjithë nxënësit

Ndarja e grupeve duhet të bëhet rastësore, me qëllim që nxënësit të njohin më nga afër njeri-tjetrin, të mos kenë druajtje dhe frikë nga sukseset e askujt, të krijojnë atmosferë miqësore në klasë larg talljeve dhe përçmimit, duke u përpjekur për sukses të padiskutueshëm. Në këtë proces duke qenë më të pavarur në klasa krijohen mundësitë që nxënësit të mësojnë aftësitë të tilla si: inkurajimi dhe ndihma.

⁶ <https://www.onlinecollegecourses.com/2012/12/10/how-to-motivate-your-students-wat-every-teacher-should-know-but-doesnt>

Përpos gjithë këtyre pozitiviteve që po listojmë, bashkëpunimi në grup ka dhe anë jo pozitive.

Së pari, brenda grupeve mund të kemi anëtarë me të njëjtën ambicie për të spikatur në punë e me dëshirën për t'u zgjedhur koordinatorë të grupit. Kjo mund të sjellë mosfunksionim të mirë të grupit gjatë procesit të MBP.

Së dyti, duke qenë se grupet janë heterogjene, pra në to bëjnë pjesë nxënës me arritje shumë të mira, mesatare dhe të dobëta, këta të fundit në shumicën e rasteve anashkalojnë futjen me produktivitet në grup dhe kërkojnë që shokët që punojnë të shënojnë emrin e tyre në produktin përfundimtar edhe pse ata nuk kanë kontribuar aspak në këtë produkt .

Së treti, mund të ndodhë që anëtarët e grupit të mos kenë përputhje të mendimeve të tyre. Kjo do të sjellë humbje kohe me biseda bosh dhe si rrjedhim dhe një produkt jo të arrirë.

Pra, në përfundim mund të themi se mësimi i bazuar në projekte (MBP) i mëson nxënësit jo vetëm përmbajtje, por edhe me aftësi të rëndësishme në mënyrën që ata duhet të jenë në gjendje të funksionojnë si të rriturit në shoqërinë tonë. Këto aftësi përfshijnë aftësitë e komunikimit dhe të prezantimit, aftësitë e organizimit dhe menaxhimit të kohës, aftësitë kërkimore dhe hulumtuese, aftësitë e vetëvlerësimit dhe të reflektimit, pjesëmarrja në grup dhe aftësitë e udhëheqjes dhe mendimi kritik. (Brandon Goodman J. Stivers, 2010)

Serkan Özel thotë se :” Hulumtimet tregojnë se zakonet e punës së nxënësve, aftësitë e të menduarit kritik dhe kreativiteti ndikohen pozitivisht nga të mësuarit e bazuar në projekte (Tretten & Zachariou, 1997). Kështu, promovimi i mësimit të bazuar në projekte përgatit nxënësit për karrierën e tyre të ardhshme akademike dhe jo akademike.

3.2.3 Roli i mësuesit në MBP; si lehtësues, menaxher i procesit, vëzhgues /komentues dhe vlerësues

Mësuesit duhet të mësojnë mënyra të reja të mësimdhënies për të plotësuar kërkesat e shoqërisë, me qëllim që nxënësit të fitojnë kompetencat që kanë nevojë për të marrë pjesë në shoqërinë e dijes dhe që të gjithë fëmijët të mësojnë në standarde të larta.

(Mclaughlin,W.M &. Talbert.E.J2006)

Mësuesi kërkon të njohë secilin fëmijë si një person individual dhe të krijojë një marrëdhënie besimi në të cilën mund të bëhet mësimi. Mësuesi përpiqet të mbështesë dhe të inkurajojë fëmijën në udhëtimin e të mësuarit, duke i inkurajuar ata që të reflektojnë dhe të pyesin. Në këtë kuptim, roli i mësuesit nuk është të shpërndajë informacion ose thjesht të korrigjojë (Learning and Teaching Scotland 2006). Gabimet e nxënësve, përveç atyre disiplinore, si respektimi i afateve dhe prishja e qetësisë gjatë punës me projektin, nuk duhen qortuar. Nuk ka më të natyrshme se gabimet, ndërsa je duke nxënë, veçanërisht në punë të tilla komplekse dhe me disa bashkëpunëtorë.

Nga studimet për këtë problem kam arritur të nxjerrë përfundime për rolin e mësuesit gjatë zhvillimit të MBP-së si lehtësues dhe menaxhues të procesit. Asistenca e mësuesve ndaj nxënësve shkon sipas një kurbe zbritëse gjatë viteve, sepse nxënësit duhet të forcohen me kalimin e kohës për punë të pavarur dhe vendime të pavarura.(UMB,2015;18)

Lehtësues i procesit të MBP,

- ✓ Udhëheqës i nxënësve
- ✓ Vëzhgues të punës së nxënësve
- ✓ Dialogues
- ✓ Tolerant dhe mirëkuptues
- ✓ Krijues i një mjedisi të qetë dhe frytdhënës

Ata duhet të lehtësojnë të mësuarit duke monitoruar kontributin dhe pjesëmarrjen e nxënësve dhe duke i angazhuar dhe inkurajuar ata që të zhvillojnë kuptime më të thella dhe kuptimplota të koncepteve Serkan Özel (2013 ;42) citon Johari & Bradshaw, 2008

Sipas Dewey (1897), "Mësuesi nuk është në shkollë për të imponuar ide të caktuara ose për të formuar zakone të caktuara në fëmijëri, por të ndikojë tek fëmija dhe ta ndihmojë atë në përgjigjen e duhur ndaj këtyre ndikimeve " citon Judy Harris Helm (2015)

Si menaxhues i procesit :

- ✓ Trajnues për t'i orientuar në punën me projekte
- ✓ Drejton grupe të vogla dhe përvoja të pavarura të punës.
- ✓ Menaxhon kohën

Sipas Dewey mësuesi ofron udhëzime nëpërmjet organizimit të pajisjeve dhe materialeve, duke siguruar qasje në ekspertë dhe duke mbështetur pjesët e punës së projektit në të cilën fëmijët kanë nevojë për ndihmë. Ai gjithashtu aludon në përdorimin e qëllimeve për punën e projektit. (Judy Harris Helm 2015) Suksesi i mundësive të ndryshme sigurisht merr aftësi menaxheriale

Vëzhgues -komentues të procesit: Vë në dukje gjatë gjithë kohës anët pozitive dhe negative të mbarëvajtjes së procesit në krijimin e produktit dhe funksionimit brenda grupit

- ✓ Sugjeron për përmirësim

Vlerësues i punës së nxënësve

- ✓ Analizon reagimet e ekspertëve
- ✓ nga mentorët
- ✓ reagimet nga prindërit
- ✓ reagimet nga drejtuesi i shkollës -
- ✓ Rishikon dhe përmirëson projektin

3.2.4 Prindërit –roli i tyre në MBP

“Prindërit janë në përgjithësi burime të pashfrytëzuara, të cilët kanë vlerat dhe ekspertizën që janë thelbësore për partneritetin”, bashkëpunimin prindër, nxënës dhe mësues e quan “forca e treshes”, pasi angazhimi i fëmijëve në shkollë formohet nga prindërit nëpërmjet “kurrikulumit të shtëpisë. (Fullan, 2010;296 Coleman ,1998;10)

Shumica e mësuesve janë të interesuar që prindërit të marrin një "mbështetje" më tepër, sesa roli bashkëpunues në praktikën e tyre në klasë, duke cituar arsyet e ekspertizës profesionale dhe statusit të tyre, Por krijimi i marrëdhënieve të fuqishme mes prindërve dhe mësuesve është një sfidë për dy arsye :

Së pari për mënyrën se si t'i adresojmë, prindërve nevojat dhe shqetësimet e të mësuarit të nxënësve gjatë MBP-së

Së dyti : mësuesit dhe prindërit të marrin role të reja me njëri-tjetri, pra të ndajnë mes tyre shqetësimet për MBP-në dhe të ndihmojnë përvojat më të mira në klasë për nxënësit. (Milbrey W. McLaughlin&Joan E. Talbert 2006)

3.2.5 Aplikimi i MBP te nxënësit me aftësi të veçanta

Po çfarë ndodh me nxënësit me aftësi të kufizuar gjatë zbatimit të punës me projekte?

Në politikat e sotme arsimore një vend me rëndësi po zë dhe arsimi gjithëpërfshirës, i cili ka të bëjë me përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuar në shkollat publike të arsimit parauniversitar. Kjo kategori nxënësish ka probleme që lidhen me kujtesën ,vështirësi me të përqëndruarin, me të prezantuarit, pra me të folur dhe të lexuarit.

Westwood (2006) tregon se mësimi i bazuar në projekte nuk mund të jetë një metodë efektive e mësimdhënies për të nxënësit me vështirësi në të mësuar, të cilët u mungojnë aftësitë adekuate bazë në lexim dhe shkrim. (Filippatou.D& Kaldi,S ,2010;17)

Brenda kontekstit të të nxënit me në qendër nxënësin, metoda e mësimdhënies së bazuar në projekte është bërë gjithnjë e më e spikatur si një përgjigje e shkollimit ndaj sfidave të shekullit të 21-të .Deri tani kemi sqaruar elementet bazë të aplikimit të MBP-së në shkollat tona, por nuk mund të lëmë pa cekur dhe efektivitetin e të nxënit të bazuar në projekte me nxënësit e shkollave me fëmijë me vështirësi në të mësuar. Studimet e shumta përkrahin mendimin se nxënësit me vështirësi në mësim mund të kenë përfitime përmes të të mësuarit bazuar në projekte në lidhje me performancën akademike dhe sociale, ndaj ata mund të angazhohen në përvojat e të mësuarit përmes mësimi të bazuar në projekte në nivelin për të përmbushur qëllimet e tyre sociale dhe akademike.

Janë këta nxënës që kanë përjetuar dhe përjetojnë ditë pas dite përballjen me bashkëjetesën me ata që janë “ndryshe”, pësojnë disfata të njëpasnjëshme në këto përballje, zhgënjehen dhe si rrjedhim kanë frikë dhe vetëvlerësim të ulët, janë pasivë dhe nuk përfshihen në eksperiencë të suksesshme. Përvojat kanë treguar se aplikimi i mësimit të bazuar në projekte ka rritur motivimin, vetëvlerësimin, vlerën e detyrës, punën dhe pranimin në grup dhe angazhimin në procesin mësimor. (Filippatou.D & Kaldi, S 2010;) citojnë në hulumtimin e tyre Gillies & Ashman, (2000) të cilët theksojnë se puna në grupe ndikon pozitivisht në shoqërinë e pranimin i fëmijëve me aftësi të kufizuara nga bashkëmoshatarët e tyre pa aftësi të kufizuara. Për më tepër, nxënësit me probleme me të mësuarit që punojnë në grupe bashkëpunimi në klasat e zakonshme priren të arrijnë rezultate më të larta se shokët e tyre që punojnë në mjedisin tipik të klasës.

Ajo që duhet të themi është se mësimi i bazuar në projekte MBP nuk është një metodë mësimore, e cila mund të zhvillojë aftësi të caktuara mësimore të tilla si leximi, shkrimi, përdorimi i strategjisë i nxënësve me nevojë të veçanta arsimore. Por ajo mund të mbështesë të mësuarit e këtyre fëmijëve përmes rrugëve alternative të tilla si qasja multi-ndijore, përvoja praktike, mësimi bashkëpunues, sepse në këtë mënyrë ata mësojnë aftësitë e nevojës për të ndihmuar dhe mbështetur të mësuarit e njëri-tjetrit. (Filippatou.D & Kaldi, S ,2010;25)

Studime të shumta (Güven dhe Duman (2007; Mc Arthur, Ferretti dhe Okolo (2002)) gjithashtu tregojnë se pas aplikimit të mësimit të bazuar në projekte kishte përmirësime për nxënësit me vështirësi në të mësuar lidhur me qëndrimet e tyre ndaj punës në grup, pranimin e tyre në grup dhe përfshirjen e tyre në procesin mësimor. Pas përvojave të tyre të zbatimit të mësimit bazuar në projekte pikëpamjet e këtyre nxënësve në lidhje me përfitimet e punës në grup në rezultatet e mësimit, ndërveprimet e kolegëve dhe pranimi në grup kanë ndryshuar dukshëm duke shtuar njohuri dhe interes për temën e projektit dhe zbatimin e tij, pavarësisht se kjo kategori nxënësish ka probleme me kujtesën, me leximin apo shkrimin.. Rezultatet e hulumtimeve të mësipërme na tregojnë se nxënësit me vështirësi më të mësuarit duket se janë shumë më të angazhuar, më të motivuar, më të vetëvlerësuar në këtë proces, në krahasim me metodat e tjera pasive të të mësuarit.

3.2.6 Baza ligjore në Shqipëri për përdorimin e MBP –së .Çfarë thonë Dispozitat Normative për projektin:

Në “Nenin 72 Projektet kurrikulare ndërlëndore/ lëndore “citohet shprehimisht si më poshtë vijon:

- 1.Temat e projekteve kurrikulare ndërlëndore/lëndore (më tutje në këtë nen “projektet”) përzgjidhen nga nxënësit.
- 2.Mësuesi udhëzon nxënësit para dhe gjatë zhvillimit të projektit, vëzhgon qëndrimin dhe kontributin në projekt të secilit nxënës-pjesëmarrës gjatë punës individuale e në grup dhe vlerëson nxënësit.
- 3.Drejtori i shkollës nxit mësuesit të punojnë për projekte ndërlëndore.
- 4 Projekti ka aspak ose shumë pak shpenzime dhe nuk kërkon shpenzime nga prindërit.
5. Në projekte është e dëshirueshme të përfshihen edhe prindër.
6. Mësuesi përshkruan përmbledhtas projektin kurrikular sipas një formati me këto rubrika: Titulli i projektit, objektivat e projektit, temat e njohurive kryesore lëndore të cilat do të rimerren në sajë të projektit, partneret (nëse ka, si: prindër, OJF), numri i orëve gjithsej të projektit dhe i ndarë në mes të mësuesve, numri i nxënësve që përfshihen në projekt ose numri i klasave, përshkrimi i shkurtër i veprimtarive kryesore të projektit; përshkrimi i shkurtër i produktit të projektit; mënyra e prezantimit përfundimtar të projektit.
7. Në orarin mësimor të klasës shënohen ato orë mësimore të projektit që zhvillohen në klasë (përzgjedhja e projektit, një pjesë e punës së nxënësve në projekt dhe prezantimi i projektit)
8. Mësuesi (mësuesit) planifikojnë një numër orësh të mjaftueshme për realizimin cilësor të projektit.
9. Orët mësimore të projekteve përfshihen në ngarkesën mësimore vjetore të mësuesve përkatës. 10. Orët mësimore të projektit shënohen në regjistër si orët e tjera lëndore.

11. Kur projekti është ndërlëndor, secili mësues bën vlerësimin e nxënësve për pjesën e lëndës së tij ku nxënësit janë përfshirë.

12. Institucioni arsimor krijon arkivin e projekteve më të mira, të cilat mësuesit i shfrytëzojnë përgjatë viteve. Arkiva është objekt inspektimi nga ISHA dhe vëzhgimi nga DAR/ZA-ja për përhapjen e përvojave të suksesshme (Dispozitat Normative, 2013 ;36)

Më poshtë po ju paraqesim një format me rubrikat përkatëse :

Titulli i projektit –

Objektivat/rezultatet e projektit

- Një listë me njohuritë kryesore lëndore të cilat do të përvetësohen ose rimerren në sajë të projektit –

(Nëse në një projekt merr pjesë më shumë se një mësues) Kontributi i çdo mësuesi dhe sa orë mësimore i takojnë secilit.

Partnerët, nëse ka (prindër, OJF, etj.) –

Numri i nxënësve që përfshihen në projekt ose numri i klasave

- Përshkrimi përmbledhës i veprimtarive kryesore përkatëse, i ndarë në hapat kryesore, me afatet dhe përgjegjësit (kur ka dy a më shumë mësues)

- Burimet kryesore të informacionit

- Përshkrimi i produktit të projektit –

Tematika e secilës orë mësimore në kuadrin e projektit (Në disa raste, kur projekti zgjat, është e pamundur të parashikohen zhvillimet e tij, pra një pjesë e këtyre temave lihen bosh)

- Mënyra e vlerësimit të nxënësve UMB 2015 fq 23.

3.2.7 Korniza kurrikulare e Arsimit Parauniversitar “

Një bazë tjetër ligjore e rëndësishme është dhe “Korniza kurrikulare e Arsimit Parauniversitar “

“Sistemi ynë arsimor synon të formojë nxënës që të jenë të aftë të jetojnë dhe të kontribuojnë aktivisht në shoqërinë demokratike, të zotë të përballojnë e të përshtaten në një botë të larmishme e në ndryshim të pandërprerë në të gjitha fushat e jetës, të dijes dhe të punës” (Tiranë 2012 fq 5)

Kurrikula duhet t’i japë mundësinë secilit nxënës të bëhet i aftë të komunikojë qartë, saktë e kuptueshëm në mënyra të larmishme.

Në zbatim të legjislacionit MBP-ja nuk mbetet më trend, por domosdoshmëri në arsimin parauniversitar dhe gjatë zhvillimit të saj nxitet aftësia e të menduarit kritik, e cila mundëson rritjen e shkallës së arsytimit të argumentuar e të pavarur të nxënësve. Të menduarit kritik përfshin grumbullimin, përzgjedhjen e informacionit të nevojshëm, vlerësimin dhe arritjen e një përfundimi.

Kurrikula synon të aftësojë nxënësit: Të përdorin metoda të larmishme për identifikimin e strukturave të informacionit dhe të ideve; të mbështesin me argumente dhe fakte bindjet, përgjithësimet, dhe përfundimet e tyre; të mbajnë ose të krijojnë qëndrime të pavarura, të mbështetura me argumente ndaj gjykimeve dhe qëndrimeve të të tjerëve; të shpjegojnë lidhjet ndërmjet së tërës e pjesëve të saj përbërëse, të dallojnë faktet nga interpretimet e të zhvillojnë linja arsytimi të bazuara në fakte/përfundime/ parashikime; të jenë të aftë të marrin në shqyrtim e të korrigjojnë veten.

Aftësia e të menduarit krijues Të menduarit krijues mundëson zbulimin e ideve të reja, krijimin e lidhjeve origjinale mes tyre dhe gjetjen e një larmie zgjidhjesh për situatat problemore. Në të gjitha fushat e të nxënësve, kurrikula u jep mundësinë nxënësve që të shfaqin origjinalitetin e tyre dhe të zhvillojnë prirjet e veta krijuese. Ajo synon të aftësojë nxënësit: - të shprehin, nëpërmjet një larmie formash, anët origjinale të personalitetit të tyre në shkollë, komunitet dhe punë; - të pranojnë dhe të kërkojnë ide e rrugëzgjidhje të reja; - të

mirëpresin idetë dhe përvojat e reja të të tjerëve; - të parashikojnë mundësitë për dështime e gabime dhe të gjejnë zgjidhje për shmangien e tyre.

Aftësia e zgjidhjes së problemit

Të zgjidhësh një situatë problemore do të thotë të përdorësh njohuritë e fituara për të zgjidhur një situatë të panjohur më parë. Aftësia e zgjidhjes së problemit u jep nxënësve mundësinë të sfidojnë, të zgjidhin e të menaxhojnë situatat e larmishme problemore të jetës së përditshme, duke u mundësuar njëkohësisht atyre zbulimin dhe hetimin e botës shkencore dhe teknologjike. Ajo shërben si bazë e të nxënësve të mëtejshëm dhe e bën individin të jetë aktiv dhe efektiv si në jetën personale, ashtu dhe në atë shoqërore. Në këtë drejtim, kurrikula e arsimit parauniversitar synon të aftësojë nxënësit: Të analizojnë situata problemore dhe të hartojnë plane ndërvepruese për zgjidhjen e tyre; të ndjekin dhe të vlerësojnë ecurinë e etapave të zgjidhjes së problemit; të bëjnë parashikime, të ngrenë hipoteza, të argumentojnë në mënyrë bindëse metodat e përdorura të kërkimit dhe përfundimet e arritura; të kërkojnë, të gjejnë zgjidhje të ndryshme dhe t'i vlerësojnë ato në përputhje me dobinë dhe zbatueshmërinë; të vlerësojnë rrugëzgjidhjet me qëllim përmirësimin e tyre; të komunikojnë zgjidhjen të tjerët

Aftësia e të punuarit në grup

Nxënësi duhet të përfitojë nga kurrikula aftësinë për të punuar në grup me të tjerët, në mjedise e rrethana të ndryshme dhe me synime të qarta. Kjo aftësi nënkupton që ai të jetë në gjendje të përcjellë idetë dhe nevojat brenda grupit, duke respektuar pikëpamjet e ndryshme të anëtarëve të tjerë, të arrijë në marrëveshje, të marrë përsipër përgjegjësitë si anëtar i grupit ose si drejtues i tij, të ndihmojë të tjerët të ndihen të përfshirë në grup dhe të motivojë grupin për të tejkaluar vështirësitë. Kurrikula synon të aftësojë nxënësit: të punojnë me të tjerët në grup, në mjedise e kontekste të ndryshme, me synime dhe qëllime të përcaktuara; të përcjellin idetë dhe nevojat brenda grupit, duke respektuar pikëpamjet e ndryshme të anëtarëve të tij; të arrijnë marrëveshje për planet e veprimit, për të respektuar afatet dhe planet e pranuar; të marrin përsipër përgjegjësitë e të qenit pjesë e grupit si

anëtar ose si drejtues i tij; të ndihmojnë të tjerët të ndihen të përfshirë në grup dhe të motivojnë grupin për të kaluar vështirësitë. (MAS, 2012 fq 17-19)

Të gjitha këto krijojnë bazën ligjore e cila vërteton më së miri faktin se ka ardhur koha që MBP-ja të mos jetë më një trend në arsimin parauniversitar, por të jetë domosdoshmëri.

3.2.8 Motivimi i nxënësit gjatë zbatimit të mësimin të bazuar në projekte

Sa i motivuar është nxënësi gjatë përdorimit të MBP? A ia vlen “barra qiranë”?

Gjatë çdo veprimtarie që ne, mësuesit bëjmë në klasat tona pyesim veten sa të motivuar ndjehen nxënësit? Dhe në këtë rast duhet të listojmë disa prej argumenteve të cilat tregojnë mundësitë e motivimit të nxënësve gjatë procesit të MBP.

Sipas fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe kuptimi i foljes Motivohet/ohet është :”E shpjegoj dhe e arsyetoj diçka që e quaj të drejtë. Kjo fjalë vjen nga fjala Motiv e cila ka kuptimin:”Shkaku që nxit apo vë në lëvizje dikë për të bërë diçka; arsyeja që të shtyn për një veprim ose për një qëndrim a sjellje të caktuar. Si rrjedhim mund të themi se nxënësit duke pasur një motiv për të punuar, ata vënë në lëvizje trurin, bashkëpunojnë, eksperimentojnë, ngrihen, lëvizin mendojnë se si do të zgjidhin problemet,(<http://k12thoughtfullearning.com> blog post) Motivimi për të zgjidhur një problem bëhet dhe motivim për të mësuar⁷

Ajo që duhet të kemi parasysh është se sfidat motivojnë .Këmbëngulja përballë dështimit është shenjë motivimi. Dështimi është në rregull për sa kohë që promovon të mësuarit.

Autonomia e punës është një nxitës më i madh i motivimit sesa shpërblimet (notat dhe dënimet) (Daniel Pink 2006). Autonomia është një ndjenjë e fortë pavarësie, pronësie dhe vetëvlerësimi gjithashtu ka efekt mbi performancën e nxënësit. Projektet që kanë thellësi, kohëzgjatje dhe kompleksitet do t'i sfidojnë nxënësit dhe do t'i motivojnë ata në ndërtimin e njohurive. Nxënësit të cilët mund ta shohin lidhjen midis një detyre të bazuar në projekte

⁷ (<http://www1.udel.edu/inst/>)

dhe botës reale do të jenë më të motivuar për të kuptuar dhe zgjidhur problemin në fjalë. Motivimi mund të jetë një nga faktorët kyç në suksesin akademik të nxënësve. me qëllim që ata të arrijnë nivele të larta të të nxënësve, duhet të mbajnë lart nivelin e motivimit . (Beres, Pamela J 2011 fq 4-5)

Gjithashtu, përpjekja është sinonim i motivimit. Një individ që tregon përpjekje më të madhe konsiderohet të jetë i motivuar (Aida Suraya Md.Yunus & Wan Zah Wan Ali 2009).Këta citojnë atë që ka thënë Bandura (1992), se rritja e vetë-efikasitetit nuk përfundon gjatë rinisë, por vazhdon të zhvillohet gjatë gjithë jetës, ndërsa njerëzit fitojnë aftësi, përvoja dhe mirëkuptim të ri. Individit me një ndjenjë të fortë të vetë-efikasitetit vështron probleme sfiduese si detyra që duhen zotëruar, zhvillon interes më të thellë në aktivitetet në të cilat ata marrin pjesë dhe formojnë një kuptim më të fortë e angazhimit ndaj interesave dhe aktiviteteve të tyre duke u shëruar shpejt nga pengesat dhe zhgënjimet. Ata që kanë një besim të fortë në aftësitë e tyre ushtrojnë përpjekje më të mëdha, kur ata dështojnë për të zotëruar sfidën. Këmbëngulja e fortë, kontribuon në arritjet e performancës. (Bandura.A 1995 fq 6-7)

3.2.9 Vlerësimi i nxënësve gjatë MBP -së

Një rol të rëndësishëm në mësimin e bazuar në projekte ka dhe vlerësimi. Ka rëndësi për faktin se nxënësve janë mësuar me vlerësimin me test e të shkruar siç ndodh në mësimdhënien tradicionale, por dhe bashkëkohore. Hartimi i vlerësimeve të vlefshme dhe të besueshme në një klasë ku aplikohet mësimi i bazuar në projekte është një proces që kërkon kohë Vlerësimi i përgjithshëm i punës së nxënësve është autentik. Frank.M& Barzilai.A (2002) Vlerësimi autentik quhet dhe "vlerësim i performancës" dhe mund të përfshijë vlerësimin e portofolit të nxënësve. Në këtë lloj vlerësimi nxënësve u kërkohet të zgjidhin dhe përmbushin problemet dhe detyrat sfiduese vlerësim për të kuptuar vlerësimin autentik. E rëndësishme për nxënësve është që të mësojnë të kuptojnë kriteret e vlerësimit, të mësojnë të vlerësojnë veten dhe të mësojnë të vlerësojnë shokët e tyre. Ata e dinë se vlerësimi do t'i drejtohet produktit, paraqitjes dhe performancën së tij gjatë projektit. (Moursund.D 2003;75)

Vlerësimi i performancës së nxënësve në projekt bazohet në vëzhgimet e punës së nxënësve në klasë, raportit të grupit dhe portofolit, raporteve personale reflektuese, posterave, prezantimeve multimediale. Përsa i përket vetëvlerësimit dhe vlerësimit të shokëve, studimet kanë treguar se si vetëvlerësimet dhe vlerësimet e shokëve mund të mos jenë jo shumë objektive. Vlerësimi i vetes nuk është shumë i thjeshtë, pasi cilido ka objektiva për të arritur dhe kur vjen puna në vlerësimin me notë nuk mund të mos i lërë pa realizuar këto objektiva dhe vlerësimi i shokëve mund të mos jetë shumë i vërtetë, pasi nxënësit i kushtojnë më shumë vëmendje bashkëpunimit shoqëror dhe e quajnë atë më të rëndësishëm se kontributi intelektual, gjë që mësuesit nuk mund ta vënë re me lehtësi. Në fund të aplikimit të mësimit të bazuar në projekte nxënësit do të dorëzojnë për vlerësim portofolin e tij i cili do të ketë në brendësi :

- ✓ Planin e projektit,
- ✓ Planet vetjake të nxënësve
- ✓ Shënimet gjatë takimeve të grupit,
- ✓ - Një listë të burimeve të informacionit,
- ✓ Raportin përfundimtar,
- ✓ Të tjera që nxënësit dëshirojnë, si fotografi, episode interesante gjatë punës, etj.
- ✓ Përveç raportit, nxënësit dorëzojnë dhe produktin e projektit kur nuk është thjesht raporti.(UMB, 2015;20)

Ka disa mënyra se vlerësohet nxënësi gjatë mësimit të bazuar në projekte:

Mësuesi e qartëson nxënësin për mënyrën se si do të vlerësohet me notë dhe se cilat kritere do të zbatohen në këtë vlerësim. Nxënësi plotëson portofolin e tij hap pas hapi me të gjithë elementet që i sqaruam më lart, por mësuesi mundet ta vlerësojë nxënësin nisur nga disa këndvështrime :

Plani i projektit duke vlerësuar :Si është hartuar ai? A janë të përcaktuar qartë rezultatet e të nxënësve dhe kompetencat e fushës dhe lëndës ? A është bërë saktë ndarja e punës në grupe, në të cilat secili të ketë të qartë punën individuale që duhet të kryejë? A është caktuar sa herë do të mbledhen grupet?

Zbatimi i orarit

Sa korrekt janë nxënësit në respektimin e orarit ? A respektojnë kohën e punës në grup? A sjellin në kohën e duhur informacionet që i kërkohen?

Menaxhimi i informacionit

Një element i rëndësishëm në dosje për vlerësim është dhe menaxhimi i informacionit.Për këtë mësuesi i pyet nxënësit për burimet e informacionit dhe larmishmërinë e tyre, kanë mbajtur qëndrim kritik ndaj informacionit të hulumtuar dhe nëse i kanë dokumentuar apo mbajtur shënim gjithçka që ka qëmtuar.

Etika e punës në grup

Etika e punës në grup është një një element, i cili duhet të kihet parasysh nga nxënësit gjatë zbatimit të mësimit të bazuar në projekte.

Gjatë kohës së vëzhgimit të nxënësve mësuesi përqendrohet në këto kritere: bashkëpunimi midis anëtarëve të grupit dhe arritja e kompromiseve pozitive; sjellja me takt në raport me njeri-tjetrin në diskutime; argumentet bindëse që zgjedhin gjatë diskutimeve ;etj

Raporti përfundimtar

Në raportin përfundimtar i cili dorëzohet në fund të mësimit të bazuar në projekte mësuesi vlerëson nxënësit së pari për strukturimin e punës së tyre, pra raportit që ka bërë, së dyti për origjinalitetin e punës së tyre dhe së treti për mënyrën se si kanë vlerësuar veten, pra si kanë realizuar vetëvlerësimin.

Gjithashtu, përveç këtyre që përmendëm dhe analizuam më sipër mësuesi tregohet i vëmendshëm në vlerësim dhe për informacionin e marrë copy-paste dhe përjashtimin e këtij

informacioni nga vlerësimi (kjo gjë përbën një nga shqetësimet bërë të mësuesve gjatë zhvillimit të projekteve lëndore dhe ndër-lëndore) dhe e dyta, por jo më pak e rëndësishme është elementi përdorimi i normës letrare në të shkruar dhe stili i nxënësit

Për të vlerësuar nxënësin gjatë zbatimit të mësimit të bazuar në projekte dy mënyra të vlerësimit me notë .

Njëra është: Të gjithë pjesëtarët e një grupi vlerësohen me të njëjtën notë. Në grup mundet të qëllojnë edhe nxënës mospjesëmarrës dhe apatikë. Që në fillim të zbatimit të MBP-së mësuesi i bën me dije grupeve që u takon atyre të mirëorganizojnë punët dhe të nxisin secilin të kontribuojë. Nëse kjo nuk arrihet, është e metë e grupit në tërësi.

Mënyra tjetër: Secili nxënës ka notën e vet e cila del përmes ponderimit të notës si grup dhe notës si individ. P.sh. notë si grup peshon 80%, kurse si individ 20%. Nota si individ bazohet në vëzhgimet e mësuesit, sidomos gjatë orëve mësimore, dhe portofolit personal të nxënësit. Mësuesi gjykon vetë se si do të vlerësojë nxënësin, nuk ka receta nga askush për vlerësimin. Një gjë është mëse e qartë, se ajo që synohet është se gjatë bashkëpunimit në grupe të vogla, gjatë aplikimit të mësimit të bazuar në projekte, shkolla parapërgatit nxënësit për sjelljen e duhur në grupet e vogla të jetës si familja dhe vendi i punës etj etj. Në të dyjat mënyrat që cituam më lart vlerësimi i nxënësve bëhet mbi katër nivele të cilat i korrespondojnë :

Niveli pakalues Nota “4”

Nxënësi në nivelin pakalues nuk paraqit raport përfundimtar dhe nuk dorëzon produktin, ose Raporti përfundimtar ka gabime të shumta për sa i përket njohurive, mungojnë argumentet, nuk ka bashkëpunuar në grup e nuk ka respektuar afatet.

Niveli bazë Notat “5 dhe 6”

Nxënësi në nivelin bazë dorëzon raportin, por me gabime gjuhësore dhe të pastrukturuar. Nxënësit përpiqen të bashkëpunojnë gjatë zbatimit të MBP-së dhe përpiqen që të zbatojnë në përgjithësi afatet. Përsa i përket prezantimit ai është i përciptë.

Niveli mesatar Notat “7 dhe 8

Nxënësit në nivelin mesatar bashkëpunojnë me njeri-tjetrin, hulumtojnë informacionin nga disa burime informacioni dhe e përpunojnë mirë atë. Tregohen të përpiktë në afatet e caktuara. Raportin përfundimtar e strukturojnë mirë dhe gjuha standarde respektohet prej tyre, por bëjnë disa gabime tek-tuk.

” Niveli i lartë Notat “9 dhe 10”

Nxënësi në nivelin e lartë përdor larmi burimesh të informacionit. Gjatë diskutimeve të zhvilluara jep gjykime kritike ndaj informacioneve dhe sjell shpesh ide origjinale. Të gjithë nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur dhe në grup. Raporti përfundimtar me shkrim paraqitet korrekt dhe i strukturuar mirë.

Por këto të cilat i cituam më lart nuk janë dhe nuk mund të jenë të vetmet mënyra vlerësimi, pasi mësuesi zgjedh dhe përshtat mënyra të tjera origjinale vlerësimi.

Vlerësimi i MBP në arritjet e nxënësve në krahasim me metodat e tjera të mësimdhënies (me vlerësimin me gojë dhe me test përmbledhës)

Në datën 08.04.2014 Ministria e Arsimit dhe Sporteve të aso kohe u dërgon me numër protokolli 2479 Drejtorivë Arsimore “Udhëzuesin për nxjerrjen e notës vjetore lëndore dhe të notës mesatare (kl VI-IX) Si përmendëm dhe më lart gjatë mësimdhënies me në qendër nxënësin mësuesit përdorin një sërë teknikash, metodash dhe strategjish të cilat më pas “konvertohen’ dhe në vlerësimin që marrin nxënësit .

Paketa e dokumenteve për vlerësimin në arsimin e mesëm të ulët (AMU) dhe arsimin e mesëm të lartë në Republikën e Shqipërisë (AML) përfshin:

Kornizën e vlerësimit të nxënësve për arsimin parauniversitar (MAS, Nr. 5563, dt, 23.07.2015)

Udhëzimin e MAS për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë, Nr.14, dt.28.07.2016

Nivelet e arritjeve të nxënësve për vlerësimin e kompetencave, shkalla 3(VI-VII)Shkalla 4 kl (VIII-IX) dhe shkalla 5 (kl.10-12)

Vlerësimi me gojë ka 40% të peshës në vlerësimin përfundimtar të nxënësve dhe vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse ka po të njëjtën peshë në % sa dhe vlerësimi me gojë 40% (këto përqindje i përkasin kurrikulës së re, (se në kurrikulën e vjetër, testi përfundimtar kishte 50% të peshës së vlerësimit të përgjithshëm) dhe vlerësimi me portofol i cili ka 20% të peshës në vlerësimin përfundimtar.

Pjesë e portofolit është edhe projekti kurrikular.Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë vetëm brenda një periudhe, por mund të jetë i shtrirë edhe përgjatë gjithë vitit. Sido që të jetë shtrirja e projektit ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar. Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe vlerësohet i gjithë projekti.

Por nuk duhet të harrojmë faktin se në vlerësimin e portofolit përveç projekteve individuale dhe në grup përfshihen dhe punë dhe detyra të kryera në klasë dhe jashtë saj, si punë praktike, punë laborator, ese, detyrë me shkrim etj; - detyra dhe kontribute të pavarura të nxënësit, të cilat janë dëshmi e talentit, e hulumtimeve praktike, e punëve tematike (me shkrim, audio-vizuale etj.).Nga kjo mund të arrijmë të kuptojmë me një matematikë të thjeshtë se sa peshë ka në vlerësim projekti .(IZHA, 2016 fq 23 ;2017 fq 16)

Më poshtë po shohim të përmbledhuar në një tabelë peshën e vlerësimeve :

Tabela 7:Llojet e vlerësimit të nxënësit në kurrikulën e re /pesha e tyre

Vlerësimi i vazhdueshëm	Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse	Vlerësimi me portofol lëndor
Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit mbi	Në përfundim të periudhës kryhet vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse, e cila	Portofoli është koleksionim sistematik i detyrave dhe punimeve krijuese dhe

përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët me shkrim, punët në grup, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës, përgjatë një periudhe	ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni. Mësuesi përzgjedh të zhvillojë test ose detyrë përmbledhëse, në varësi të veçorive të lëndës.	hulumtuese të kryera nga nxënësi përgjatë periudhës për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve). Rubrikat e portofolit mund të grupohen në: - punë dhe detyra të kryera në klasë dhe jashtë saj, si punë praktike, punë laborator, ese, detyrë me shkrim etj.; - projekte individuale ose në grup; - detyra dhe kontribute të pavarura të nxënësit, të cilat janë dëshmi e talentit, e hulumtimeve praktike, e punëve tematike (me shkrim, audio-vizuale etj.).
40%	40%	20%

Burimi :Përshtatur “Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës së re në AMU dhe Gjinnaz (2016.2017, fq 13-16)

Siç do ta shohim dhe në analizën e gjetjeve, vlerësimi që nxënësi marrin gjatë aplikimit të MBP në shkollë është shumë herë më i mirë se në vlerësimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin me test përmbledhës, por vlera prej 10% e vlerësimit demotivon nxënësit në punën e tyre.

Strukturat vendimarrëse pranë MASR-së duhet të marrin masë në këtë drejtim. Le të shpresojmë të bëhet më e mira!

3.2.10 Teknologjia në ndihmë të MBP-së .Çfarë është STEM MBP?

Teknologjia është tashmë pjesë përbërëse e jetës së nxënësve dhe gjatë aplikimit të saj në mësimin e bazuar në projekte e bën mjedisin më kuptimplotë për ta .Ajo shërben si një mjet për të mbështetur të nxënit shkencor dhe krijimin e një mjedisi aktiv për të . Nxënësit mund ta përdorin teknologjinë gjithashtu si instrument për të mbledhur të dhëna duke kursyer shumë kohë në këtë mënyrë, për të zgjeruar ndërveprimin dhe bashkëpunimin me të tjerët, për të vizualizuar të dhënat në forma të ndryshme për analizë dhe për të modeluar fenomenet. Aftësitë e teknologjisë nuk duhet të konsiderohen vetëm si përmirësimin e aksesit fizik të informacionit, por gjithashtu edhe lehtësimin e aksesit intelektual (Blumenfeld et al 1991).

Teknologjia përdoret për të mbështetur probleme sfiduese, ndjenjën e autenticitetit dhe cilësinë e "jetës reale" të detyrës në fjalë. Përdorimi i email-it, konferencat kompjuterike, të dhënave në web, diskutimet në grup në internet dhe audio dhe video konferencat në mënyrë të konsiderueshme për të të rritur shkallën dhe lehtësinë e ndërveprimit midis të gjithë pjesëmarrësit.

Nxënësit dhe mësuesit dhe prindërit duhet të përdorin një platformë teknologjike e cila t'u mundësojë mësuesve dhe prindërve për të ndjekur përparimin e nxënësve ⁸

Teknologjia si mjet për prezantim

Teknologjia luan një rol të rëndësishëm në prezantimin e produktit të projektit. Nxënësit krijojnë produkte të tilla si PPT, video në prez, slideshare, amazon etj. Përveç funksionit të prezantimit me shokët e klasës, këto video mund të shpërndahen dhe me të tjerët në rrjetet sociale duke ndërvepruar me bashkëmoshatarët kudo që ndodhen. Mundet që këto punë të reklamohen dhe në një faqe interneti.

⁸ (<https://elearningindustry.com/7-ways-integrate-technology-successful-project-based-learning>)

Teknologjia si mjet për bashkëpunim

Teknologjia mund të përdoret gjithashtu për të mbështetur bashkëpunimin dhe komunikimin. World Wide Web dhe Interneti kanë hapur shumë mundësi për nxënësit për të gjetur informacion dhe për të bashkëvepruar me njëri-tjetrin ose dhe për mësuesit. Ata duhet të mësojnë si ta përdorin si forum në mënyrë që të ndërveprojnë me njëri-tjetrin, të marrin përgjegjësitë në punën bashkëpunuese, të gjejnë strategji për përballimin e konfliktit, për cilësinë e dhënies së komenteve të dobishme dhe reagimeve konstruktive.

Teknologjia si mjet për reflektim. Ditari reflektues është një mjet për të krijuar kuptim dhe kontekst nga ngjarjet dhe përvojat në projekt. Web-shkrimet (bloget) ofrojnë një mjet të ri dhe të fuqishëm për mbështetjen e të nxënësit reflektiv bashkëpunues dhe individual. Blogimi inkurajon nxënësit që të reflektojnë dhe reflektimi është shpesh një element kyç në procesin e të mësuarit. Edhe nëse nxënësit nuk mund të kenë blogë, mësuesit duhet t'i inkurajojnë nxënësit të reflektojnë dhe të regjistrojnë përshtypje dhe ide të ndryshme gjatë aplikimit të punës me projekte. Në këto raste mund të përdoren thjesht si një record, një ditar zanor etj. Në këtë mënyrë nxënësit ruajnë përparimin dhe reflektojnë mbi punën e tyre. Po me ndihmën e teknologjisë nxënësit mund të krijojnë dosjet me punët e tyre dhe u rikthehen herë pas here për reflektim dhe përmirësim të punëve .

Teknologjia si mjet për vlerësim

Puna e bërë nga nxënësit në një mësim të bazuar në projekt mund të dokumentohet si e thamë dhe më lart nëpërmjet e-portofoleve, të cilat mund të vlerësohen lehtësisht nga mësuesi duke i ardhur në ndihmë teknologjia e informacionit. (Donnelly, Roisin, 2005 ; 18)

Duke i ardhur në ndihmë teknologjia mësimi i bazuar në projekte nuk mbetet vetëm një mënyrë për të mësuar, por dhe për të punuar së bashku. Shkatërohen barrierat e izolimit në klasë, largohet frika për të hyrë drejt një procesi të panjohur dhe fitohet besim për sukses. (Educational Technology Division Ministry of Education, Malaysia 2006;8)

Çfarë është STEM MBP?

Pavarësisht se “Arsimi vazhdon të funksionojë në një zonë 'të sigurt' ku mbizotërojnë standardet dhe rezultatet e paracaktuara”⁹ MBP po popullarizohet dhe po aplikohet gjerësisht në shumë e shumë shkolla. Nuk po shikohet më si një metodë, por si ndryshim i mendjes së nxënësve dhe mësuesve

Derimëtanë në folëm gjerë e gjatë për MBP e cila përfshinte një a disa njësi mësimore. Sot në disa shtete shkolla të ndryshme kanë përshtatur MBP dhe STEM e cila përfshin S-shkencën; T-teknologjinë; E-inxhinierinë dhe M-matematikën, madje dhe muzikën, duke i ndihmuar nxënësit të ndjekin pasionin e tyre për artin nëpërmjet shkencave dhe teknologjisë.

Ka ardhur koha që mësuesit të mos kufizohen më duke u vënë para testimin për llogaridhënie, por duhet të ketë një model mësimor që u siguron nxënësve detyra me vlerë të lartë që nxisin angazhimin rigoroz të lëndës dhe STEM MBP e kryen më së mirë këtë gjë

STEM MBP është edhe sfiduese dhe motivuese. Ai kërkon që nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike dhe analitike dhe të rritin aftësitë e të menduarit të rendit të lartë. STEM MBP kërkon bashkëpunim, komunikim kolegjal, zgjidhjen e problemeve dhe të mësuarit vetë-drejtues dhe përfshin të gjithë nxënësit. STEM MBP bazohet në projektimin inxhinierik si gurthemel dhe si bazë mbi të cilën studentët i sjellin njohuritë e tyre të ndara në shkencë, teknologji dhe matematikë për të përballuar zgjidhjen e problemeve reale të botës reale.(Capraro .M.R & Slough.W.S, 2013; 14-15)

Veçanërisht në kontekstin e recesionit, tregimet e kompanive në lidhje me vendet vakant të punës të cilat nuk janë në gjendje për të gjetur punëtorët me aftësitë e nevojshme teknike

⁹ (<https://www.kqed.org/mindshift/42910/how-to-make-sure-that-project-based-learning-is-applied-well-in-schools>)

janë bërë të njohura, si me gazetarët ashtu edhe me ata politikëbërësit që inkurajojnë investimet në arsim dhe trajnim¹⁰

Nëse do të rikujtojmë ato që kemi thënë më lart, theksojmë se STEM dëshmon një element të rëndësishmë të lidhjes së shkollës me inxhinierinë duke u inkorporuar të gjithë këto disiplina nxënësit do të bëhen më të aftë për tregun e punës

Spiralja e projektit

Çfarë nënkuptojmë nga spiralja e projektit?

Për të krijuar një lëvizje dhe ndikim shumë më të madh në komunitetin e nxënësve, por jo vetëm, projektet e tyre duhet të përhapen. Projektet e mira përçojnë energji pozitive të cilat gjithkush ka nevojë t'i shpërndajë me kolegët nëpërmjet rrjeteve sociale dhe profesionale. Në këtë mënyrë ndahet informacioni me ta dhe shtohet gama e njohurive rreth MBP-së. Produkti që do të shpërndahet mund të jetë një video në mënyrë që shpërndarja të bëhet në kohë të shpejtë e bëhet virale.

Po si përgatitet një projekt spiral?

Pasi përgatisim produktin e projektit, rezultateve të tij u bëjmë “marketing” në rrjetet sociale (The Project Spiral, 145-146-147).Më pas e bëjmë publike duke ndarë përvojën e të mësuarit të bazuar në projekte, lidhemi me rrjetin për të shkëmbyer eksperiencë rreth MBP-së. E tillë është dhe Platforma Edmodo dhe ne Edcampus mbahen mbledhje të strukturuar për të bërë një “bilanc” për çka ka shkuar mirë e çfarë jo. Dhe fundi i spiralit të projektit i vjen me mendimet përmbyllëse. Nga ky cikël fitojnë nxënësit të cilët bëhen më aktivë ,mësuesit bëhen bashkëpunëtorë të mirë dhe komuniteti informohet për atë çka bëhet në shkollat e fëmijëve të tyre. Projekti spiral i përket së ardhmes.

¹⁰ .(https://www.purdue.edu/hhs/hdfs/fii/ep-content/uploads/2015/07/s_iafis04c03.pdf)

3.3 Një përmbledhje për përparësitë dhe jo përparësitë e zbatimit të mësuarit të bazuar në projekte

3.3.1 Përparësitë/Avantazhet e Mësimit të bazuar në projekte

Mësimi i bazuar në projekte (MBP) përcaktohet si metoda e mësimdhënies në të cilën nxënësit gjatë një periudhe të zgjatur kohe i përgjigjen një “pyetje të madhe “duke grumbulluar informacion të ri dhe duke fituar aftësi të reja.

Kjo qasje e re mësimore është e fokusuar te nxënësit duke u larguar kështu nga të mësuarit tradicional ku mësuesi është në qendër të procesit mësimor dhe burimi i vetëm i dijes, drejt një rruge ku mësuesi vepron si një lehtësues dhe nxënësit hulumtojnë, bëjnë pyetje dhe i zbatojnë ato që ata kanë mësuar, duke punuar në ekipe apo dhe individualisht.

PBL angazhon nxënësit në zhvillimin e aftësive të tyre bashkëpunuese dhe hetuese

I ndihmon nxënësve që të kuptojnë më mirë informacionin që mbledhin.

I motivon për të mësuar, pasi ata pranojnë se ata e kuptojnë më lehtë informacionin që marrin përmes kësaj qasjeje praktike.

I nxit për të kërkuar informacionin vetë dhe jo ta marrin të gatshëm nga mësuesit

Klima e krijuar në klasë i toleron gabimet dhe ndryshimet.

MBP shërben si një urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës.

Rritja e vetëbesimit dhe një qasje të ndryshme të nxënësve ndaj të mësuarit.

Vlerësimi zhvillohet vazhdimisht.

MBP ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e komunikimit. Duke i mësuar të mbrojnë, idetë e tyre, por në të njëjtën kohë të mësojnë t'i dëgjojnë kundërshtarët dhe të jenë hapur ndaj opinionëve të tjerëve.

Gjatë zbatimit të mësimit të bazuar në projekte nxënësit mësojnë duke u argëtuar, në një mjedis argëtues, ndryshe nga të mësuarit tradicional.

Rrit kreativitetin e nxënësve.

Ul ankthin e nxënësve gjatë procesit të të mësuarit.

MBP zhvillon zakonin e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

3.3.2 Dobësitë e zbatimit të MBP-së

Pasi përmendëm përparësitë, që ka zbatimi i mësimit të bazuar në projekte, nuk mund të mos lëmë pa përmendur vështirësitë në lidhje me të. Kur themi se mësimi i bazuar në projekte tashmë është një domosdoshmëri për arsimin parauniversitar, kjo nuk do të thotë që të kemi tendencë që nxënësit të përqëndrohen vetëm në to duke lënë pas dore të mësuarit e vazhdueshëm dhe të mësuarit për testimet.

Një tjetër disavantazh është dhe zgjedhja e temave të ndryshme që do trajtohen nga nxënësit, të cilat në shumicën e rasteve zgjidhen nga mësuesit.

Zbatimi i mësimit të bazuar në projekte në një klasë të madhe mund të shfaqen vështirësi në motivimin e nxënësve, në përqëndrimin e tyre për të mësuar.

MBP kërkon më shumë kohë për t'u zbatuar.

Mungesa e materialeve dhe e infrastrukturës shkollore funksionale.

Në disa raste nuk menaxhohet mirë klasa dhe krijohet zhurmë gjatë zbatimit të mësimit të bazuar në projekte.

Për nxënësit dhe prindërit zbatimi i MBP kërkon më shumë shpenzime e kanë të vështirë të zgjidhin konfliktet brenda grupit.

Grupet të cilat e zbatojnë për herë të parë këtë metodë mundet të mos kuptohen me njeri-tjetrin duke krijuar situata konfliktuale. Për të minimizuar këto dobësi mësuesit duhet të jenë në gjendje të krijojnë në klasë një klimë pozitive, një atmosferë të këndshme, frymë bashkëpunimi midis grupeve, të sigurojnë mjete të thjeshta të cilat do t'u shërbejnë atyre gjatë procesit të të mësuarit. Mësuesit duhet të bëjnë përpjekjet maksimale e të gjejnë rrugë kërkimi të cilat nuk kërkojnë shumë kohe e shumë kosto.

KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E STUDIMIT

Ky kapitull përmban metodologjinë e studimit. Në këtë kapitull do të përshkruhen metodat e hulumtimit, instrumentet matëse të tij, popullata, kampionimi dhe procedurat e ndjekura për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave

4.1 Metodat e kërkimit dhe dizenjimi i punimit

Gjatë hulumtimit tonë në pjesën teorike jemi përpjekur për të grumbulluar sa më shumë të dhëna të cilat kishin të bënin me Mësimin e Bazuar në Projekte, me përparësitë e mangësitë që kishte aplikimi i MBP në klasë, duke hulumtuar shumë pak literaturë vendase që kishte për këtë çështje, literaturë të huaj, web faqe etj

Përzgjedhja e metodave të hulumtimit mbështetet në objektivat specifike të kërkimit dhe në natyrën e pyetjeve kërkimore.

Punimi në fjalë është mbështetur në metodën sasiore e mbështetur dhe nga qasja cilësore. Kombinimi i dy metodave asaj sasiore dhe cilësore na ndihmon në dhënien e përgjigjeve më të sakta, provon korrelacionin midis variablave dhe vërteton hipotezat e ngritura.

Hulumtimi i marrëdhënies ndërmjet variablave është në qendër të studimit, si rrjedhim u zgjodh një nga llojet e metodës sasiore siç është studimi korrelacional i cili zbatohet për të përcaktuar marrëdhëniet midis dy variablave (Fraenkel, Wallen dhe Hyun , 2011)

Duke u bazuar në pyetjet kërkimore dhe hipotezat u dizenuan tre instrumenta matëse, për të matur në këtë mënyrë se si do të realizoheshin marrëdhëniet midis variablave. Instrumentet u shqyrtuan me specialistë të fushës së edukimit dhe me ekspertë të statistikave. Pyetësorët u testuan para se të aplikoheshin në një grup mësuesish, nxënësish dhe prindëresh të shkollave 9-vjeçare, të Tiranës. Testimi paraprak "face by face" pilot testoi vlefshmërinë kërkimore dhe rezultatin se një pyetje e instrumentit të prindërve ishte e kuptueshme, ndaj duke u konsultuar me ekspertë të edukimit dhe të statistikave kjo pyetje u mendua të hiqej nga pyetësori. Meqë pyetja nuk rezultoi e kuptueshme nga respondentët e pilotimit, e ndryshuam dhe e kthyem në pozitive dhe përsëri zhvilluam testin e besueshmërisë Cronbach's Alpha.

Tabela 8 :Testi i besueshmërisë Cronbach's Alpha për respondentët nxënës dhe mësues

Testi i besueshmërisë së pyetësorëve nxënës-mësues

Nxënës dhe Mësues	Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
Nxënës	.763	.771	10
Mësues	.769	.776	10

Tabela 9 :Testi i besueshmërisë Cronbach's Alpha për prindërit me pyetjen

Testi i besueshmërisë së pyetësorëve prindër

Cronbach's Alpha/priër	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
.854	.858	9

Tabela 9:Testi i besueshmërisë Cronbach'sAlpha për prindërit

Testi i besueshmërisë

Cronbach's Alpha me pyetjen reverse	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
.761	.759	9

Pra siç shihen nga vlerat në tabelë me kthimin reverse të pyetjes vlerat ndyshojnë

Test i besueshmërisë së pyetësorit është matur nëpërmes llogaritjes së koeficientit të Cronbach's Alpha për matjen e qëndrueshmërisë së brendshme të pyetësorit dhe u arrit në përfundimin se doli më e lartë se 0,7(norma e lejuar) duke treguar qëndrueshmërinë e pyetësorit.

Siç vërehet nga tabela vlera e koeficientit të besueshmërisë Cronbach's Alpha, $\alpha = 0.761$, për të gjitha variablat e pavarura dhe të varura të këtij hulumtimi. Ndërsa, po nga kjo tabelë vërehet se koeficienti i besueshmërisë Cronbach's Alpha bazuar në vlerat $\alpha = 0.759$, atëherë përgjigjet e grumbulluara nga pyetësorët e plotësuar për të gjitha variablat e përdorura janë të besueshme dhe të mjaftueshme për analizën e të dhënave.

Pas pilotimit u krye analiza e instrumentit, në të cilën u rishikuan koha e nevojshme në dispozicion të respondentëve për të plotësuar pyetësorin, mënyra e plotësimit të të dhënave të kërkuara, pyetjet që kishin dalë gjatë procesit të plotësimit apo të kuptuarit e përmbajtjes së pohimeve.

Më pas pyetësi u hodh në terren. Procesi i përzgjedhjes së nxënësve, mësuesve të shkollave dhe prindërve respondentë u karakterizua nga një bashkëpunim i hapur dhe shumë efektiv me drejtorinë arsimore dhe me drejtoritë e shkollave 9-vjeçare publike

Instrumenti i ndërtuar është i tipit Likert dhe mat frekuencën e zbatimit të variablave të studimit.

Për të matur variablat e përcaktuar në mënyrë konvencionale si variabla të pavarur dhe si variabla të varur: 1) variabël i pavarur: a) Mësimi i bazuar në probleme (MBP) b) variabël i varur: a) arritjet e nxënësve b) të mësuarit aktiv dhe aftësitë për jetën u përfshinë në dizejnim, respondentët nxënës, mësues, prindër

Për të përballuar gjerësinë e opinionëve, përvojave dhe praktikave u mendua të përdorej kjo metodologji. Përdorimi i disa llojeve të metodave, teknikave dhe i grupeve të subjekteve, mësues, nxënës dhe prindër, synon të garantojë vlefshmërinë e rezultateve të studimit. Procesi i përzgjedhjes së nxënësve, mësuesve të shkollave dhe prindërve u drejtua nga

studiuesja dhe u mbështet nga drejtorë, nëndrejtorë dhe mësues të shkollave të përzgjedhura.

Studiuesja para se të zhvilloheshin pyetësorët zhvilloi një seancë trajnimi me respondentët e përzgjedhur mësues, nxënës, prindër në të cilën u shpjegoi rëndësinë dhe qëllimin e plotësimit të instrumenteve, si edhe i njohën pjesëmarrësit më të gjithë procedurën e plotësimit të tyre, duke u garantuar anonimatën e tyre. Gjithashtu për të zhvilluar intervistat gjysmë të strukturuar me mësuesve të shkollave dhe me prindërit u bashkëpunua me drejtorinë arsimore dhe me drejtoritë e shkollave 9-vjeçare. Mësuesve, nxënësve dhe prindërve u la mundësia që në rast se nuk mund të plotësonin pyetësorin në terren ta plotësonin në Google Forms, pasi në këtë mënyrë kursenin më shumë kohë. Një pjesë e pyetësorëve u plotësuan online. Më pas të gjithë pyetësorët u hodhën në Google Forms dhe u krijua databaza, më pas u transferuan në excel ku u bënë disa nga analizat dhe kodimi i pyetësorëve e më pas përpunimi i të dhënave u bë me programin statistikor SPSS 22.00 Kodimi i të dhënave dhe paraqitja e gjetjeve me formën narrative, pra analiza deskriptive u bë më pas.

Gjithashtu u bë dhe korrelacioni Cronbach's Alpha ose Alfa e Kronbach's, i cili është testi i besueshmërisë, një matës për besueshmërinë e konstruktit dhe mat konsistencën e brendshme të tij që do të thotë, nëse pyetjet mes tyre kanë konsistencë, a janë të besueshme dhe nëse pas disa vitesh bëhet një studim tjetër po më këtë temë dhe nëse pyetësori përdoret si i standardizuar do të kërkohet që rezultatet të dalin të njëjta, pasi këtë gjë e vërteton konsistenca e pyetjeve. Cronbach's Alpha duhet të jetë më e > se 0,7 që të jetë i pranueshëm testi .

U përdor analiza e korrelacionit përmes Chi Test i cili teston lidhjen midis dy variablave dhe vërteton se lidhja ndërmjet variablave nuk është e rastësishme. Një analizë tjetër që u përdor është Pearson R si dhe tabelat kryq Cramer's V, analiza faktoriale nëpërmjet testeve Likelihood.Goodnes etj

4.2 Instrumentet e hulumtimit Për të zbuluar efektivitetin e MBP kemi përdorur këto instrumente në mbledhjen e të dhënave :

Anketimi është një nga teknikat që aplikohet më shumë me qëllim të nxjerrjes së të dhënave statistikore. Gjithashtu këtë teknikë e kemi përdorur për të marrë përgjigje sa më të sinqerta në lidhje me aplikimin e MBP-së në shkollat e klasat e arsimit parauniversitar.

Pyetësi i hartuar për nxënësit e arsimit të mesëm të ulët përmban 28 pyetje të ndarë në tre sesione:

Sesioni i parë përmban të dhëna të përgjithshme për shkollën, klasën e gjininë.

Sesioni i dytë është ndërtuar me pyetje se sa nxënësit e njohin MBP-në.

Sesioni i tretë është ndërtuar me pohime të nxënësve, sesi reflektojnë me opinionin e tyre ndaj deklaratave të dhëna

Dhe për mësuesit, pyetësi përmban 18 pyetje dhe është ndarë në tre sesione:

Sesioni i parë përmban të dhëna të përgjithshme për shkollën, gjininë, eksperiencën.

Sesioni i dytë është ndërtuar me pyetje se sa ndikon MBP-ja te nxënësit në të gjitha aspektet në arritjet e tyre, në sjelljet e tyre dhe përparësitë dhe mangësitë për mënyrën se si funksionon në arsimin e mesëm të ulët.

Sesioni i tretë është ndërtuar me pohime të mësuesve, sesi reflektojnë me opinionin e tyre ndaj deklaratave të dhëna.

Përdorimi i shkallës Liker në këtë sesion u jep mundësi respondentëve të mendojnë rreth faktorëve që kemi shprehur në pohim dhe i ndihmon për të bërë dallimet midis mendimeve të njerëzve.

Për prindërit pyetësi është ndërtuar me 14 pyetje të ndarë në dy sesione:

Sesioni i parë përmban të dhëna të përgjithshme për statusin, gjininë dhe klasën e fëmijës, mosha dhe arsimi i prindit.

Sesioni i dytë ka të bëjë më ndikimin e MBP-së te nxënësit.

Pas analizës deskriptive (përshkruese), frekuencat, është aplikuar crosstabulimi duke filluar nga gjinia, mosha, eksperiencia, klasa, deri te zona e respondëntëve të anketuar. Pas daljes së rezultateve nga pyetësi, përpunimi është bërë ndërmjet testit Hi –katrorit (Hi-square)dhe Testi i Fisherit

Intervista është një teknikë e cila është përdorur për të intervistuar, duke zhvilluar intervista gjysmë të strukturuar, për 15 mësuesit e lëndëve të shkencave si matematikë, fizikë, kimi, biologji, informatikë etj Rezultatet e kësaj metode janë analizuar nëpërmjet formës narrative. Kjo metodë cilësore mund të sigurojë një bazë përshkruese të eksperiencave, besimeve dhe sjelljeve të njerëzve, nga të cilat mund të zënë fill hulumtime te reja.

4.3 Kampioni i studimit

Studimi u përqëndrua te shkollat e arsimit të mesëm të ulët (VI –IX –të) të qytetit të Tiranës. Kampioni i nxënësve u përzgjedh në përputhje me dizenjimin e studimit dhe me metodën dhe llojin e zbatuar, studim korrelacional. U përzgjedhën shkollat pjesëmarrëse dhe në vijim për çdo shkollë të përzgjedhur u përfshinë të gjithë nxënësit. Popullata e shkollave përfshin të gjitha shkollat 9-vjeçare publike të arsimit të mesëm të ulët (VI-IX të qytetit të Tiranës (n=66)

Kampioni u përzgjedh me teknikën e përzgjedhjes rastësore, ku shkollat u ndanë në bazë të vendndodhjes dhe për këtë na ka shërbyer ndarja e re e Tiranës në katër unaza dhe sipas afersisë së tyre më qendrën e qyteti i kemi ndarë në dy zona të mëdha 1)zona e parë urbane dhe 2)zona e dytë periurbane .

Tirana ka numrin më të madh të shkollave 9-vjeçare dhe numri shumë i madh i popullsisë na e bëri të pamundur t'i përfshijmë në hulumtim të gjithë. Ne u përqëndruam në disa shkolla, të cilat do të na jepnin mundësinë më të madhe të marrjes së informacionit të duhur. Do të ishte shumë mirë që studimi të ishte shtrirë në të gjithë vendin, por kjo kërkonte kohë dhe burime të mëdha financiare .

Për studimin tonë kampioni i përzgjedhur u përbë nga tre grupe respondentësh : 1.kampioni i mësuesve të arsimit të shkollave 9- vjeçare publike të qytetit të Tiranës, 2. kampioni i nxënësve të arsimit të mesëm të ulët të shkollave 9-vjeçare publike të qytetit të Tiranës; 3.kampioni i prindërve të arsimit të mesëm të ulët të shkollave 9- vjeçare publike të qytetit të Tiranës, sepse këta janë faktorë të rëndësishëm për të dhënë opinionin se si ndikon MBP –ja në arritjet e nxënësve, bashkëpunimin midis tyre dhe të mësuarit aktiv

Anketimi u krye në 11 shkolla të arsimit të mesëm të ulët (VI-IX) duke u bazuar në ndarjen zonë urbane dhe zonë periurbane të shkollave 9 –vjeçare të qytetit të Tiranës dhe popullata e respondentëve nxënës dhe mësues që morën pjesë në studim.

Më poshtë po ju paraqesim popullatën e nxënësve dhe mësuesve të arsimit të mesëm të ulët.

Tabela 10: Popullata e nxënësve të arsimit të mesëm të ulët të shkollave 9-vjeçare publike të qytetit të Tiranës

N r	Shkollat 9 vjecare publike	Klasa e gjashtë		Klasa e shtatë		Klasa e tetë		Klasa e nëntë		
		Fem ra	Gjith sej	Fem ra	Gjith sej	Fem ra	Gjith sej	Fem ra	Gjith sej	Fem ra
1	AHMET GASHI	52	71	36	83	39	103	55	100	41
2	28 NËNTORI	49	128	61	113	59	118	61	138	63
3	AVNI RUSTEMI	50	93	41	88	35	103	49	101	54
4	ALI DEMI	55	112	53	93	48	101	47	105	53
5	BAJRAM CURRI	42	77	37	79	43	79	31	74	24
6	DORA D ISTRIA	35	89	37	71	38	91	32	108	45

7	DESHMORE T E LIRISË	33	83	34	86	36	85	45	82	38
8	EMIN DURAKU	79	142	60	137	71	122	61	137	82
9	EDITH DURHAM	77	152	62	142	64	176	90	150	57
10	FAN NOLI	77	148	69	167	91	163	79	155	69
11	GJON BUZUKU	60	110	57	128	73	105	51	134	74
12	HASAN PRISHTINA	55	124	65	106	51	114	63	127	70
13	HASAN VOGLI	21	50	21	58	22	79	36	61	25
14	HASAN TAHSIM	14	15	6	8	3	28	13	20	12
15	JERONIM DE RADA	54	114	57	131	61	131	53	141	63
16	KONFEREN CA E PEZES	30	59	27	62	36	56	21	67	35
17	LASGUSH PORADECI	75	101	37	134	68	124	58	151	78
18	KUSHTRIMI I LIRISE	44	99	41	95	46	111	66	80	44
19	KONGRESI I LUSHNJES	36	66	35	79	35	75	32	58	31
20	LIDHJA E PRIZRENIT	46	70	29	79	37	87	49	106	43
21	MUSTAFA GREBLLESH	18	68	41	59	31	73	32	65	30

	I								
22	MISTO MAME53	93	44	86	56	90	42	85	43
23	MUSINE KOKALARI38	97	56	96	48	87	43	137	67
24	MIHAL GRAMENO65	147	69	120	60	129	60	162	80
25	NIKET DARDANI12	50	20	34	18	57	31	45	25
26	OSMAN MYDERIZI39	69	34	101	44	102	43	85	34
27	PJETER BUDI51	111	57	99	54	98	48	102	57
28	RAMAZAN JARANI36	87	36	71	27	86	35	84	32
29	SKËNDER CACI45	120	55	113	64	93	53	134	62
30	SIRI KODRA14	41	20	50	24	45	19	51	26
31	NAIM FRASHËRI 6-90	144	61	140	67	150	70	130	70
32	SERVETE MAÇI14	50	26	50	24	51	30	57	28
33	S. GABRANI (1-5)82	0	0	0	0	0	0	0	0
34	VASIL SHANTO66	135	65	141	65	132	65	133	64
35	XHEZMI DELLI6	17	5	20	10	23	11	25	16

36	E KUQE	39	100	41	102	46	84	36	106	46
37	1 MAJI	50	103	39	97	42	109	43	124	51
38	1 QERSHORI	15	55	30	42	17	59	29	73	30
39	7 MARSI	39	88	57	89	45	72	29	86	38
40	4 DËSHMORE T	26	64	34	64	32	50	15	59	21
41	M.Q.ATATU RK	17	56	24	72	26	53	29	68	28
42	A. KOSTALLA RI (1-5)	69	0	0	0	0	0	0	0	0
43	MURAT TOPTANI	10	18	3	25	14	22	9	0	0
44	SHYQYRI PEZA	62	125	62	134	70	113	51	140	62
45	QAZIM TURDIU	58	85	42	131	75	120	67	133	61
46	SKENDER LUARASI	21	50	21	47	21	48	19	56	31
47	KOLE JAKOVA	41	87	32	77	45	73	28	85	46
48	ISA BOLETINI	56	121	64	116	43	108	48	124	58
49	26 NENTORI	27	58	28	41	20	47	16	50	20
50	KOSOVA 1-6	31	49	26	0	0	0	0	0	0
51	IBRAHIM BRAHJA	19	48	25	42	15	33	23	41	18
52	DHORA	25	47	21	54	30	62	33	57	22

	LEKA									
53	GUSTAV MAYER 1-5	88	0	0	0	0	0	0	0	0
54	AT ZEF PELLUMBI	38	86	39	82	36	80	31	109	51
55	KONGRESI I MANASTIRI T	74	195	93	155	83	167	75	161	80
56	PAL ENGJELLI	21	45	18	49	23	51	19	48	23
57	GJERGJ FISHTA	36	61	32	86	35	64	27	60	34
58	KOREOGRA FIKE	24	33	23	31	18	25	15	24	15
59	JORDAN MISJA	19	37	24	31	13	27	11	31	12
60	LUIGJ GURAKUQI	4	19	5	8	2	9	4	9	2
61	INST NX QE NUK SHIKOJNE	2	8	2	9	3	12	4	8	2
62	INST NX QE NUK DEGJOJNE	4	13	4	0	0	16	8	10	4
63	A.KOSTALL ARI 6-9	0	134	57	150	74	141	59	151	77
64	S.GABRANI 6-9	0	162	80	138	68	145	76	137	67

65	ARDIAN KLOSI	14	35	17	30	12	36	12	19	8
66	BETIM MUCO	39	92	48	58	23	55	25	0	0
	Gjithsej	2491	5206	2445	5079	2479	5148	2415	5359	2542

Tabela 11 :Respondentët nxënës të shkollave të arsimit të mesëm të ulët pjesëmarrës në studim

Shkolla	Nxënës
7 Marsi	30
Ahmet Gashi	51
Dhora Leka	46
Dora D'Istria	29
Kole Jakova	20
Kongresi i Manastirit	48
Sabaudin Gabrani 2	17
Shyqeri Peza	21
Skender Luarasi	69
Vasil Shanto	20
Hasan Tahsini	35
Total	386

**Tabela 12: Popullata e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët të shkollave 9-vjeçare
publike të qytetit të Tiranës**

Mësuesit.Viti shkollor 2017-
2018

Nr	Shkollat 9 vjecare publike	Mesuesit	
		Gjithsej	Femra
1	AHMET GASHI	40	36
2	28 NENTORI	52	47
3	AVNI RUSTEMI	38	34
4	ALI DEMI	41	34
5	BAJRAM CURRI	36	29
6	DORA D 'ISTRIA	34	31
7	DESHMORET E LIRISE	45	37
8	EMIN DURAKU	58	53
9	EDITH DURHAM	62	57
10	FAN NOLI	61	53
11	GJON BUZUKU	58	51
12	HASAN PRISHTINA	49	41
13	HASAN VOGLI	27	24
14	HASAN TAHSIM	13	9
15	JERONIM DE RADA	48	44
16	KONFERENCA E PEZES	25	22
17	LASGUSH PORADECI	46	41
18	KUSHTRIMI I LIRISE	41	35
19	KONGRESI I LUSHNJES	31	26
20	LIDHJA E PRIZRENIT	40	34
21	MUSTAFA GREBLLESHI	27	20

22	MISTO MAME	38	33
23	MUSINE KOKALARI	41	35
24	MIHAL GRAMENO	55	51
25	NIKET DARDANI	23	19
26	OSMAN MYDERIZI	32	28
27	PJETER BUDI	38	34
28	RAMAZAN JARANI	41	35
29	SKENDER CACI	49	43
30	SIRI KODRA	19	17
31	NAIM FRASHERI 6-9	34	28
32	SERVETE MAÇI	36	31
33	S. GABRANI (1-5)	35	33
34	VASIL SHANTO	51	45
35	XHEZMI DELLI	13	11
36	E KUQE	38	31
37	1 MAJI	42	37
38	1 QERSHORI	27	23
39	7 MARSI	36	30
40	4 DESHMORET	24	20
41	M.Q.ATATURK	26	17
42	A. KOSTALLARI (1-5)	23	21
43	MURAT TOPTANI	11	8
44	SHYQYRI PEZA	54	46
45	QAZIM TURDIU	48	42
46	SKENDER LUARASI	24	20
47	KOLE JAKOVA	39	31
48	ISA BOLETINI	48	33
49	26 NËNTORI	26	22
50	KOSOVA 1-6	16	15

51	IBRAHIM BRAHJA	21	17
52	DHORA LEKA	26	23
53	GUSTAV MAYER 1-5	34	31
54	AT ZEF PLLUMBI	41	39
55	KONGRESI I MANASTIRIT	67	59
56	PAL ENGJËLLI	24	22
57	GJERGJ FISHTA	30	24
58	KOREOGRAFIKE	0	0
59	JORDAN MISJA	0	0
60	LUIGJ GURAKUQI	24	21
61	INST NX QE NUK SHIKOJNE	22	17
62	INST NX QE NUK DEGJOJNE	32	24
63	A.KOSTALLARI 6-9	33	19
64	S.GABRANI 6-9	31	28
65	ARDIAN KLOSI	15	12
66	BETIM MUCO	29	21
	Gjithsej	2288	1954

Tabela 13: Respondentët mësues të arsimit fillor dhe arsimit të mesëm të ulët pjesëmarrës në studim

Shkolla	Mësues
7 Marsi	32
Ahmet Gashi	38
Dhora Leka	23
Dora D'Istria	15
Kole Jakova	34
Kongresi i Manastirit	57
Sabaudin Gabrani 2	20
Shyqeri Peza	48
Skender Luarasi	24
Vasil Shanto	45
Hasan Tahsini	10
Total	346

4.4 Vlefshmëria dhe Besueshmëria e Studimit

Përpunimi i të dhënave në këtë studim u realizua me metodën statistikore të SPSS 20 dhe u ndërmorën këto hapa: analiza deskriptive, korrelacione, cross-tabulime, frekuenca të shpërndarjes së përgjigjeve. Kërkimi empirik hulumton marrëdhëniet ndërmjet MBP-së dhe të mësuarit aktiv, arritjeve të nxënësve dhe bashkëpunimit të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët. Hipotezat e formuluar testohen duke u bazuar në të dhënat e grumbulluara nëpërmjet:

- (a) matjeve me pyetësorët duke marrë pohime të nxënësve dhe mësuesve,
- (b) matjeve me anë të intervistave gjysmë të strukturuar të përgjigjeve të mësuesve të lëndeve shkencore

Studimi ka ndjekur disa hapave që pasojnë njëri tjetrit: (1) përcaktimi i problemit,

(2) shqyrtimi i literaturës, (3) formulimi i hipotezave, (4) grumbullimi i të dhënave, (5)

analiza e gjetjeve, (6) nxjerrja e përfundimeve.

Metodologjitë shkencore të studimit në të gjithë hapat e tij, janë zbatuar me korrektësi duke filluar që nga formulimi i pyetjes kërkimore, formulimi i qëllimit të studimit, përcaktimi i hipotezave dhe variablave të varur dhe të pavarur, hartimi i instrumenteve, hartëzimi i pyetjeve, testimi paraprak “face by face”, grumbullimi i të dhënave, analizave dhe përpilimi i përfundimeve dhe rekomandimeve. Edhe në rast se studimi do të përsëritet nga studiues të tjerë në të njëjtat kushte duke zbatuar të njëjtën metodologji shkencore, ata do të përftonin të njëjtat gjetje dhe përfundime, gjë që siguron besueshmërinë e jashtme të temës kërkimore

4.5 Mbledhja dhe grumbullimi i të dhënave

Procesi i mbledhjes së të dhënave u krye nga autorja e studimit duke u ndihmuar dhe nga drejtuesit dhe mësuesit të shkollave në të cilën u kryen pyetësorët. Hulumtimi u zhvillua mbi bazën e dy metodave kërkimore, sasiore, pyetësorët drejtuar nxënësve, prindërve dhe mësuesve dhe metoda cilësore e realizuar nëpërmjet intervistave të zhvilluara me gjashtë drejtues shkollash tre prej të cilave u përkisnin zonës urbane dhe tre të zonës periurbane.

Mbledhja e të dhënave u bë nga muaji mars 2018 e deri në muajin maj 2018, pasi u mor leja në DAR Tiranë për të pasur mundësi të hyjmë e të zhvillojmë pyetësorët në shkollat e arsimit të mesëm të ulët. U bisedua me mësuesit duke i sqaruar përse do të përdorej pyetësori dhe ata në disa raste bëmë dhe sqarimin e nxënësve.

Shkalla e kthimit të pyetësorëve nga ana e nxënësve ishte në masën (95.5 %). Një pjesë e pyetësorëve u formëzuan në google forms dhe më pas u bë shpërndarja e linkut te mësuesit dhe nxënësit. Më pas të dhënat u hodhën në excel dhe u koduan dhe përpunuan në SPSS 22.00.

4.6 Etika e kërkimit

Rregullat etike të studimit janë respektuar në mënyrë rigoroze. Midis respondentëve dhe studiuesit ka pasur një dakortësi dypalëshe për respekt reciprok e bashkëpunim. Respondentëve u është bërë me dije se të dhënat e tyre nuk do të përdoren për asnjë gjë

tjetër, veçse për efekt e qëllim të studimit dhe të dhënat fillestare që janë marrë nga intervistat gjysmë të strukturuar me mësues të lëndëve të ndryshme nuk do të përdoren për asnjë studim tjetër. Duke pasur bashkëpunim reciprok me të gjithë respondentët, gjej dhe një herë rastin t'i falenderoj që ma bënë më të lehtë punën për mbledhjen e të dhënave.

4.7 Vështirësi gjatë mbledhjes së të dhënave

Pavarësisht se punimi u krye duke respektuar gjithë rregullat etike si në çdo studim tjetër dhe në këtë studim janë hapur probleme të cilat kanë vështirësuar mbledhjen e informacionit e të dhënave:

- 1.Studimi përfshin vetëm 11 shkolla të qytetit Tiranë. Ai përfshiu vetëm nxënës të arsimit të mesëm të ulët të shkollave 9-vjeçare të Tiranës .
- 2.Besueshmëria e plotësimit të pyetësorevë nga respondentët mund të mos jetë shumë të sigurt, pasi u plotësuan jo gjithmonë në prani të studiueses.
- 3.Studimi bazohet në matjen e variablave dhe intervistave gjysmë të stukturuar bazuar në deklaratimet e respondentëve .

Për sa u përket kufizimeve të literaturës në lidhje me këtë problematikë mund të themi se jemi mbështetur në literaturën bashkëkohore ndërkombëtare, pasi literatura vendase shqiptare për mësimin e bazuar në projekte MBP është e papërfillshme.

KAPITULLI V: ANALIZA E TË DHËNAVE: MËSUESIT, NXËNËSIT, PRINDËRIT

5.1 Analiza dhe interpretimi i rezultateve

Në këtë kapitull paraqiten në mënyrë të përmbledhur diskutimet mbi gjetjet e studimit dhe këto shoqërohen me interpretimet e rezultateve. Nga ana teorike prezantuar nga kapitujt e mëparshëm vërehet se mësimi i bazuar në projekte është një metodë e cila sjell motivim te nxënësit, e bën atë hulumtues dhe e përgatit t'u japë rrugëzgjdhje problemeve dhe më situatat më të vështira, sjell një klimë miqësore dhe të ngrohtë në klasa, lehtëson mësuesin dhe rrit bashkëpunimin me prindërit dhe mbi të gjitha ndikon pozitivisht në arritjet e tyre.

Në vendin tonë vërehet një mungesë e studimeve të tilla për mësimin e bazuar në projekte. Nëpërmjet këtyre gjetjeve do të përpiqemi të vërtetojmë hipotezat e hulumtimit dhe t'u japim përgjigje pyetjeve të hulumtimit. Më poshtë do të paraqesim të dhënat e hulumtimit me nxënësit, mësuesit dhe prindërit si dhe rezultatet e intervistave me drejtorët e shkollave

Tabela 13: Testi i besueshmërisë Cronbach's Alpha –respondentët mësues

Tabela 14: Testi i besueshmërisë Cronbach's Alpha –respondentët nxënës

Reliability Statistics			
Nxënës apo Mësues	Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
Nxënës	.763	.771	10
Mësues	.769	.776	10

Nëpërmes llogaritjes së koeficientit të Cronbach's Alpha e cila shërben për matjen e qendrueshmërisë së brendshme të pyetësorit u arrit në përfundimin se doli më e lartë se 0,7(

norma e lejuar) duke treguar qëndrueshmërinë e pyetësorit dhe u vërtetua testi i besueshmërisë së pyetësorit.

Siç vërehet nga tabela vlera e koeficientit të besueshmërisë Cronbach's Alpha, $\alpha = 0.763$ për respondentët nxënës dhe, $\alpha = 0.769$ për mësuesit për të gjitha variablat e pavarura dhe të varura të këtij hulumtimi. Ndërsa, po nga kjo tabelë vërehet se koeficienti i besueshmërisë Cronbach's Alpha, $\alpha = 0.771$ për respondentët nxënës dhe $\alpha = 0.776$ për mësuesit atëherë përgjigjet e grumbulluara nga pyetësorët e plotësuar për të gjitha variablat e përdorura janë të besueshme dhe të mjaftueshme për analizën e të dhënave.

Analiza e instrumentit u krye pas pilotimit në të cilën u rishikuan të kuptuarit e përmbajtjes së pohimeve, koha e nevojshme në dispozicion të respondentëve për të plotësuar pyetësorin, mënyra e plotësimit të të dhënave të kërkuara, pyetjet që kishin dalë gjatë procesit të plotësimit. Më pas pyetësori u hodh në terren.

Në anketim morën pjesë dhe 346 mësues dhe 386 nxënës të klasave VI-IX të përzgjedhur në mënyrë rastësore të shkollave 9 vjeçare të qytetit të Tiranës dhe 136 prindër po të këtyre shkollave

5.1.1. Paraqitja e rezultateve të pyetësorëve dhe analizimi tyre në përqindje dhe grafikë

Të dhënat deskriptive. Rezultatet dhe analizimi pyetësorëve të mësuesve dhe nxënësve

Në vijim paraqiten rezultatet e përftuara nga analiza deskriptive e të dhënave nga të cilat u përftuan rezultatet që do të paraqiten në tabelën e mëposhtme, e cila përfshin vlerat e frekuencave të variablave të marrë në studim në vlera numerike dhe në përqindje.

Tabela 15: Vlera e frekuencave të variablit Klasa –respondentët nxënës

Klasa

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	VI	40	10.4	10.4	10.4
	VII	32	8.3	8.3	40.2
	VIII	83	21.5	21.5	21.9
	IX	231	59.8	59.8	100.0
	Total	386	100.0	100.0	

Siç shihet nga tabela vlerat e frekuencave të variablit klasa për respondentët nxënës vëmë re a) në klasën VI bëjnë pjesë 40 nxënës ose 10.4% e tyre b) në klasën e VII bëjnë pjesë 32 nxënës ose 8.3% e tyre c) në klasën VIII bëjnë pjesë 83 nxënës ose 31.5 e tyre;c) 231 nxënës ose 59.8% bëjnë pjesë në klasën e nëntë. Nëse do të vëzhgojmë kampionin e zgjedhur rezulton se mbizotërues janë respondentët nxënës të klasave të nënta, pasi u synua që të vëzhgoheshin më shumë ata të cilët kanë më shumë vite që aplikojnë MBP dhe ne mund të shohim më mirë se sa e kanë përqafuar këtë qasje të re.

5.1.2 Gjinia

Tabela 16: Vlera e frekuencave të variablit gjinia –respondentët mësues

Gjinia		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Mashkull	49	14.2	14.2	14.2
	Femer	297	85.8	85.8	100.0
	Total	346	100.0	100.0	

Respondentë mësues që kanë marrë pjesë në pyetësor janë 364 gjithsej .Nga këta 297 ose 85,8 %janë të gjinisë femërore dhe 49 ose 14,2% janë të gjinisë femërore. Siç shihet

evidentohet një raport jo i drejtë i të dy gjinive, pasi si e cituam dhe më lart në profesionin e mësuesisë janë të punësuar më shumë individë të gjinisë femërore, sesa mashkullore. Kjo, pasi sistemi arsimor në Shqipëri nuk është më i mirëpaguari dhe kjo sjell një tërheqje të gjinisë mashkullore për të mos zgjedhur këtë profesion. Diferenca e ndjeshme duket si në përqindje në tabelën e vlerave të frekuencave , por dhe në grafikun e mëposhtëm

Grafiku 7:Vlerat e frekuencave të variablit gjinia-respondentët mësues




Tabela 17:Vlera e frekuencave të variablit gjinia-respondentët nxënës


Gjinia

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Mashkull	146	37.8	37.8	37.8
	Femer	240	62.2	62.2	100.0
	Total	386	100.0	100.0	

Respondentë nxënës që kanë marrë pjesë në plotësimin e pyetësorit janë gjithsej 386 , nga të cilët 146 meshkuj ose 37.8% dhe 240 femra ose 62.2 %. Siç shihet evidentohet një raport

jo i drejtë midis meshkujve dhe femrave pjesëmarrëse, pasi një pjesë e meshkujve sidomos e atyre të klasave të VIII dhe të IX refuzuan plotësimin e pyetësorit, pasi ndjehen të kompleksuar në situata të tilla.

Grafiku 8: Vlerat e frekuencave të variablit gjinia-respondentët nxënës



5.1.3 Eksperienca Tabela18 :Vlera e frekuencave të variablit -Eksperienca


	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 0-5 vite	52	15.0	15.0	15.0
6-10 vite	47	13.6	13.6	28.6
11-15 vite	70	20.2	20.2	48.8
16-20 vite	60	17.3	17.3	66.2
21-25 vite	58	16.8	16.8	82.9
26-30 vite	42	12.1	12.1	95.1
Mbi 30 vite	17	4.9	4.9	100.0
Total	346	100.0	100.0	

Nga tabela më sipër shihet eksperienca që kanë në arsim respondentët pjesëmarrës. Në studim rezultojnë se 52 prej tyre ose 15% janë me 0-5 vite në arsim, 47 prej respondentëve ose 13,6% kanë 6-10 vite në arsim; 70 mësues ose 20,2 e respondentëve kanë 11-15 vite në

mësimdhënie, siç shihet kjo kategori zë përqindjen më të madhe; 60 mësues ose 17,3% kanë 16-20 vite në arsim, duke vazhduar me 58 mësues ose 16,8 % kanë 21-25 vite; 42 mësues ose 12,1 % kanë 26-30 vite eksperiencë në mësimdhënie dhe mbi 30 vite ka një numër të vogël respondentësh 17 mësues ose 4.9%. Nga respondentët mbi 30 vite, si grupi më pak i përfaqësuar, kemi një përqindje të vogël, pasi kjo kategori është më rezistente në mospjesëmarrje të plotësimi të pyetësorëve.

5.1.4 Zona urbane dhe periurbane

Grafiku 9: Grafiku me vlerat zonë urbane dhe periurbane



Grafiku u mësipërm tregon qartë shpërndarjen e shkollave në të cilat u hulumtua, sipas ndarjes zonë urbane dhe periurbane. Gjithashtu në këtë grafik jepet dhe eksperiencia e mësuesve në këto shkolla:

Tabela 19:Vlerat e frekuencave Zbatimi i MBP-së dhe Niveli shkollor i përdorimit të MBP–respondentët nxënës

Kur e keni përdorur për herë të parë MBP?	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid ARSIMIN	207	53.6	53.6	53.6
FILLOR				
AMU	179	46.4	46.4	100.0
Total	386	100.0	100.0	

Nga përgjigja e pyetjes Kur e keni përdorur MBP për herë të parë ? rezulton se :207 respondentë nxënës ose 53.6 prej tyre pohojnë se e kanë përdorur në arsimin fillor, ndërsa 179 respondentë nxënës ose 46.4 prej tyre e kanë aplikuar për herë të parë në arsimin e mesëm të ulët(AMU) Nga tabela me vlerat e frekuencat e variablit Kur e keni përdorur MBP për herë të parë rezulton se : 207 respondentë nxënës ose 53.6 prej tyre pohojnë se e kanë përdorur në arsimin fillor, ndërsa 179 respondentë nxënës ose 46.4 prej tyre e kanë aplikuar për herë të parë në arsimin e mesëm të ulët(AMU)

Tabela 20:Vlerat e frekuencave të Zbatimit të MBP-ja dhe Sqarimi nga mësuesi para aplikimit- Respondentët nxënës

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Jo	12	3.1	3.1	3.1
Po	374	96.9	96.9	100.0
Total	386	100.0	100.0	

A sqaroheni nga mësuesi para se të aplikoni MBP?

Kësaj pyetjeje i është dhënë kjo përgjigje nga nxënësit: 12 pjesëmarrës ose 3.1% e tyre pohojnë se nuk sqarohen nga mësuesit, ndërsa 374 pjesëmarrës nxënës ose 96.9 % e tyre pohojnë se sqarohen gjë që do të thotë se nxënësit ende nuk e kanë bërë “pronë “ të tyre këtë lloj qasjeje. Nëse do ta ishin familjarizuar me këtë metodë sqarimi vlen vetëm për fazat e para të aplikimit të saj, më pas ata do të ishin të gatshëm për procesin duke pasur mësuesin vetëm lehtësues dhe frymëzues. Kjo thekson akoma më shumë rëndësinë e temës sonë se ka ardhur koha që MBP-ja në mësimdhënien shqiptare të shikohet jo më si një trend, por domosdoshmëri. Megjithatë studiuesja mund të mendojë se respondentët nxënës kanë dhënë përgjigjen “Po”, jo për procedurën e zhvillimit të MBP-së, por për sqarime rreth temës apo detaje rreth saj

5.1.5.Cilësia e MBP-së -Arritjet e nxënësve

Tabela 21 : Vlera e frekuencave të cilësisë së MBP-së në arritjet e nxënësve -respondentët mësues

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 2	4	1.2	1.2	1.2
3	8	2.3	2.3	3.5
4	8	2.3	2.3	5.8
5	22	6.4	6.4	12.1
6	46	13.3	13.3	25.4
7	35	10.1	10.1	35.5
8	106	30.6	30.6	66.2
9	69	19.9	19.9	86.1
10	48	13.9	13.9	100.0
Total	346	100.0	100.0	

Përgjigjen e pyetjes : Në çfarë shkallë mendoni se ndikon MBP në arritjet e nxënësve e gjejmë në tabelën mësipërm të këtyre variablave ku na rezulton se 42 prej respondentëve

mësues ose 12.1 % vlerësojnë se MBP ndikon në arritjet e nxënësve nga në shkallën 2-5, ndërsa 187 prej respondentëve ose 54% e tyre vlerësojnë ndikimin e MBP-së në vlera pozitive në shkallët 6-8 dhe në fund 117 mësues ose 33.8 prej tyre pohojnë se ndikon shumë e ndikon jashtë mase duke iu përgjigjur shkallëve përkatëse.

Tabela 22: Vlera e frekuencave të Ndikimit të MBP-së - Arritjet e nxënëve –respondentët nxënës


		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	5	1.3	1.3	1.3
	2	1	.3	.3	1.6
	3	3	.8	.8	2.3
	4	5	1.3	1.3	3.6
	5	29	7.5	7.5	11.1
	6	30	7.8	7.8	18.9
	7	51	13.2	13.2	32.1
	8	93	24.1	24.1	56.2
	9	101	26.2	26.2	82.4
	10	68	17.6	17.6	100.0
	Total	386	100.0	100.0	

:Në çfarë shkallë mendoni se ndikon MBP në arritjet tuaja?

Përgjigjen e pyetjes e marrim duke u bazuar në vlerat e frekuencës së variablit arritjet e nxënësve nga i cili rezulton se 43 nxënës ose 11.1 % e tyre pohojnë mendimin e tyre për ndikimin në arritje në shkallët 1-5 duke pohuar se influenza e ndikimit në arritjet e tyre nuk është e konsiderueshme, 174 nxënës ose 45.1% e tyre pohojnë mendimin në shkallët 6-8 të cilat kanë vlerë mesatare në gjykim dhe 169 nxënës ose 43.8 e tyre pohojnë se ndikon në

arritjet e tyre në vlerat 9-10 dmth se MBP ndikon konsiderueshëm për të pasur arritje të larta në procesin mësimor.

Grafiku 10: Vlera e frekuencave të Ndikimit të MBP-së në Arritjet e nxënëve –respondentët nxënës



Grafiku e përforcon akoma më shumë gjykimin e nxënësve të cilët mendojnë se MBP-ja ka një ndikim të rëndësishëm në arritjet e tyre gjë që e cila mbështet analizën statistikore të përforcimit të hipotezës së dytë : **MBP-ja ndikon në arritjet e nxënësve.**

Duke krahasuar gjykimin e mësuesve dhe të nxënësve për këtë pyetje arrijmë në përfundimin se pohimin për shkallën 1-5 e bëjnë 42 mësues ose 12.1 prej tyre dhe 43 nxënës ose 11.1. pra 1% e nxënësve mendojnë ndryshe nga mësuesit, një ndryshim aspak i konsiderueshëm në dallimin e gjykit midis mësuesve dhe nxënësve; për shkallët 6-8 pohojnë mendimin e tyre 187 mësues ose 54% e tyre dhe 174 nxënës ose 45.1% e tyre, pra 11.9 % e nxënësve mendojnë ndryshe nga mësuesit e në fund 117 mësues ose 33.8% e tyre pohojnë mendimin në shkallët 9-10, kurse nxënës janë 169 ose 43.8 prej tyre,pra 10% e nxënësve ndryshojnë në gjykim me mësuesit e tyre. Ashtu si do ta lexoni dhe më poshtë në analizën cilësore ky ndryshim justifikohet me faktin se MBP është një metodë tërheqëse, e cila ofron një vlerësim më të mirë të nxënësve në raport me vlerësimin me gojë apo vlerësimin me test .

5.1.6: Krijimi e sjelljeve sociale midis nxënësve

Tabela 23: Vlera e frekuencave të ndikimit të MBP-së në krijimi i sjelljeve sociale midis nxënësve –respondentët mësues

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 3	6	1.7	1.7	1.7
4	3	.9	.9	2.6
5	23	6.6	6.6	9.2
6	25	7.2	7.2	16.5
7	50	14.5	14.5	30.9
8	91	26.3	26.3	57.2
9	87	25.1	25.1	82.4
10	61	17.6	17.6	100.0
Total	346	100.0	100.0	

Nga tabela më sipër marrim përgjigjen e pyetjes :Në çfarë shkallë ndikon MBP në krijimin e sjelljeve sociale midis nxënësve? Duhet të themi se asnjë mësues nuk rezulton të ketë pohuar mendim për shkallët 1-2, pra nuk ndikon aspak dhe pohimi i tyre fillon në shkallën 3. nga 57 prej respondentëve mësues ose 16.5 % japin vlerësimin në vlerat 3-6 dhe 289 respondentë që morën pjesë në studim ose 83,5 e tyre japin vlerësimin për ndikimin e MBP në krijimin e sjelljeve sociale në vlerat 7-10

Tabela 24: Vlerat e frekuencave Shkalla e MBP-së në krijimin e sjelljeve sociale të tyre – respondentët nxënës

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	10	2.6	2.6	2.6
	2	4	1.0	1.0	3.6
	3	5	1.3	1.3	4.9
	4	18	4.7	4.7	9.6
	5	25	6.5	6.5	16.1
	6	31	8.0	8.0	24.1
	7	38	9.8	9.8	33.9
	8	75	19.4	19.4	53.4
	9	74	19.2	19.2	72.5
	10	106	27.5	27.5	100.0
	Total	386	100.0	100.0	

Nga tabela më sipër marrim përgjigjen e pyetjes **Në çfarë shkallë ndikon MBP në krijimin e sjelljeve sociale midis nxënësve?**

Nga respondentët nxënës rezulton se :62 nxënës ose 16.1 prej tyre pohojnë mendimin e ndikimit të dobët të MBP-së në krijimin e sjelljeve sociale të tyre, madje 10 nxënës ose 2.6 e tyre mendojnë se nuk ndikon aspak, por vlen të përmendet se numri i nxënësve në të cilët fillon të rritet mendësia e ndikimit të MBP-së në sjelljet sociale në shkallët 4-5 ; 144 nxënës ose 37.3 e tyre rriten në vlerat e pohimit 6-8 dhe 180 nxënës ose 46.6 e tyre mendojnë se ndikon dhe ndikon jashtë mase MBP-ja në krijimin e vlerave sociale midis tyre .

Duke ballafaquar dhe krahasuar mendimet e dy palëve mësues dhe nxënës arrijmë në pohimin se ka diferenca në gjykim për shkallët 1-5, ndërsa për shkallët 9-10 ka diferenca jo shumë të dukshme, pasi numri i mësuesve në këtë shkallë është 148 ose 42.8% e tyre, ndërsa nxënës janë 180 nxënës ose 46.6 % e tyre nga të cilët 3.8 % e respondentëve nxënës më shumë mendojnë për ndikim të konsiderueshëm të MBP-së në krijimin e sjelljeve sociale të tyre. Pra, dhe ky rezultat është në mbështetje të hipotezës së parë e cila thekson ndikimin e MBP- së në rezultatet e pritshme të nxënësve

5.1.7 Aftësimi i nxënësit për të ardhmen

Tabela25 :Vlerat e frekuencave të Ndikimi i MBP-së aftësimin e nxënësve për të ardhmen - respondentët mësues

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	3	.9	.9	.9
3	3	.9	.9	1.7
4	10	2.9	2.9	4.6
5	18	5.2	5.2	9.8
6	16	4.6	4.6	14.5
7	48	13.9	13.9	28.3
8	62	17.9	17.9	46.2
9	101	29.2	29.2	75.4
10	85	24.6	24.6	100.0
Total	346	100.0	100.0	

Në ç`shkallë mendoni se ndikon MBP për t`i aftësuar nxënësit për të ardhmen? Përgjigjen e pyetjes do ta marrim nga tabela e vlerave të frekuencave të ndikimit të MBP-së në aftësimin e nxënësve për tregun e punës, në të cilën rezulton se 50 prej respondentëve ose 14.5% kanë pohuar mendimin e tyre në vlerat 1-3,4,5,6 duke filluar nga mendimi negativ se

‘nuk ndikon aspak’ duke vazhduar më pas në vlerat më të larta ; 296 respondentë apo 85.5 e tyre mendojnë se ndikimi i MBP-së në këtë variabël përgjigjet me vlerat 7-10, por vlen të përmendim dhe 85 prej respondentëve japin mendimin se MBP ndikon jashtë mase për t’i aftësuar nxënësit për të ardhmen e tyre dhe përshtatjen me ndryshimet e shpejta.

Tabela 26– *Vlerat e frekuencave të Shkallës së ndikimit të MBP në aftësimin e nxënësve për të ardhmen -respondentët nxënës*

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	3	.9	.9	.9
3	3	.9	.9	1.7
4	10	2.9	2.9	4.6
5	18	5.2	5.2	9.8
6	16	4.6	4.6	14.5
7	48	13.9	13.9	28.3
8	62	17.9	17.9	46.2
9	101	29.2	29.2	75.4
10	85	24.6	24.6	100.0
Total	346	100.0	100.0	

Nga tabela e mësipërme marrim përgjigjen e pyetjes Sa ndikon MBP në aftësimin e nxënësve për të ardhmen dhe aftësitë e shekullit XXI?

Vëmë re se 65 nxënës ose 16.8% e tyre pohojnë mendimin e një ndikimi të dobët të MBP-së në krijimin e këtyre aftësive, ndërsa 321 nxënës ose 83.2 e tyre pohojnë mendimin se gjatë aplikimit të MBP-së në klasë nxënësve u krijohet mundësia që njohuritë e mësuara teorikisht t’i vënë në praktikë. Mendimet e tyre në këtë pyetje nuk kanë ndryshime shumë

të dukshme 14.5 % e mësuesve në pohimet 1-5 dhe 16.8% e nxënësve , ndërsa për gjykimet e shkallëve 7-10 rezultojnë 85.5% mësues dhe 83.2% nxënës. Studiuesja është e prirur të mendojë se mësuesit janë më të njohur apo thënë ndryshe “më të rrahur me jetën” me atë që kërkon e ardhmja dhe shekulli i ri dhe gjykojnë më drejt aftësitë që duhen për t’i bërë ballë.

5.1.8 Aftësitë e shekullit XXI, si të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve

Tabela 27: Vlerat e frekuencave të ndikimit të MBP në aftësitë e shekullit XXI, (si të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve)-respondentë mësues

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	1	.3	.3	.3
2	2	.6	.6	.9
3	3	.9	.9	1.7
4	12	3.5	3.5	5.2
5	17	4.9	4.9	10.1
6	31	9.0	9.0	19.1
7	54	15.6	15.6	34.7
8	83	24.0	24.0	58.7
9	63	18.2	18.2	76.9
10	80	23.1	23.1	100.0
Total	346	100.0	100.0	

Duke u bazuar te tabela e vlerave të frekuencave na rezultojnë se nga 346 respondentë, 35 prej tyre, të cilët morën pjesë në plotësimin e pyetësorëve ose 10.1 vlerësojnë variablin në vlerat 1-5 dhe 311 prej respondentëve ose 89.9 e tyre vlerësojnë variablin në vlerat 6-10. Pra, ashtu si kemi theksuar dhe në pjesën teorike që duhet të jemi me mësuesit ata që duhet të nxisim të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve si një shprehje e të menduarit të nxënësit, dhe si duket rezultate e punës sonë po shfaqen në këtë studim.

Tabela 28 : Vlerat e frekuencave të Ndikimit të MBP në aftësitë e shekullit XXI, (si të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve)—respondentët nxënës

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	6	1.6	1.6	1.6
2	7	1.8	1.8	3.4
3	4	1.0	1.0	4.4
4	6	1.6	1.6	6.0
5	18	4.7	4.7	10.6
6	29	7.5	7.5	18.1
7	60	15.5	15.5	33.7
8	59	15.3	15.3	49.0
9	110	28.5	28.5	77.5
10	87	22.5	22.5	100.0
Total	386	100.0	100.0	

Sa ndikon MBP në aftësitë e shekullit XXI, (si të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve? Kësaj pyetjeje respondentët nxënës i kanë dhënë këtë përgjigje që duket dhe në tabelën e vlerave:

Nga tabela e vlerave rezulton se 46 nxënës ose 10.6% e tyre vlerësojnë variablin në vlerat 1-5, pra ndikimi i MBP-së në aftësitë e shekullit të ri nuk është i përfillshëm, ndërsa 345 nxënës ose 89.4 e tyre mendojnë dhe pohojnë mendimin e tyre në shkallët 6-10 duke konsideruar të vlefshëm zhvillimin e MBP –së në aftësitë e shekullit të ri. Studiuesja është e prirur të mendojë se në një shoqëri demokratike në të cilën jetojmë, nxënësit po ndërgjegjësohen gjithmonë e më shumë se marrja e përgjegjësisë kërkon të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve në cilëndo situatë që ato do të ndodhen.


Duke bërë një krahasim të vlerave të dy tabelave me respondentët përkatës mësues dhe nxënës rezulton se shkalla 1-5 pohohet nga 35 mësues ose 10.1% e tyre dhe 41 nxënës ose 10.6% e tyre pra, 0,5 % më shumë nxënës pohojnë se nuk ka ndikim të fortë MBP-ja në këto aftësi; për shkallët 7-10 rezulton se 311 mësues ose 89.9 e tyre pohojnë mendimet e tyre në këto shkallë dhe 345 nxënës ose 89.4 e tyre pohojnë mendimin në këto shkallë , pra 0.5% më shumë e nxënësve pohojnë mendimin e një ndikimi të konsiderueshëm të MBP-së në krijimin e aftësive të shekullit 21, si një domosdoshmëri që e kërkon koha.

5.1 9 MBP në raport me metodologji të tjera të mësimdhënies

Tabela29 :Vlera e MBP-së në raporti me metodat,teknikat e strategjitë e tjera të mësimdhënies respondentët mësues

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Pak i rendesishem	9	2.6	2.6	2.6
Disi I rendesishem	82	23.7	23.7	26.3
Shume i rendesishem	198	57.2	57.2	83.5
Total	57	16.5	16.5	100.0
	346	100.0	100.0	

Grafiku 11: Vlera e MBP-së në raportin me metodat, teknikat e strategjitë e tjera të



mësimdhënies


Përgjigjen e kësaj pyetje e marrim në tabelën dhe në grafikun e vlerave të frekuencave. Vlera “Aspak i rëndësishëm” nuk është pohuar nga asnjë respondent; Vlera “Pak i rëndësishëm” është pohuar nga 9 mësues ose 2,6 % e tyre që morën pjesë në studim, 82 prej mësuesve ose 23.7 pohojnë vlerën “Disi”; 255 prej mësuesve ose 73.7 % e tyre shprehin pohime shumë pozitive në vlerat “I rëndësishëm” dhe “Shumë i rëndësishëm” 255 respondentet që pohojnë rëndësinë dhe vlerën që ka MBP-ja sot në mësimdhënie.

Ky gjykim vjen si rezultat dhe i ndryshimit të kurrikulës, e cila e vendosi mësimin e bazuar në projekte në vlerësim dhe mësuesit në një farë mënyrë janë të detyruar ta aplikojnë atë të paktën një herë në tre muaj, pra çdo tremujor që vlerësohet nxënësi.

Tabela 30: Vlerat e frekuencave Rëndësia e MBP-së në raport me metodat,teknikat e strategjitë e tjera të mësimdhënies -repondentët nxënës

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Aspak i rëndësishëm	12	3.1	3.1	3.1
	Pak i rëndësishëm	25	6.5	6.5	9.6
	Disi i Rëndësishëm	108	28.0	28.0	37.6
	I rëndësishëm	183	47.4	47.4	85.0
	Shumë i rëndësishëm	58	15.0	15.0	100.0
	Total	386	100.0	100.0	

Grafiku 12: Vlerat e frekuencave Rëndësia e MBP-së në raport me metodat,teknikat e strategjitë e tjera të mësimdhënies -repondentët nxënës



Përgjigjja e kësaj pyetje me respondentët nxënës rezulton se 12 prej tyre ose 3.1 % pohojnë mendimin se për ta MBP-ja nuk është “Aspak i rëndësishëm”; 25 nxënës ose 6.5% e tyre pohojnë se është “Pak i rëndësishëm”; 108 nxënës ose 28% e tyre pohojnë mendimin se është “Disi i rëndësishëm”; 183 nxënës ose 47.4 prej tyre pohojnë faktin se është “I rëndësishëm” aplikimi i kësaj metode dhe 58 nxënës ose 15% e tyre mendojnë se është “Shumë i rëndësishëm”. Pra, te respondentët nxënës kemi një larmishmëri përgjigjesh të cilat vijnë duke pasur parasysh dhe stilet e të nxënësve të tyre.

Nga krahasimi që bëjmë në përgjigjet e respondentëve mësues dhe nxënës rezulton se diferencat më të mëdha janë në të pohimeve të nivelit të ulët dhe nuk ka diferenca në nivelin mesatar 82 mësues ose 23.7% dhe 108 nxënës ose 28% ; 255 mësues ose 73.7% në përgjigjet e nivelin e lartë e 241 nxënës ose 62.4%

Studiuesja është e prirur të mendojë se mësuesit e njohin më mirë produktivitetin e metodave dhe strategjive që përdorin në klasë me qëllim sigurimin e arritjeve të larta.

Tabela 31: Vlera e frekuencave Cilët aktivizohen më shumë gjatë zhvillimit dhe prezantimit të projektit femrat apo meshkujt-respondentët mësues

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Meshkujt	67	19.4	19.4	19.4
Femrat	279	80.6	80.6	100.0
Total	346	100.0	100.0	

Bazuar në tabelën e vlerave të frekuencave sipas 346 mësuesve pjesëmarrës në studim 67 prej tyre meshkuj i atribuojnë një pjesëmarrje me 19.4 % e meshkujve dhe 279 femra ose 80.6 prej tyre pohojnë mendimin se janë pikërisht femrat të cilat aktivizohen më shumë. Janë vetë djemtë të cilët pohojnë mendimin se vajzat janë shumë më aktive në procesin e të mësuarit se ata(djemtë) dhe si rrjedhim gjatë aplikimit të MBP-së marrin më shumë përgjegjësi në realizimin dhe prezantimin e produkteve cilësore të MBP-së.

Tabela 32 :Vlera e frekuencave të Aktivizimit gjatë MBP-së i femrave apo meshkujve-respondentët nxënës

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Meshkujt	90	23.3	23.3	23.3
	Femrat	296	76.7	76.7	100.0
	Total	386	100.0	100.0	

Përgjigjet e nxënësve duken në tabelën vlerave të frekuencave në të cilën rezultojnë se:90 respondentë nxënës ose 23.3% e tyre shprehin mendimin se janë djemtë ata që aktivizohen më shumë gjatë zhvillimit të MBP-së, ndërsa 296 respondentë nxënës ose 76.7% mendojnë se janë vajzat ato që aktivizohen më shumë gjatë punës me projekte. Ata e japin këtë mendim bazuar në eksperiencën e tyre gjatë aplikimit të MBP-së në klasa. Vajzat janë shumë më hulumtuese, kreative dhe kërkuese ndaj vetes për të bërë një prezantim dinjitoz të produktit të nxjerrë dhe nxënësit meshkuj e ndjejnë dhe e pohojnë këtë fakt.

Tabela 34.Tabela e vlerave të frekuencave të funksionimit të MBP-së në klasat ku mbizotëron mësimdhënia tradicionale –respondentë mësues

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	198	57.2	57.2	57.2
	Po	148	42.8	42.8	100.0
	Total	346	100.0	100.0	

A mundet të funksionojë MBP në një klasë ku mbizotëron mësimdhënia tradicionale ?

Nga tabela na rezultojnë se 198 ose 57.2 prej tyre respondentë nxënës kanë dhënë përgjigjen

JO dhe 148 respondentë nxënës ose 42.89% japin mendimin se mund të funksionojë. Mësuesit e japin këtë rezultat, pasi ata kanë hasur vështirësi dhe ndonëse tradicionalisht të prirur drejt mësimdhënies tradicionale, me futjen e kurrikulës së re dhe futjes në detyrim të vlerësimit të mësimi bazuar në projekte u përshtaten më së miri .

Tabela 35: Vlerat e frekuencave të funksionimit të MBP-së në klasat ku mbizotëron mësimdhënia tradicionale –respondentë nxënës

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Jo	175	45.3	45.3	45.3
Po	211	54.7	54.7	100.0
Total	386	100.0	100.0	

A mundet të funksionojë MBP në një klasë ku mbizotëron mësimdhënia tradicionale ?

Te respondentë nxënës kjo pyetje ka marrë këtë përgjigje në vlera dhe në përqindje rezulton se :176 nxënës ose 45.3% e tyre janë kundra funksionimit të MBP-së në një klasë ku aplikohet mësimdhënia tradicionale me mësuesin në qendër dhe 211 nxënës ose 54.7 % e tyre pohojnë se funksionon në një klasë me mësimdhënie tradicionale, Këtë mendim nxënësit ia atribuojnë eksperiencës së tyre.

Grafiku 13:Vlera e frekuencave të pyetjes : **A mundet të funksionojë MBP në një klasë ku mbizotëron mësimdhënia tradicionale?-respondentët nxënës**



Tabela 36: Vlerat e frekuencave Cilësia e MBP-së në zonat urbane dhe periurbane-respondentët mësues

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	228	65.9	65.9	65.9
Invalid	118	34.1	34.1	100.0
Total	346	100.0	100.0	

Sic duket nga tabela e vlerave të frekuencave të pyetjes **A mendoni se ka dallime në cilësinë e zhvillimit të MBP në shkollat që janë në qendrat urbane dhe ato periurbane nëse qarkoni PO thoni Pse?** Nga pjesëmarrësit në pyetësor 228 ose 65.9% e tyre mendojnë se nuk ka dallime midis përdorimit të MBP-së në zonat urbane dhe periurbane, ndërsa 118 respondentë ose 34.% e tyre mendojnë se ka ndryshime. Këta që mendojnë se ka ndryshime në aplikimin e MBP-së për shkollat që ndodhen në zonat periurbane japin argumentet e tyre disa prej të cilave janë :

- ✓ Infrastruktura e pamjaftueshme
- ✓ Mungesa e bazës materiale si: laboratorë kimie, fizike, biologjie, tabela SMART, Videoprojektor, laptop etj

- ✓ Niveli ekonomik dhe arsimor i familjeve që jetojnë në zonat periurbane nuk i favorizojnë fëmijët për hulumtime, (largësia nga qendra, mospasja e internetit në shtëpi, një pjesë e madhe e familjeve me ndihmë sociale etj
- ✓ Mungesa e laboratorëve të informatikës etj

Tabela 37: Vlerat e frekuencave të Efektivitetit të MBP-së në lidhje me nxënësit e talentur. Respondentë mësues

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Aspak efektive	4	1.2	1.2	1.2
	Pak Efektive	10	2.9	2.9	4.0
	Disi efektive	37	10.7	10.7	14.7
	Efektive	153	44.2	44.2	59.0
	Shume efektive	142	41.0	41.0	100.0
	Total	346	100.0	100.0	

Bazuar në vlerat e frekuencave të ndikimit të MBP në lidhje me nxënësit e talentuar sipas mësuesve, pasqyruar në tabelë rezulton se :

14 mësues ose 8.1 pohojnë mendimin se nuk është “Aspak efektiv” apo “Pak efektiv” ndikimi i MBP-së te nxënësit e talentuar; 37 mësues ose 10.7% e tyre pohojnë mendimin se është “Disi e pranueshme” për të ndikuar mësimi i bazuar në projekte te nxënësit e talentuar, 153 mësues ose 44.2% pohojnë mendimin se është “Efektive” dhe 142 mësues

apo 41% e tyre pohojnë mendimin se është “Shumë efektive”. Mësuesit e kanë dhënë këtë përgjigje duke mbështetur arsyetimin e tyre te inteligjencat e shumëfishta të nxënësve dhe jo te nxënësit me rezultate shumë të mira në mësim

Grafiku 14: Vlerat e frekuencave të variablit efektiviteti për nxënësit e talentuar




Tabela 38: Vlerat e frekuenca ndikimi MBP-së në reduktimin e numrit të mungesave në shkollë –respondentët mësues

		Freq uenc y	Per cen t	Valid Perce nt	Cumula tive Percent
Valid	Pajtohe m plotesisht	9	2.6	2.6	2.6
	Pajtohe m Patohe m Disi/ neutral	56	16. 2	16.2	18.8
	Nuk pajtohe m Nuk pajtohe m aspak	56	16. 2	16.2	35.0
		157	45. 4	45.4	80.3
		68	19. 7	19.7	100.0
	Total	346	10 0.0	100.0	

Gjatë zhvillimit të MBP reduktohet numri i mungesave të nxënësve në shkollë

Nga tabela më sipër marrim përgjigjen e pyetjes e marrim me rezultatet si më poshtë: 65 pjesëmarrës mësues ose 18.8% në studim pohojnë mendimin “Pajtohem plotësisht” dhe

“Plotësisht” dhe ky mendim thekson lidhjen e aplikimit të MBP-së me rritjen apo zvogëlimin e numrit të mungesave në shkollë,

Në studimin e literaturës vëmë re studiues të ndryshëm, të cilët janë të mendimit se reduktimi i mungesave në shkollë lidhet me faktin se sa i motivuar është nxënësi gjatë aplikimit të MBP-së, 56 pjesëmarrës ose 16.2% thonë se “pajtohem mesatarisht” me këtë ide, 157 pjesëmarrës mësues ose 45.4% pohojnë mendimin se “Nuk pajtohem plotësisht”, 68 mësues ose 19.7% pohojnë mendimin se nuk pajtohen aspak me këtë variabël. Studiuesja është e prirur të mendojë se këta mësues të fokusuar në mësimdhënie, ndoshta nuk kanë pasur kohë të bëjnë një “bilanc” të numrit të mungesave të nxënësve gjatë aplikimit të MBP, ose eksperiencia e tyre ka qenë e tillë dhe ne na duhet ta marrim si të mirëqenë këtë fakt.

Grafiku 15: Vlerat e frekuenave të Ndikimit të MBP-së në reduktimin e numrit të mungesave në shkollë –respondentët mësues




Tabela 39: Vlerat e frekuencave Ndikimi MBP-së në reduktimin e numrit të mungesave në shkollë –respondentët nxënës

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Pajtohem plotësisht	39	10.1	10.1	10.1
Pajtohem Patohem	36	9.3	9.3	19.4
Disi/ neutral	83	21.5	21.5	40.9
Nuk pajtohem	139	36.0	36.0	76.9
Nuk pajtohem aspak	89	23.1	23.1	100.0
Total	386	100.0	100.0	

Nga tabela e mësipërme vlera e frekuencave të ndikimit të MBP në numrin e mungesave në shkollë rezulton se 75 prej respondentëve nxënësve ose 19.4% e tyre kanë shprehur mendimin se “pajtohen plotësisht” ose “pajtohen” me pohimin se mësimi i bazuar në projekte ndikon në reduktimin e mungesave në shkollë, 83 prej tyre ose 21.5% janë pajtuar me pohimin “disi”, 139 prej tyre ose 36.0% nuk pajtohen me këtë mendim dhe 89 respondentë nxënës ose 23.1% e tyre kanë qenë kategorikë në vlerësim duke pohuar “nuk pajtohem aspak” me këtë pohim ,

Nga krahasimi i përgjigjeve të respondentëve mësues dhe nxënës vëmë re se nuk ka ndryshime në asnjë nivel mes tyre, gjë që bie ndesh me studimet e shumta të cilët thonë se zhvillimi i mësimi të bazuar me projekte në shkolla rrit motivimin e nxënësve, e bën procesin e të mësuarit më shumë tërheqës, mëson nxënësit të marrin përgjegjësi e të punojnë “me duart në magje”. Të gjitha këto të çojë në mendimin se në atë kohë kur zhvillohet MBP-ja nxënësit vinë me dëshirë e pa stres në shkollë gjë që nuk ndodh, kur

kanë test apo kur kanë” radhën “ për t`u pyetur në mësim. Përvoja ime si mësuese dhe si drejtuese e një shkolle ku prej 4 vjetësh aplikuam MBP-në nuk e mbështet mendimin e kolegëve.

Tabela 40: Vlerat e frekuencave: Koha e harxhuar nga MBP-ja në lidhje me strategjitë e tjera-respondentët mësues

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Pajtohem plotësisht	46	13.3	13.3	13.3
Disi/neutral	54	15.6	15.6	28.9
Nuk pajtohem	181	52.3	52.3	81.2
Nuk pajtohem aspak	65	18.8	18.8	100.0
Total	346	100.0	100.0	

Bazuar në tabelën e vlerave të frekuencave të kohës që MBP-ja harxhon kohë më shumë se strategjitë e tjera rezulton se 46 responndentë mësues ose 13.3% e tyre “pajtohen plotësisht” ose “pajtohen” me pohimin se metoda e MBP-së kërkon më shumë kohë se strategjitë e tjera të mësimdhënies, 54 mësues ose 15.6 mbajnë një qëndrim neutral as pajtohen me pohimin, por as nuk janë kundra pohimit; 181 mësues ose 52.3% e tyre mbajnë një qëndrim pro pohimit “nuk pajtohem” për këtë problem dhe 65 mësues ose 18.8% e tyre mbajnë qëndrim kategorik”nuk pajtohen aspak “me këtë pohim. Mendimet e respondëntëve mësues bien ndesh me literaturën e cila thekson se MBP-ja kërkon më shumë kohë në aplikim se strategjitë e tjera të metodologjisë së mësimdhënies, sepse hulumtimi nga burime të ndryshme, nxjerrja e një produkti cilësor, prezantimi i tij kërkon kohë fizike dhe cilësore.

Tabela 41:Vlerat e frekuencës së :Kohës së harxhuar nga MBP-ja në lidhje me strategjitë e tjera-respondentët nxënës

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Pajtohem plotesisht	8	2.1	2.1	2.1
Pajtohem	71	18.4	18.4	20.5
Patohem				
Disi/neutral	69	17.9	17.9	38.3
Nuk pajtohem	158	40.9	40.9	79.3
Nuk pajtohem aspak	80	20.7	20.7	100.0
Total	386	100.0	100.0	

Tabela mësipër me vlerat e frekuencave të Kohës së harxhuar nga MBP-ja në lidhje me strategjitë e tjera-respondentët nxënës na tregon se 8 respondentë nxënës ose 2.1% e tyre pajtohen me këtë pohim”plotësisht”; 71 nxënës që morën pjesë në studim ose 18.4 e tyre pajtohen me këtë mendim po jo në mënyrë kategorike, 69 nxënës ose 17.9% e tyre janë neutral në vlerësimin e pohimit, 158 nxënës ose 40.9% e tyre , pra një numër madh i respondentëve pohojnë mendimin se “Nuk pajtohem” me këtë pohim dhe kategoria e fundit e respondentëve nxënës që “Nuk pajtohem aspak” me këtë pohim janë 80 nxënës ose 20.7% e tyre. Pohimet e dhëna nga nxënësit për këtë variabël bien në kundërshtim me përgjigjen e dhënë në pyetjen e hapur se Cili është shqetësimi kryesor i tyre rreth MBP-së dhe përgjigjja është se shqetësimi kryesor i tyre është koha e harxhuar për hulumtim në raport me strategjitë e tjera të mësimdhënies.

Gjykimet e respondentëve mësues, nga respondentët nxënës në vlera nuk kanë diferenca

Tabela 42:Vlerat e frekuencave të ndikimit të MBP-së ne lidhje me stilet e të mësuarit – respondentët mësues

		Freque ncy	Perce nt	Valid Perce nt	Cumulativ e Percent
Valid	Pajtohem plotësisht	1	.3	.3	.3
	Pajtohem	12	3.5	3.5	3.8
	Pajtohem	43	12.4	12.4	16.2
	Disi/ neutral				
	Nuk pajtohem	194	56.1	56.1	72.3
	Nuk pajtohem aspak	96	27.7	27.7	100.0
	Total	346	100.0	100.0	

Bazuar në vlerat e frekuencave të ndikimit të MBP-së në lidhje me stilet e të mësuarit – respondentët mësues rezulton se:13 respondentë ose 6.5% e tyre pohojnë mendimin “pajtohem plotësisht” dhe “pajtohem”. Kjo përgjigje mund të jetë e limituar për shkak se nga përvoja e gjatë në arsimin parauniversitar në vendin tonë, kam arritur në përfundimin se mësuesit nuk i njohin stilet e të nxënësve dhe kanë mangësi në evidentimin e këtyre stileve, te nxënësit ku japin mësim,43 mësues ose 12.4 prej tyre pohojnë “pajtohem disi/neutral” dhe 194 mësues ose 56.1 % e tyre “nuk pajtohen” me këtë variabël dhe 96 mësues ose 27.7% “nuk pajtohen aspak “me këtë variabël. Studiueses i duhet të mendojë e të propozojë rreth kësaj çështjeje se duhen marrë masa të menjëhershme në trajnimin e mësuesve me stilet e të nxënësve, pasi duke mos i njohur ato, puna me nxënësit në vend që të lehtësohet vështirësohet më shumë.

Tabela 43: Vlerat e frekuencave të Vlera e MBP-së në lidhje me vlerësimin përfundimtar-respondentët nxënës

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	42	10.9	10.9	10.9
	Po	344	89.1	89.1	100.0
	Total	386	100.0	100.0	

Para se të bëjmë analizën e të dhënave të kësaj tablele, duhet të rikujtojmë atë çka kemi thënë në kapitujt mësipër se në kurrikulën e vjetër vlerësimi për MBP-në ishte në vlerën 10% të peshës së vlerësimit përfundimtar, ndërsa me futjen e kurrikulës së re mësimi i bazuar në projekte ka një peshë më të vogël në vlerësimin e përgjithshëm.

Sipas tabelës me vlerat e frekuencave rezulton se 42 nxënës ose 10.9% tyre japin mendimin se vlera 10% për ta është e pranueshme dhe nuk është e nevojshme të ndryshojë, ndërsa 344 nxënës ose 89.1 e tyre kanë dhënë përgjigjen PO, pasi mendojnë se kjo vlerë duhet të ndryshojë.

Ky mendim përforcohet dhe te pyetjet e hapura ku nxënësit mendojnë se ata mundohen shumë kur përgatisin produktin e projektit dhe kjo lodhje e madhe nuk justifikohet e nuk i motivon, për shkak se te arritjet e tyre pesha në vlerësimin përfundimtar është jo më 10% por 8% të vlerësimit përfundimtar

Tabela 44 :Vlerat e frekuencave të variablit :Promovimi i të nxënit gjatë gjithë jetës

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Pajtohem plotësisht	2	.6	.6	.6
	Pajtohem	27	7.8	7.8	8.4
	Disi/ neutral	30	8.7	8.7	17.1
	Nuk pajtohem	207	59.8	59.8	76.9
	Nuk pajtohem aspak	80	23.1	23.1	100.0
	Total	346	100.0	100.0	

Promovimi i të nxënit gjatë gjithë jetës .Sipas tabelës me vlerat e frekuencave rezulton se 2 nxënës ose 6% tyre japin mendimin se pajohen plotësisht se MBP promovon të nxënit gjatë gjithë jetës.27 prej tyre ose 7.8 % pajtohet me këtë mendim,30 prej respondentëve ose 17.1% janë neutralë në mendime , 207 prej respondentëve ose 76.6% nuk pajtohen me pohimin dhe 80 respondentë nuk pajtohen aspak me pohimin .

Tabela 45: Vlerat e frekuencave të variablave Ndikimi i MBP-Puna në grupe-Respondentët nxënës

	Frequen cy	Percen t	Valid Percen t	Cumulati ve Percent
Valid Nuk më pëlqen të punoj në grupe	37	9.6	9.6	9.6
Më pëlqen të punoj në grupe	213	55.2	55.2	64.8
Më pëlqen të punoj në grupe në shumicën e kohës	136	35.2	35.2	100.0
Total	386	100.0	100.0	

Siç shihet dhe nga tabela e dhënë 37 nxënës ose 6.3 e tyre nuk duan të punojnë në grupe. Nese do t'i referoheshin inteligjencave të shumëfishta të tyre këtë përgjigje e kanë dhënë ata nxënës të cilët kanë të zhvilluar inteligjencën intrapersonale. Ata pëlqejnë të punojnë vetëm dhe “të korrin” vetëm frytet e suksesit, 213 nxënës ose 55.2% e tyre japin përgjigjen se u pëlqen të punojnë në grupe dhe 136 nxënës ose 35.2% e tyre u pëlqen të punojnë në shumicën e rasteve.

Pra, shohim se kemi në grupin e respondentëve nxënës një sasi të konsiderueshme nxënësish të cilët duan të punojnë në grupe duke theksuar inteligjencën ndërpersonale të tyre. Kjo tregon dhe një herë se nxënësit tanë nga viti në vit po ndërgjegjësohen me faktin se një nga aftësitë thelbësore të shekullit 21 është komunikimi dhe bashkëveprimi në grup.

Tabela 46:Vlerat e frekuencave të variablave ndikimi i MBP-së dhe Komunikimi(mësues dhe nxënës)-respondentët nxënës

P16 Njëpërmjet MBP, mendoj se mund të komunikoj me shokët dhe mësuesit e mi:

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Më pak tani se më parë	38	9.8	9.8	9.8
	Më mirë tani se më parë	348	90.2	90.2	100.0
	Total	386	100.0	100.0	

Para se të zhvillohej pyetësi në shkollë të ndryshme u bë leximi dhe sqarimi i pyetjeve, pra nxënësit do të krahasonin marrëdhënien e tyre të komunikimit me shokët dhe mësuesit kur nuk e përdornin këtë metodë dhe pas përdorimit të metodës. Nga tabela e vlerave rezulton se 38 nxënës ose 9.8% e tyre përdorimi i MBP i kishte ndërprerë komunikimin me shokët dhe mësuesit, ndaj ishin dakort me pohimin “më pak tani se më parë, 348 nxënës ose 90.2% e tyre pajtoheshin me pohimin “më mirë tani se më parë”, pra komunikimi me shokët brenda grupit dhe me mësuesit ishte rritur, pasi nxjerrja e produktit në emër të grupit i përgjegjëson anëtarët e grupit se si “humbja ” dhe “fitorja “është e përbashkët, ndaj e shohin bashkëpunimin të domosdoshëm.

5.2 Të dhënat deskriptive Rezultatet dhe analizimi i pyetësorëve të prindërve

Pyetësorët u testuan para se të aplikoheshin në një grup prindëresh të shkollave 9-vjeçare, të Tiranës..Testimi pilot testoi vlefshëmërinë kërkimore dhe rezultatin e thënë dhe në

kapitullin e “Metodologjisë” se një pyetje ishte e pakuptueshme, ndaj duke u konsultuar me ekspertë të edukimit dhe të statistikave kjo pyetje u mendua të hiqej nga pyetësi :

Tabela 47: Testi i besueshmërisë Cronbach's Alpha me pyetjen 8

Testi i besueshmërisë		
Cronbach's Alpha me pyetjen reverse	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
.761	.759	9

Pra siç shihen nga vlerat në tabelë me kthimin reverse të pyetjes vlerat ndyshojnë

Test i besueshmërisë së pyetësit është matur nëpërmes llogaritjes së koeficientit të Cronbach's Alpha për matjen e qëndrueshmërisë së brendshme të pyetësit dhe u arrit në përfundimin se doli më e lartë se 0,7(norma e lejuar) duke treguar qëndrueshmërinë e pyetësit

Siç vërehet nga tabela vlera e koeficientit të besueshmërisë Cronbach's Alpha, $\alpha = 0.855$, për të gjitha variablat e pavarura dhe të varura të këtij hulumtimi. Ndërsa, po nga kjo tabelë vërehet se koeficienti i besueshmërisë Cronbach's Alpha bazuar në vlerat $\alpha = 0.759$, atëherë përgjigjet e grumbulluara nga pyetësit e plotësuar për të gjitha variablat e përdorura janë të besueshme dhe të mjaftueshme për analizën e të dhënave.

Pas pilotimit u krye analiza e instrumentit, në të cilën u rishikuan koha e nevojshme në dispozicion të respondentëve për të plotësuar pyetësin, mënyra e plotësimit të të dhënave të kërkuara, pyetjet që kishin dalë gjatë procesit të plotësimit, apo të kuptuarit e përmbajtjes së pohimeve.

Më pas pyetësi u hodh në terren Në anketim morën pjesë dhe 136 prindër të nxënësve të klasave VI-IX të përzgjedhur në mënyrë rastësore të shkollave ku u krye dhe anketimi i nxënësve dhe mësuesve

Për t'i gjetur faktorët të cilët ndikojnë në cilësinë e zbatimit të MBP së te arrijtjet e pritshme të nxënësve apo aftësive për jetën, janë identifikuar disa variabla (ndryshore) të pavarura, si: mosha e prindit, mosha e fëmijës, gjinia e prindit dhe gjinia e fëmijës, arsimimi i prindërve.

Paraqitja e statistikave të variablës të varur dhe të variablave të pavarura është bërë në programin SPSS Statistics 22 (Pallant, 2009), me analizën e kryqëzimit të tabelave (Crosstabulation), për t'i shpjeguar marrëdhëniet ndërmjet dy variablave.

Për të vërtetuar së nëse ka një lidhje ndërmjet dy variablave cilësore na shërben Testi Chi Scuar i Koeficientit Person. Për të vërtetuar se ndërmjet dy variablave ekziston një ndryshim sinjifikant. Na shërben rezultati i analizës me metodën “crosstabs” i cili në këtë program paraqitet me anë të një table, e cila e përmban statistikën Chi Scuar dhe vlerën e saj të rëndësisë (domethënies) e cila tregon nëse është vlera më e vogël se 0,05 ($p < 0,05$), atëherë mes variablave ekzistojnë marrëdhënie statistikisht domethënëse.

Për të përcaktuar nëse ekziston një lidhje ose jo statistikore ndërtohen dy hipoteza:

Ho: Nuk ka lidhje ndërmjet variablave në shqyrtim

Ha: Ka lidhje statistikore ndërmjet variablave në shqyrtim

